



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Dimal”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË”
TË USHTRUAR NË BASHKINË DIMAL

Tiranë 2023

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit.	4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.	4
3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.....	17
II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit).....	18
OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA	19
1. Objektivi i auditimit.....	19
2. Qëllimi i auditimit.....	19
3. Identifikimi i çështjes.....	19
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	20
5. Përgjegjësitë e audituesve	20
6. Kriteret e vlerësimit	20
7. Standardet e auditimit	21
8. Metoda e auditimit.....	21
9. Dokumentimi i auditimit.....	23
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	24
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.	24
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	24
2.1 Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.....	24
2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	41
2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2021.....	63
2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.....	64
2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.	127
2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Territorit të Njësisë Vendore.....	131
2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	134
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME.....	157
MASA DISIPLINORE.....	170
V. ANEKSET.....	Error! Bookmark not defined.

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit.

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 121/1 Prot, datë 31.01.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 08.02.2023 deri në datën 24.03.2023, në Institucionin Bashkia Dimal krye auditimi “Financiar dhe i përputhshmërisë”.

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, zbatimi i kontratave të punimeve, lejet e ndërtimit, aktiviteti i IMT, zbatimi i rekomandimeve, administrimi i asetëve, si dhe çështje të dala gjatë auditimit.

Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohej), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 18 akt konstatime.

Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projektraportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshtime, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit dhe janë bërë pjesë e materialit në projektraport dhe në raportin përfundimtar të auditimit.

Pas trajtimit të observacioneve për projektraportin, me subjektin Bashkia Dimal është kryer takimi përmbyllës pranë zyrave të KLSH.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

NR.	Përmbledhje e gjetjes	Referenc a në raportin përfundi mtar (Nr. Fq)	Rëndësia	Rekomandimi
I	Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes së dhënies me qira të fondit pyjor nga Bashkia Dimal, u konstatua se, Është lidhur kontrata me nr. 912/13, datë 02.11.2021, me objekt “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor”, me afat 10 vjet dhe me vlerën 971,500 lekë/vit, ndërmjet Bashkia Dimal përfaqësuar nga znj. J.M në cilësinë e Qiradhënësit dhe zhvillues subjektin “S ShPK” në cilësinë e Qiramarrësit. Kontrata e lidhur është bërë pas miratimit të Këshillit Bashkiak i cili me vendimin nr. 55 datë 02.09.2021, me 15 vota pro nga 21 anëtarë, është dhënë dakortësia për vijimin e procedurave të Heqjes nga fondi pyjor/kullosor publik të sipërfaqe pyjore	154-159	E lartë	Këshilli Bashkiak, Kryetari i Bashkisë Dimal, të marrë masat e duhura që, të rishikojnë të gjithë procesin e dhënies me qira të fondit pyjor dhe kontratën e nënshkruar, të rishqyrtojnë projektin e paraqitur nga subjekti “S.” ShPK si kontraktues për dhënien e fondit pyjor, sipas kushteve dhe tarifave të miratuara, për resursin e tokës, me qëllim arkëtimin e të ardhurave në përputhje me këto tarifa, përshtatjen e tipologjisë së

	<p>Bregu i pashijes dhe mali i Kozarës Për Zhvillimin e Aktivitetit Agroturizëm nga Shoqëria S. ShPK, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 614/1 datë 08.09.2021. Miratimi i dhënies së fondit pyjor nga Këshilli Bashkiak dhe kontrata e lidhur është dhënë jo në përputhje me kondicionet urbane sipas PPV në fuqi, në kohën e miratimit të kontratës, pasi në njësitë strukturore në të cilën është kërkuar të zhvillohet projekti i propozuar nuk lejohen ndërtimet e tipologjive të propozuara. Gjithashtu ndryshimi i zhvillimit të njësive të miratuar me PPV e re të vitit 2022, sjell edhe ndryshimin e statusit të resursit të tokës. Si rezultat i ndryshimeve nevojitet rishikimi i kushteve të kontratës të lidhur përpara miratimit të PPV dhe tarifave përkatëse të tokës në të cilën do të zhvillohet projekti.</p>			<p>ndërtimit në zonat me aktivitete sociale dhe rekreative, sipas PPV të miratuar me vendimin të KKT nr. 04, datë 14.12.2022 dhe Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”.</p>
2	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit u konstatua se; në 5 (pesë) procedura prokurimi, nga Autoriteti Kontraktor janë vendosur kritere e kërkesa të veçanta si liçenca, akte ekspertiza ligjore etj., si dhe specifikime teknike të cilat nuk janë sqaruar në mënyrë teknike dhe ligjore për lidhjen e ngushtë me objektin e prokurimit dhe natyrën e kontratave.</p> <p>Vendosja e kritereve kufizuese dhe të pa argumentuara sjellin për pasojë diskriminim dhe trajtimin e pabarabartë të ofertuesve në procedurat e prokurimit publik.</p>	64-130	E lartë	<p>Autoritetit Kontraktor Bashkia Dimal, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kritereve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me objektin e prokurimit dhe natyrën e kontratave, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.</p>
3	<p>Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 me të ardhurat e veta (pa transfertën e palushtëzuar) të Bashkisë Dimal ka diferenca me vlerën e planifikuar. Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën 335,674,180 lekë, ndërsa realizimi në vlerën 319,520,908 lekë, ose në masën 95,16%.Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri</p>	42-64	E lartë	<p>Bashkia Dimal, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore. Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të</p>

	<p>më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 212,517 mijë lekë, realizuar 157,618 mijë lekë, ose në masën 74,16 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Dimal në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.</p>			<p>gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.</p>
4	<p>Nga auditimi konstatohet se totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2021, të llogarisë(401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën në vlerën 266,150,796 lekë. Bashkia Dimal në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 101,357,088 lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta, dhe Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti 32,151,954 lekë nga investimet e FZHR-së, vlera 101,357,088 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 91,926,520 lekë, ose 90,69% e vlerës së planifikuar, diferenca prej 9,430,568 lekë e pa likuiduar gjatë vitit 2022. Por gjatë vitit 2022 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 137,394,223 lekë, duke e çuar në 31.12.2022 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 146,824,791lekë. Peshën kryesore të detyrimeve e zënë ato për investime në vlerën 122,634,948 lekë, ose në masën 83% të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta bashkisë.Pra, në datën 31.12.2022 vlera e detyrimeve të</p>	42-64	E lartë	<p>Bashkia Dimal të marrë masa për hartimin sa më real të buxhetit, mbështetur në realizimin sa më objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve duke pasur parasysh shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.</p>

	<p>prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022) është rritur me 45,467,703 lekë, ose në masën prej 44%.</p> <p>Përveç sa më lartë më 31.12.2022 Bashkia Dimal ka krijuar detyrime të tjera të reja gjatë vitit 2022, me burim financimi nga granti (FZHR), të cilat janë detyrime për dy ujësjellës, në vlerën 119,326,005 lekë, duke çuar vlerën totale të detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022 në 266,150,796 lekë. Peshën kryesore të detyrimeve totale (së bashku me detyrimet e FZHR) e zënë ato për investime në vlerën 223,961,553lekë, ose në masën 84% të totalit prej 266,150,796 lekë.</p>			
5	<p>Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultuan të ardhura të munguara progresive 2016-2022, për buxhetin e bashkisë Dimal në vlerën totale 317,757,340 lekë. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave të familjarëve në vlerën 199,755,053 lekë. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit në vlerën 69,920,905 lekë Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 3,822,253 lekë. Të ardhura të munguara nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre në vlerën 2,600,000 lekë. Të ardhura të munguara nga mospagimi i gjobave të vendosura nga IMT-ja në vlerën progresive 33,124,950 lekë. Ka mangësi në rastet e ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve.</p>	42-64	E lartë	<p>a) Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Dimal, të marrë masa ligjore ndaj subjekteve debitorë me qëllim mbledhjen e detyrimeve të prapambetura dhe të zbatojë procedurat ligjore për realizimin dhe arkëtimin e tyre.</p> <p>b) Të marrë masa për arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në momentin që lind detyrimi me qëllim mos krijimin e detyrimeve të prapambetura për secilën kategori biznesi.</p>
6	<p>Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me Liçensë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të</p>	42-64	E lartë	<p>Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Dimal, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për</p>

	<p>dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejimin e subjekteve të ushtrajnë aktivitet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën. Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, rezulton se në territorin e Bashkisë Dimal dhe në Njësitë Administrative në vartësi, ushtrajnë aktivitetin 14 subjekte aktualisht të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga 14 subjekte janë pajisur me autorizim 12 subjekte, nga të cilat 2 subjekte janë përpara periudhës objekt auditimi si dhe janë pajisur me licenca/autorizime të reja subjekti 12 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, kanë mbyllur aktivitetin e tyre 2 subjektet të cilat nuk ushtrajnë më aktivitetin në tregtimin me pakicë të hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre si dhe nuk paguar tarifën për tu pajisur me autorizim tregtim karburanti gjithsej 5 subjekte të cilët ushtrajnë aktivitet dhe papaguar detyrimin fiskal, evidentohen në vlerën 2,600,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Dimal</p>			<p>pajisen me liçensa të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe arkëtimin e tarifës së patakshuar prej 2,600,000 lekë ndaj 5 subjekteve, sipas pasqyrës më sipër. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për pagesën e tarifës së liçencë/autorizimit, Bashkia Dimal në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmarrin veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.</p>
7	<p>Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Dimal, nuk ka zbatuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen. Rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 137 persona në vlerë 3,822,253 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Dimal,</p>	42-64	E lartë	<p>Drejtorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 3,822,253,lekë ndaj 137 personave sipas listës, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.</p>
8	<p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Rrjeti jashtëm dhe brendshëm,</p>	64-130	E lartë	<p>Autoriteti Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimeve në</p>

	<p><i>njësia administrative Cukalat, Bashkia Ura Vajgurore</i>”, me fond limit në shumën 201,420,870 lekë pa TVSh dhe me vlerë kontrate në shumën 200,412,476 lekë pa tvsh, me BOE fitues “S. ShPK dhe G. C ShPK”. Bashkia Dimal, nëpërmjet Komisionit të vlerësimit të ofertave, në të cilën, nga 3 OE pjesëmarrës, ka s’kualifikuar 2 OE për mosplotësim të kriterëve të kërkuara dhe ka kualifikuar 1 OE. Nga verifikimi i dokumentacionit të BOE të kualifikuar dhe shpallur fitues, rezulton se, BOE i kualifikuar nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara nga AK, pra në këtë rast tenderi duhej të anulohet. Mos anulimi i procedurës së prokurimit ka çuar në kualifikim dhe shpallje fitues të OE i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, duke sjellë si rezultat lidhjen e kontratës në kushtet e paligjshmërisë të procedurës së prokurimit publik në vlerën 238,203,283 lekë me TVSH.</p>			<p>Bashkia Dimal, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, të marrë masat e duhura që, të mbajë në konsideratë të gjitha aktet ligjore në vlerësimin e OE pjesëmarrës në kushtet kur ata plotësojnë të gjitha kërkesat e vendosura nga AK.</p>
9	<p>Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës Sheq-Gajdë”, me fond limit në shumën 60,391,938 lekë, në fazën e vlerësimit të ofertave u konstatua se: Në këtë procedurë kanë marrë pjesë dy BOE, e konkretisht BOE “L. ShPK & V. K ShPK & E.A ShPK” me vlerë oferte në shumën 37,414,293 lekë dhe BOE K.ShPK & F. ShPK”, me vlerë oferte në shumën 57,305,850 lekë. Nga procesi i vlerësimit të KVO rezulton se të dy BOE pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e AK por një prej tyre ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët. Grupi i auditimi pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi dhe komisioni i ngritur, arrin në përfundimin se s’kualifikimi i “L. ShPK & V. K ShPK & E.A ShPK”, është i padrejtë dhe se dokumentacioni i paraqitur justifikon vlerën e ofertës së dhënë për shkak se një pjesë e zërave të preventivit gjenden pranë zonës së Bashkia Dimal me çmime/kosto</p>	64-130	E lartë	<p>Autoriteti Kontraktor Bashkia Dimal, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, të marrë masat e duhura që, të mbajë në konsideratë të parimet e prokurimit publik, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, me qëllim përdorimin e fondeve me ekonomikitet, efiçencë dhe efikasitet.</p>

	<p>më të ulët dhe të favorshme nga manuali i çmimeve të punimeve të ndërtimit. Gjithashtu BOE ka paraqitur dëshmi se plotëson kërkesat e cilësisë së AK dhe dokumentacionin e kërkuar për të cilat ka deklaruar se merr përsipër kryerjen e punimeve sipas të gjitha kushteve të kërkuara nga Bashkia Dimal sikurse ka paraqitur dhe dokumentacionin shtesë për të justifikuar dhe dhënien e ofertës, pavarësisht se ka qenë anomalisht e ulët. Nëse do të kualifikohej BOE “L. ShPK & V. K. ShPK & E.A ShPK”, Bashkia Dimal do të kryente këtë procedurë me një vlerë 19,891,557 lekë më pak. Pra shuma prej 19,891,557 lekë pa TVSh përbën efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkia Dimal.</p>			
10	<p>Nga auditimi i dokumentacioni të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karburant”, me fond limit në shumën 24,000,000 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate në shumën 24,000,000 lekë pa TVSh me marzh fitimi 16.1% ose 17 leke litër, pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se; Në dosjen e prokurimit nuk rezulton të jetë argumentuar dhe justifikuar sasia e parashikuar. Referuar të dhënave të vëna në dispozicion për vitet e mëparshme rezulton se sasia e konsumuar për vitin 2018 është 71,707 litra, për vitin 2019 është 61,963 litra dhe për vitin 2020 është 79,960 litra. Pra referuar 3 viteve të mëparshme sasia mesatare e konsumuar është 71,210 litra. Për vitin 2021 janë parashikuar 102,439 litra sikurse edhe për vitin 2022. Kjo sasi nuk është argumentuar se përse është parashikuar rreth 22,479 litra më tepër nga viti 2020, dhe 44,958 litra më tepër për të dy vitet. Autoriteti Kontraktor nuk ka siguruar një përshkrim të mallrave që nevojiten për nisjen e procedurës, nuk ka siguruar të dhëna të nevojshme nga strukturat përkatëse për parashikimin e sasisë që nevojiten për realizimin e procedurës, të cilat duhet të argumentonin</p>	64-130	E lartë.	<p>-Autoriteti Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimeve në Bashkia Dimal, të marrë masat e duhura që, të mbajë në konsideratë të gjitha aktet ligjore në llogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim përdorimin e fondeve me ekonomikitet.</p> <p>- Autoriteti Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimeve në Bashkia Dimal, të marrë masat e duhura që përpara hartimit të urdhrimit të prokurimit të argumentojë përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit me qëllim kryerjen e një procesi transparent dhe të besueshëm të procesit.</p>

	<p>vlerën e kontratës. Bazuar në çmimin e ditës i cili është marrë për llogaritjen e fondit limit i cili është 117,143 lekë pa TVSH me sasinë prej 44,958 litra e pa argumentuar arrihet në konkluzion se vlera prej 5,266,514 lekë konsiderohet vlerë e pa argumentuar e fondit limit me pasojë përdorimin e fondeve publike jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit. Gjithashtu nuk rezulton të jetë argumentuar përzgjedhja e llojit të kësaj procedure prokurimi si Marrëveshje Kuadër.</p>			
11	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi auditimin e zbatimit të kontratës së furnizimit me karburant për vitin 2021 konstatohet se; Me datën 15.12.2012, referuar fletëhyrjes në magazinë me nr. 66, marrë në dorëzim nga magazinierja është bërë hyrje sasia me karburant 12,520 litra “Naftë”, sipas faturës së OE “G”, me nr. 432, datë 15.12.2021. Është mbajtur procesverbali nga komisioni i marrjes në dorëzim në të cilin shprehen se kjo sasi është bërë hyrje sipas kontratës së nënshkruar pa nr. prot., datë 15.12.2021 me vlerë 2,140,419 lekë me TVSh. Në këtë procesverbal citohet gjithashtu se “Sipas kërkesave të njërive shpenzuese përkatëse komisioni mori në dorëzim sasinë prej 12,520 litra me vlerë 2,140,419 lekë. Ky shpenzim është njohur dhe në kontabilitet nga nëpunësi zbatues, duke e njohur si detyrime në Pasqyrat Financiare të Bashkia Dimal të vitit 2021. Rast i cili konsiston në marrjen përsipër të një angazhimi të pa parashikuar në buxhetin e vitit 2021 për të cilin nuk janë parashikuar fonde në dispozicion, duke shmangur gjithashtu kryerjen e procedurave standarte të prokurimit, mostrajtimin e barabartë të OE, shmangien e konkurrencës, etj.Nga sa më sipër konstatohet se shuma prej 2,140,419 lekë është shpenzim financiar i pa argumentuar për buxhetin e Bashkisë Dimal.</p>	64-130	E lartë	<p>Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, të marrin masat e duhura për miratimin e fondeve përkatës në Këshillin Bashkiak para kryerjes së shpenzimeve dhe iniciativave të angazhimeve buxhetore.</p>
12	<p>Nga auditimi i pesë komponentëve të</p>	25-42	E lartë	Sektori i Burimeve Njerëzore

<p>Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, u konstatua se; referuar Strukturës dhe Organigramës së Bashkisë Dimal në Rregulloren e saj, në disa raste ka mbivendosje dhe mbingarkesë kompetencash. Në bazë të pyetësorit dërguar njësive të menaxhimit, nuk ka një urdhër nga titullari i institucionit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi. Nuk ka raporte periodike mbi zhvillimin e aktiviteteve të kontrollit sipas afateve të përcaktuar në Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit. Bashkia Dimal nuk ka një plan trajnimesh të brendshme, për rrjedhojë as një buxhet trajnimesh për punonjësit e shërbimit civil apo punonjësit marrëdhëniet me të cilët rregullohen me anë të Kodit të Punës. Bashkia Dimal nuk ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik. Bashkia Dimal nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim. Në Bashkinë Dimal nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut. Vendosija e znj. M.B me detyrë shef finance dhe nëpunës zbatues i Bashkia Dimal, si kryetari i Njesisë së Prokurimit, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Bashkia Dimal nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Bashkia Dimal nuk ka hartuar dhe miratuar hartat e procesit të punës. Bashkia Dimal nuk ka miratuar gjurmën e auditimit. Nuk janë përditësuar raportet periodike apo publikimet vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale.</p>		<p>në Bashkinë Dimal të hartojë një plan trajnimesh për punonjësit e këtij institucioni. Të hartohet dhe miratohet Plani Strategjik i institucionit. Të hartohet dhe miratohet strategjia e menaxhimit të riskut. Të miratohet Gjurma e Auditimit për institucionin. Sektorët dhe Drejtoritë që janë ngarkuar me zbatimin e aktiviteteve të cituara në Plan e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, duhet të hartojnë në mënyrë periodike raporte drejtuar titullarit, ku të përshkruhet ecuria e zbatimit.</p>
--	--	--

13	<p>Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit rezulton se: Leja me nr. prot 2105 datë 11.09.2020 me zhvillues D. B me objekt Magazinë dhe dy stalla për rritjen e shpendëve me adresë Ura Vajgurore nuk është marrë miratim nga TAP-i bazuar mbi sugjerimin që i është dhënë nga përgjigjja e shkresës së AZHT, nr.437 dhe leje ndërtimi: Magazine bujqësore 1 kat ne Drenovicë, Ura Vajgurore adresa e realizimit të punimeve: Ura Vajgurore Fshati Drenovicë nuk është marrë mendim nga institucionet si AKM, AZHT. Me nr. 2977/1, datë 24/09/2021 dhe leje ndërtimi nr. 3360/1, datë 10/11/2021, për magazine shërbimi 1 kat " adresa e realizimit të punimeve: Kutalli, Dimal bazuar mbi përgjigjen e kthyer nga ana e ARRSH-së ku citohet se duhet të respektojë distancat nga kufiri rrugor si dhe të aksesit të bëhet në rrugët e brendshme dhe jo në aksin kombëtar Berat-Fier. Me nr. prot 1514 dhe leje zhvillimi 3827/1 datë 13.12.2021 bazuar mbi kthimin e përgjigjes nga ana e ARRSH-së ku në atë aks ka projekt zhvillimi nga ana e FSHZH dhe DPZHTK e bashkisë Dimal të marrë masa për të bërë ballafaqimin nëse kjo leje e miratuar prek ose jo projektin e zhvillimit që do realizojë FSHZH.</p>	130-134	E lartë	<p>Nga DPKZHT Dimal të merren masa për të marrë konformitetin nga institucionet e përfshira dhe të respektojë rekomandimet e tyre.</p>
14	<p>Nga kontrolli i inspektoratit të mbrojtjes së territorit bashkia Dimal u konstatua se arsimimi i kryeinspektorit nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Si rezultat i kësaj, në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së IMTV rezultoi se në 10 raste nuk është mbajtur vlera e gjobës sipas kuadrit ligjor në fuqi. Veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, nenin 11 dhe nenin 52. Gjithashtu nga kontrolli i inspektoratit të mbrojtjes së territorit u konstatua se në 58 raste është konstatuar se janë mbajtur proces-verbal kundërvajtje por nuk kanë dalë me vendime gjobe, në 94 raste është mbajtur proces-verbal kundërvajtje është mbajtur dhe</p>	134-137	E lartë	<p>Nga ana e kryetarit të bashkisë Dimal të merren masa për të emëruar në krye të këtij Inspektoriatit punonjës me arsim të duhur sipas kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu nga IMTV të merren masat e duhura për rastet e konstatuara me shkelje të vendosën kundërvajtjet administrative përkatëse.</p>

	vendim me gjobë por nuk është mbajtur vendim prishje.			
15	<p>Bashkia Dimal nuk ka marrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm e konkretisht:</p> <p>a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 16 masa organizative janë pranuar 16 masa nga të cilat janë realizuar 3 masa, janë në proces 3 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe nuk janë zbatuar 7 masa.</p> <p>b. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike-të ardhura të munguara janë rekomanduar 4 masa nga të cilat, janë pranuar për zbatim 4 masa, janë zbatuar 1 masë, janë në proces zbatimi 2 masa, dhe është 1 masë pjesërisht e realizuar.</p> <p>c. Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Dimal, për punonjësit e saj konstatohet se nga ana e Bashkia Dimal nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e konstatuar me shkelje dhe me përgjegjësi në Raportin e auditimit të mëparshëm.</p>	137-154	E lartë	Kryetari i Bashkisë Dimal të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përshpejtuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara dhe pjesërisht të zbatuara të paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit.
16	<p>Nga kontrolli i dosjes teknike dhe vëzhgimit në terren për objektin “Rikonstruksioni i rrugëve me rërë bituminoze i fshatrave të bashkisë,” Vlera e kontratës 39,918,096 lekë pa TVSH sipërmarrësit BOE T. ShPK dhe M.ShPK me kontratë nr.236/21 Nga kontrolli në terren i këtyre rrugëve të cilat janë të shpërndara nëpër fshatra të ndryshëm të kësaj bashkie u konstatua se rrugët në shumë pjesë të tyre kishin dëmtime të mëdha si gropa apo rrëshqitje të shtresave rrugore madje në disa pjesë rëra bituminoze kishte degraduar.</p> <p>Projekti i kësaj rruge <u>nuk është eficient dhe efektiv</u> pasi kjo metodë projektimi nuk garanton jetëgjatësi të objektit të ndërtuar. Një rikonstruksion rruge nuk mund të jetë jetëgjatë kur në të ndodhen vetëm 2 shtresa</p>	64-130	E lartë	Nga ana e bashkisë Dimal konkretisht zyrës së urbanistikës dhe kryetarit të bashkisë të merren masa për të hartuar dhe miratuar projekte me efikasitet dhe efektivitet.

	<p>konkretisht stabilizant 10 cm dhe rërë bituminoze 10 cm. Lidhja mes këtyre dy shtresave nuk realizohet sipas kushteve teknike gjithashtu dhe vetë shtresa e rërës bituminoze nuk është zgjidhje e duhur marrë parasysh që këto rruge nuk kanë kanale për kullimin e ujërave. Prania e ujërave mbi sipërfaqen e rrugës për një kohë të gjatë ndikon në degradimin e rrugës për një afat kohor të shkurtër. Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se vlera e këtij investimi në shumën 39,918,096 lekë pa TVSH dhe 47,901,715 lekë me TVSh është shpenzim pa efektivitet për buxhetin e Bashkia Dimal.</p>			
17	<p>Nga kontrolli i dosjes teknike dhe vëzhgimit në terren për objektin “Rrjeti i jashtëm dhe brendshëm njësia administrative Cukalat, bashkia Ura Vajgurore,” Vlera e kontratës 238,203,283 lekë me TVSH sipërmarrësit BOE S. ShPK me dhe G. C kontratë nr.2199/12 Prot u konstatua se: Nga auditimi dhe kontrolli në terren i ujësjellësit të njësisë administrative Cukalat u konstatua se rrethimet e depove Bistrovicë, Cukalat dhe Hallambrez nuk janë rrethuar me rrjetë teli me gjemba si në situacion por me rrjetë teli normale konkretisht zëri: 3.837 Rrethim me tela me gjemba janë situacionuar 250 m2 me vlerë 450,288 lekë në depo Allambrez, 250 m2 me vlerë 450,288 lekë në depo Bistrovicë, 250 m2 me vlerë 450,288 lekë, 280 m2 me vlerë 505,620 lekë në depon Cukalat. Në total 1,406,196 lekë vlerë që përbën dëm ekonomik.</p>	64-130	E lartë	<p>Nga ana e bashkisë Dimal të merren masa për të arkëtuar shumën prej 1,406,196 lekë nga operatori ekonomik BOE “S. ShPK dhe G. C” vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e ndryshimit të zërave të të punimeve të situacionuara nga ato të konstatuara në terren.</p>
18	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrjeteve shpërndarës të të ujësjellësit në bashkinë Ura Vajgurore”, me kontratë nr.2515/5 Prot, datë 16.10.2020, me vlerë kontrate në shumën 71,774,494 lekë me TVSH, me sipërmarrës S. ShPK, referuar preventivit të punimeve, në lidhje me zëri Shtresë cakelli t=20 cm.u konstatua se; Nga vëzhgimi në terren i mbulimit të</p>	64-130	E lartë	<p>Nga ana e bashkisë Dimal të merren masa për të arkëtuar shumën prej 618,547lekë vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p>

	tubacioneve të dërgimit nga st.pompave në depo nuk u konstatua që këto tubacione të mbulohen me cakëll 20cm derisa shtersa e cakëllit është e fundit dhe do të ishte e dukshme nëse do ishte vendosur. Janë situacionuar 2209 m2 shtresë cakulli t=20 cm me vlerë 618,547 lekë .			
19	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i qëndër komuntare Llambi Mile, Bashkia Ura Vajgurore” Vlera e kontratës 40,608,800 lekë pa TVSH sipërmarrësit BOE M. ShPK dhe N. ShPK me kontratë nr.3086/10 Prot, datë 17.12.2020 u kostatua se: Zëri 2.267/1 Shtresë me pllaka porcelani importi është situacionuar 572 m2.Sipërfaqja reale e matur nga jashtë në terren rezulton të jetë 526 m2.Duke zbritur dhe muret e jashtëm dhe të brendshëm llogaritur dhe lartësinë e plintuseve rezulton se duhet ti zbresim 33 m2 sipërfaqe.Në total janë 526 m2-33m2=493 m2 sipërfaqe e shtruar me pllaka porcelani importi.573-492=79 x 2753 lekë/m2=217,487 lekë.</p> <p>-Instalimet telefon/internet: Nga kontrolli në terren nuk u konstatuan këto instalime me vlerë në total për gjithë nenzërat e kësaj rubrike janë në vlerë 55,350 lekë.</p> <p>-Enë zgjerimi të kaldajës copë 2 me vlerë 82,800 lekë nuk janë konstatuar nga ana e grupit të auditimit si dhe nga ana e mbikëqyrës. Vlera totale prej 355,637 lekë përbën dëm ekonomik si pasojë e punimeve të porealizuara dhe situacionimit të volumeve më shumë se gjendja faktike në terren.</p>	64-130	E lartë	Nga ana e bashkisë Dimal të merren masa për të arkëtuar shumën prej 355,637 lekë vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
20	Nga auditimi i sistemit e-leje për lejet e miratuara nga ana e DPZHTK Bashkia Dimal u konstatua se për lejen e ndërtimit njësi shërbimi adresa e realizimit të punimeve: kutalli,dimal me nr.prot 1514 dhe leje zhvillimi 3827/1 datë 13.12.2021 taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur saktë dhe ka një diferencë prej 286,149 lekë shumë e cila përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të bashkisë si	130-134	E lartë	Nga ana e DPZHTK bashkia Dimal të merren masa për të arkëtuar shumat prej 286,149 lekë dhe 110,373 lekë shuma të cilat përbëjnë dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të bashkisë si dhe të merren masa për të llogaritur në mënyrën e saktë taksën e ndikimit në infrastrukturë.

	dhe për lejen nr. 2471/2, datë 24/08/2021 fabrikë për përpunimine vajit të ullirit, bashkia ura vajgurore taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur saktë dhe ka një diferencë prej 110,373 lekë shumë e cila përbën dëm ekonomik shkaktuar Bashkisë Dimal.			
21	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt <i>Ndërtim kopshtesh në lagjen 28 nëntori Ura Vajgurore, Syzes dhe lagje 4 shtatori</i> Vlera e kontratës 21,609,579 lekë me TVSH sipërmarrësit F. ShPK me kontratë nr.1576/13 Prot, datë 16.10.2020 është konstatuar se : Zëri i punës F.V dritare druri dopia xham 12.6 m2 dhe F.V dyer druri me dy carje vertikale me xham 6.2 m2.Nga matjet në terren rezulton se sipërfaqja e dritareve është 14.3m2.Diferenca 18.8m2-14.3 m2=4.5 m2 x 12000 lekë/m2= 54,000 lekë .	64-130	Ulët	Nga ana e bashkisë Dimal të merren masa për të arkëtuar shumën prej 54,000 lekë vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinionimi i auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni mbi Përputhshmërinë.

Ne kemi audituar planifikimin e nevojave për investime, përputhshmërinë ligjore për zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin në teren të kontratave të punimeve të lidhura midis autoritetit kontraktor dhe operatorëve të shpallur fitues.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Dimal, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar për përputhshmërinë.

Baza për dhënien e opinionit të modifikuar¹.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

-Në 5 raste në shumën totale të vlerës të kontratës 442,725 mijë lekë pa TVSh dhe konkretisht në procedurat e prokurimit për objektet “Rrjeti jashtëm dhe brendshëm, njësia administrative Cukalat, Bashkia Ura Vajgurore”, “Shërbimi i pastrimit në Bashkinë Dimal”, “Blerje Karburant”, “Rikonstruksion i shkollës Qendër Komunitare “Llambi Mile Çiflig, Bashkia Ura Vajgurore”, “Rikonstruksioni i rrugës Sheq-Gajdë”, zhvilluar në periudhën 2020-2022, janë

¹ “Opinion i modifikuar”, jepet në raste kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore.

vendosur kriteret të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumet e punës.

-Në 6 raste në procedurat e prokurimit janë konstatuar efekte financiare negative si në procesin e kryerjes së procedurës, po ashtu edhe në zbatimin e kontratave, në shumën 314,809 mijë lekë.

-Në 1 rast në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në pajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën totale 200,412 mijë lekë, konkretisht në procedurën e prokurimit me objekt “*Rrjeti jashtëm dhe brendshëm, njësi administrative Cukalat, Bashkia Ura Vajgurore*.”

-Në 3 raste në procesin e zbatimit të buxhetit dhe menaxhimit të të ardhurave janë konstatuar të ardhura të munguara në shumën totale prej 324,179 mijë lekë.

-Në 5 raste nga zbatimi i kontratave janë konstatuar diferenca punimesh të pa kryera në shumën totale prej 2,86,557 lekë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Dimal:

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Dimal.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kriterëve të DT, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të japë opinion për këtë.

II. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2022:

Bashkia Dimal ende nuk ka përfunduar procesin e rakordimeve me Degën e Thesarit Berat dhe nuk ka përfunduar hartimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2022. Për këtë arsye grupi i auditimit nuk mund të japë një opinion për Pasqyrat Financiare të vitit 2022 të cilat do të auditohen në vijim.

II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 121/1 Prot, datë

31.01.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, i ndryshuar, me shkresat nr. 121/2 Prot, datë 06.03.2023, nga data 08.02.2023 deri në datë 24.03.2023, në subjektin Bashkia Dimal u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.04.2020 – 31.12.2022.

Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. E.M, *Përgjegjës Grupi*
2. R.L, *Anëtar*
3. E. R, *Anëtar*
4. M.M, *Anëtar*

Auditimi u krye me zgjedhje, mbi bazë rrisku.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektiv i auditimit.

Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021 dhe 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

- Në auditimin e përputhshmërisë objektivi është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, si dhe opinionit mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit.

2. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

- Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit nga subjekti, të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar.

3. Identifikimi i çështjes

Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit të auditimit, u identifikuan fushat me risk të cilat përbëjnë drejtimet e auditimit, të miratuara me programin e auditimit nr. 121/1 Prot, datë 31.01.2023, i ndryshuar, si më poshtë:

1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.
2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.
5. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).
7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
8. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Dimal, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Dimal është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Dimal. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, u ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- V.K.M nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- V.K.M nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017;
- V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- V.K.M Nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësisë të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve

- civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
 - Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
 - Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”.
 - Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023".
 - Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
 - Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
 - UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
 - Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Dimal grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

8. Metoda e auditimit

1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye

mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Dimal me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale².

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH^{ja} aplikon³.

²ISSAI 1315

³Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektiveve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektive fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; *dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.

Zona Gjeografike: Dimali kufizohet në veri- perëndim me bashkinë Lushnjë, në veri-lindje me bashkinë Kuçovë, në jug-lindje me bashkinë Berat dhe në jug-perëndim me bashkinë e Roskovecit. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Urës Vajgurore.

Popullsia: Sipas Çensusit të vitit 2011, kjo bashki numëron 27,295 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 39,551 banorë. Me një sipërfaqe prej 156.56 km², ajo ka densitet prej 174 banorë/km² sipas çensusit dhe densitet prej 226 banorë/km² sipas regjistrimit civil. Bashkia Dimal ka qenë që prej vitit 1914 nënprefekturë. Zona që përfshihet në bashkinë e re është e pasur me monumente arkeologjike, historike, monumente kulti dhe natyrore, me vlera unike në llojin e vet, të vizitueshme në çdo kohë dhe të njohura ndërkombëtarisht.

Të dhëna të tjera: Bashkia e re shtrihet në një zonë të pasur me toka bujqësore shumë pjellore si dhe me burime të rëndësishme guri. Burimet kryesore të të ardhurave për banorët e kësaj zone bazohen te shfrytëzimi i resurseve natyrore, sidomos atyre të përpunimit të inerteve të gurit dhe të lumenjve, i fermave private, përpunimit agro-industrial, plantacioneve me ullinj, dru frutorë dhe vreshta, perimeve, blegtorisë, si dhe përpunimit të produkteve të qumështit dhe mishit.

Kjo zonë është e njohur herët për minierat sipërfaqësore të gurit, ndërsa kohët e fundit edhe për përpunimin e gurit në granil dhe gëlqere, duke u njohur edhe si “gurorja” e Shqipërisë për shkak të numrit të madh të shoqërive private që kryejnë aktivitetet në këtë fushë.

Me ndarjen e re administrative kjo njësi vendore do të marrë një profil të rëndësishëm bujqësor, të orientuar sidomos në frutikulturë me prodhimin e ullirit, por nuk mbetet pas dhe blegtorisë, drithërat dhe perimet, si dhe shumë foragjere. Veçanërisht Komuna Kutalli është e njohur në rang kombëtar për kultivimin dhe hershmërinë e perimeve në serat pa ngrohje. Këtë mundësi ia jep terreni dhe pozicioni shumë i favorshëm gjeografik që i favorizon fermerët të kultivojnë perime, fruta dhe vreshta.

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm;

2.1.3 Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të nënpikës 1.1 të programit të auditimit: “Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;

4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetësori i Vetëvlerësimit dhe a është dërguar në Ministrinë e Financave

Baza ligjore ku mbështetet auditimi mbi MFK është:

- ✓ Ligji nr.10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar;
- ✓ “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016;
- ✓ Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- ✓ Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr.7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,
- ✓ VKM nr.243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr.746/2018;
- ✓ Ligji nr.68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- ✓ Ligji “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH”;
- ✓ Udhëzimi nr. 15 dt 20.07.2016;
- ✓ Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Dimal, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “*Mjedisi i Kontrollit*”, “*Menaxhimi i Riskut*”, “*Aktivitetet e Kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në zbatim të auditimit, u kërkua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Baza rregullatore mbi të cilën ushtron funksionet e saj Bashkia e Dimal: Rregullorja e brendshme e miratuar, Rregullorja për sinjalizimin, planet mujore dhe vjetore të punës. etj
2. Strukturën organizative dhe organigramën e institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi; dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;

3. Shkresat e përcaktimit të NA dhe NZ në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, si dhe ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
4. Shkresat për krijimin e grupeve të menaxhimit strategjik [GMS]
5. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre në një vit;
6. Regjistrin e riskut
7. Raportet e monitorimit ku përfshihen edhe Deklarata e cilësisë dhe Pyetëtori i vetëvlerësimit;
8. Plotësimi i pyetësorëve të KLSH për bashkinë e Dimal, dërguar me E-mail
9. Nga auditimi i dokumentacionit të vene në dispozicion nga Bashkia e Dimal, në përgjigje të kërkesave të përshkruara më lart lidhur me MFK-në, grupi i auditimit rezulton me këto konstatime:

➤ Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Dimal, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “*Mjedisi i kontrollit*”, “*Menaxhimi i riskut*”, “*Aktivitetet e kontrollit*”, “*Informimi dhe Komunikimi*” si dhe “*Monitorimi*”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “*Për disa shtesa dhe ndryshime*”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Titulli i gjetjes: Mangësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Situata: Nga auditimi i pesë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, u konstatua se:

- Nga shqyrtimi i Strukturës dhe Organigramës së Bashkisë Dimal në Rregulloren e saj, u konstatua se në disa raste ka mbivendosje dhe mbingarkesë kompetencash.
- Në bazë të pyetësorit dërguar njësisë të menaxhimit, nuk ka një urdhër nga titullari i institucionit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi.
- Nuk ka raporte periodike mbi zhvillimin e aktiviteteve të kontrollit sipas afateve të përcaktuara në Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
- Bashkia Dimal nuk ka një plan trajnimesh të brendshme, për rrjedhojë as një buxhet trajnimesh për punonjësit e shërbimit civil apo punonjësit marrëdhëniet me të cilët rregullohen me anë të Kodit të Punës.
- Bashkia Dimal nuk ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik.
- Bashkia Dimal nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim.
- Në Bashkinë Dimal nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut.
- Vendosja e znj. M.B me detyrë shëf finance dhe nëpunës zbatues i Bashkia Dimal, si kryetari i Njësisë së Prokurimit, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues.
- Bashkia Dimal nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT.

- Bashkia Dimal nuk ka hartuar dhe miratuar hartat e procesit të punës.
- Bashkia Dimal nuk ka miratuar gjurmën e auditimit.
- Nuk janë përditësuar raportet periodike apo publikimet vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale. *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. J.M, Kryetar i Bashkisë Dimal, me detyrë nëpunës autorizues, znj. M.B, Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Financës, me detyrë nëpunës zbatues, znj. B. B, përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, znj. I.M me detyrë koordinatorë e riskut.*

Kriteret:

- Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi 3.1.
- Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.
- Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu III, paragrafi Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore.
- Udhëzimi nr 16 dt 20.07.2016 për Koordinatorin MFK dhe koordinatorin e riskut në njësinë publike, pika 3.2.5.
- Ligji nr. 10296 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin neni 8, pika a. Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu III, paragrafi 3.2.
- Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu III, paragrafi 3.2.
- Udhëzimi nr. 16 dt 20.07.2016 pika 3.2.2.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 21, pika 2.
- Ligji nr.10296 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, neni 8, pika 8. shkronja a.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 3.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 22, pika 5.
- Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreun III, paragrafi 3.3.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, pika 2.
- Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi 3.4.\

Shkaku: Mosrespektimi i kuadrit ligjor të cituar më sipër. Mungesa e trajnimit për stafin e Bashkisë Dimal me fokus njohjen e rregullave dhe parimeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin.

Ndikimi: Mosnjohja e plotë si dhe sa duhet e koncepteve të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rëndësia: E lartë

Sektorin e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Dimal të hartojë një plan trajnimesh për punonjësit e këtij institucioni.

Të hartohet dhe miratohet Plani Strategjik i institucionit. Të hartohet dhe miratohet strategjia e menaxhimit të riskut.

Të miratohet Gjurma e Auditimit për institucionin. Sektorët dhe Drejtoritë që janë ngarkuar me zbatimin e aktiviteteve të cituara në Plan e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, duhet të hartojnë në mënyrë periodike raporte drejtuar titullarit, ku të përshkruhet ecuria e zbatimit.

Më hollësisht trajtohen më poshtë problematikat e konstatuara e konkretisht:

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1, “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili siguron vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit. Mjedisi i kontrollit përmban: a) integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; b) politikat menaxheriale dhe stilin e punës; c) strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; ç) politikat dhe praktikrat e menaxhimit të burimeve njerëzore; d) aftësitë profesionale të punonjësve.

-Nga shqyrtimi i Strukturës dhe Organigramës së Bashkisë Dimal në Rregulloren e saj, u konstatua se në disa raste ka mbivendosje dhe mbingarkesë kompetencash.

-Në pikën 11 të Rregullores, ku përshkruhet përberja e strukturës së Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Kontrollit të Projekteve, Shërbimeve Publike, Transportit, Administrimit të Ujërave, Diasporës, Migracionit dhe Integritit Europian, si dhe përgjegjësitë dhe detyrat e kësaj drejtorie së bashku me punonjësit e saj, vihet re një mbingarkesë e detyrave dhe kompetencave të kësaj drejtorie, duke qenë se pjesë e saj janë dhe specialistë të integritit europian dhe specialistë për çështjet e diasporës, migracionit dhe integritit europian. Këto dy pozicione jo vetëm që kanë përgjegjësi e detyra të ngjashme me njëra tjetrën, por nuk përshtaten me profilin dhe përshkrimin e punës së kësaj Drejtorie. Këto dy pozicione do të ishin më përshtatshme në Drejtorinë Juridike dhe sektorët e saj

- Në Drejtorinë e sipërcituar parashikohet pozicioni i punës Specialist për Ujitjen dhe Kullimin, i cili parashikon disa detyra dhe përgjegjësi mbi ujitjen, vaditjen dhe rindërtimin e sistemeve të tyre në rast dëmtimi të tyre. Në Drejtorinë e Asistencës ndaj Fermerit, Mjedisit, Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes Konsumatore dhe Shërbimit Veterinar, Sektori për Bujqësinë, Asistencën e Fermerit dhe Administrimin e Ujrave, është parashikuar specialisti Administrimit të Ujrave, i cili konkretisht mbikqyr dhe kontrollon punën e Specialistit për Ujitjen, pjesë e strukturës së Drejtorisë së Planifikimit të Territorit. Për të mos ngarkuar strukturën e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, si dhe për të lehtësuar e thjeshtëzuar punën në shërbimin ndaj qytetarëve, do të duhej që pozicioni i Specialistit të Ujitjes të vendosej në Sektorin e Administrimit të Ujrave në Drejtorinë e Asistencës së Fermerit Mjedisit, Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes Konsumatore dhe Shërbimit Veterinar. Këto dy drejtori mbajnë në emërtesën e tyre funksionin e Administrimit të Ujrave, duke ndërlikuar ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuar në Rregulloren e institucionit.

-Për vitin 2022, Bashkia Dimal ka miratuar Strukturën dhe Organigramën e saj me Vendimin 224 datë 21.01.2022, ku përcaktohet numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë prej 288 punonjësish, nga të cilët 205 punonjës të Bashkisë, 79 funksione të transferuar, 4 funksione të deleguar, dy të zgjedhur, 7 staf politik (këshilltarë të Kryetarit), 57 pozicione pune të shërbimit civil, 222 pozicione pune të rregulluar me Kodin e Punës.

Struktura e Bashkisë Dimal ka ndryshuar me vendimin e Këshillit Bashkiak me nr. 15 dt. 28.02.2022, ku janë shtuar 6 pozicione pune, përkatësisht: dy edukatore dhe 4 sanitare. Të dhënat tabelore si më poshtë:

Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar Struktura nr.2556 prot, datë 12.09.2022	294	Nëpunës Civilë	57
		Nëpunës me kontratë + te zgjedhur	237
A ka punonjes me kontratë		Nëse po, sa?	7

provizore?(PO/JO)			
A janë të plotësuar vendet vakante (PO/JO)		Nëse jo, sa vende vakante ka?	3 vende e vakant, 1 në shërbimin civil dhe 2 punonjës me kontratë

- Për vitin 2022, Bashkia Dimal ka ushtruar veprimtarinë e saj nëpërmjet Rregullores së brendshme të institucionit. Bashkia nuk ka një Kod Etike të hartuar dhe miratuar si një dokument të veçantë, por dispozitat që rregullojnë etikën dhe disiplinën e administratës së institucionit janë integruar në Rregulloren e institucionit. Në bazë të pyetësorit dërguar njësive të menaxhimit, nuk ka një urdhër nga titullari i institucionit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi. Komunikimi për rregulloren e brendshme dhe dispozitat përkatëse për etikën dhe disiplinën është kryer nëpërmjet postës elektronike.

- Bashkia Dimal ka hartuar dhe krijuar Rregulloren “Për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit dhe Konfidencialitetin me akt nr. 356 prot. Dt 28.12.2017 dhe Rregulloren “Për Hetimin Administrativ dhe Kërkesën e Sinjalizuesit për Mbrojtjen nga Hakmarrja”, si dhe është krijuar Njësia e Sinjalizimit të Brendshëm të përbërë nga dy punonjës me Urdhër nr 405, dt. 20.12.2016, i ndryshuar me nr 3051 dt. 13.12.2018 të Kryetarit të Bashkisë. Për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës.

- Sipas Rregullores së institucionit, ankesat nga qytetarët mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sektorin e marrëdhënieve me publikun). Rregullorja përcakton se përgjigjet lidhur me ankesat e paraqitura siglohen nga specialisti, drejtuesi i njësisë së menaxhimit dhe drejtori i përgjithshëm e me pas firmosen nga Kryetari i Bashkisë. Përveç dorëzimit të ankesave në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, Rregullorja e Institucionit në nenin 15 të saj parashikon se qytetarët kanë të drejtë të takojnë personalisht Kryetarin e Bashkisë për problemet e tyre, në ditët dhe orët e përcaktuara specifikisht në Rregullore.

Në lidhje me parimin nr. 2, “Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje”.

- Për vitet 2022, Bashkia Dimal ka hartuar dhe miratuar Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, ku janë planifikuar aktivitetet e kontrollit, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit.

- Nuk ka raporte periodike mbi zhvillimin e aktiviteteve të kontrollit sipas afateve të përcaktuara në Plan në kundërshtim me përcaktimet e Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

- Për periudhën vitin 2022, janë hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për çdo 4-muaj, duke u paraqitur MFE.

- Këshilli bashkiak me kompetencat e tij ushtron përgjegjësitë e mbikqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin nr. 3.

- Bashkia Dimal nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim duke rënë në kundërshtim me Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin neni 8, pika a. Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu III, paragrafi 3.2.

Për çdo drejtori janë përcaktuar objektet, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist.

Në lidhje me parimin nr. 4, “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”.

Punësimi në Bashkinë e Dimal bëhet në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Ligjit nr.7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr.243/2015 i ndryshuar me VKM nr.746/2018 Kreu I pika 1, 2. Kjo procedurë rregullohet nga Strukturat e Bashkisë së Dimal:-Sektori i Burimeve Njerëzore [SBNJ] është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM nr.243/2015 i ndryshuar Kreu II;

- Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr.243/2015 i ndryshuar ;

- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pika e, ë, f, g të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Strukturat përgjegjëse të Bashkisë së Dimal hartojnë në fillim të çdo viti Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil duke zbatuar Ligjin nr.152/2015 “Për nëpunësin civil” neni 18, VKM nr. 108/2014 “Për plani vjetor të pranimit në shërbimin civil”, VKB “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Dimal” për çdo vit ushtrimor.

-Bashkia Dimal nuk ka hartuar dhe miratuar hartat e procesit të punës në kundërshtim me Manualin e MFK

-Punonjësit e Bashkisë Dimal trajnohen në bazë të kalendarit të trajnimeve vjetore të ASPA, për ata punonjës të cilët janë punësuar sipas dispozitave të Ligjit për Nepunësin Civil. Bashkia Dimal nuk ka një plan trajnimesh të brendshme, për rrjedhojë as një buxhet trajnimesh për punonjësit e shërbimit civil apo punonjësit marrëdhëniet me të cilët rregullohen me anë të Kodit të Punës. Mungesa e një plani të brendshëm trajnimesh bien në kundërshtim me Kreun III, paragrafin 3.1 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin.

-Për Bashkinë Dimal, Koordinatorë e Riskut është znj. I. M.

- Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është zonja M.B, e cila mban pozicionin si Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Financave.

Për vitin 2022 janë administruar autorizimet, konkretisht 9 autorizime, ku kryetari i Bashkisë ka autorizuar përkatësisht znj. R.S (Sekretare e Përgjithshme) dhe znj. L. B (Nën kryetare e Bashkisë) për ushtrimin e disa kompetencave.

- *Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).*

Në zbatim të nenit nr. 24 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar; ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017“Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.10296datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore”, është ngritur GMS ku është miratuar draft-projekti PBA 2023-2025, projekt-buxheti për vitin 2023, si dhe deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm. Lidhur me përbërjen e GMS, në përgjithësi ajo është sipas përcaktimit të bërë në pikën 30 të Udhëzimit nr.23, datë 30.07.2016 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore”, ku drejtuesi i grupit është Kryetari i Bashkisë, si dhe ka përfaqësues nga të gjitha drejtoritë dhe sektorët e Bashkisë.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupitë Menaximit Strategjik(GMS) rezultoi se:

- Bashkia Dimal nuk ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik” në kundërshtim me Udhëzimin nr 16 dt 20.07.2016 për Koordinatorin MFK dhe koordinatorin e riskut në njësinë publike, pika 2.3.

II.Komponenti“Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin nr. 6, Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

-Nga Bashkia Dimal përcaktohen objektiva sasiore (vlerë monetare) vetëm në hartimin e PBA-ve dhe buxheteve vjetore.

Në lidhje me parimin nr. 7, “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

-Bashkia Dimal ka një koordinator risku si dhe ka miratuar një regjistër risku me nr prot. 290/1 dt. 25.02.2022.

-Bashkia Dimal ka miratuar Regjistrin e Riskut me nr. Prot 290/1, dt 25.02.2022

-Në Bashkinë Dimal nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 16 dt 20.07.2016 pika 3.2.2, si dhe në kundërshtim me nën kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, neni 8, pika 8. shkronja a.

- Përcaktimi i NA dhe NZ është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH”, si dhe ligjit nr. 90 datë 27.09.2012 “Për organizimin e administratës shtetërore” si dhe janë njoftuar Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues plotësojnë kriteret e kërkuara nga ligji si: (kriteri i varësisë NA-NZ, kriteri i arsimimit dhe kriteri i nivelit menaxherial).

III.Komponenti: “ Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin nr. 10, “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.

-Nga komunikimi me personat përgjegjës në Bashkinë Dimal, u konstatua se institucioni nuk ka hartuar dhe miratuar Hartat e Proceset e Punës, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi 3.3, Udhëzimi nr. 16, dt 20.07.2016 pika 2.3.

-Konstatohet se urdhër shpenzimet nënshkruhen nga nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues.

- Nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion lidhur me takimet e detyrueshme vjetore të GMS, në zbatim Ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit financiar dhe kontrollin” përcaktohet se “Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të mbledhet të paktën katër herë në vit. Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t’i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë”

Konstatohet se Bashkia Dimal ka miratuar një plan pune vjetor të GMS lidhur me aktivitetet dhe çështjet që do të analizohen. Bashkia Dimal ka hartuar grafikun e takimeve që do të zhvillohen nga ana e GMS për vitin 2022. Referuar regjistrin të Vendimeve janë përcaktuar dhe janë zhvilluar 6 takime nga ana e Grupit të Menaxhimit Strategjik të cilat janë miratuar me VKB nr. 01 datë 25.02.2022 dhe mbaron me VKB nr. 6 datë 23.12.2022 sipas përcaktimeve të Ligjit nr.10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të menaxhimit financiar dhe Kontrollin”.

-Bashkia Dimal ka hartuar “Plani i Veprimit për Zhvillimin e Kontrollit të Brendshëm” me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat si dhe qëllimet do të arrihen) dhe me shkresën nr. 290/1 prot., datë 25.02.2022 i është përcjellë Njesisë Qëndrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

-Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Financiare (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.

-Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të përlogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimve/shërbimeve.

-Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në 12 procedura prokurimi për periudhën objekt auditimi, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Dimal, znj. M.B si anëtare e Njesisë së Prokurimit dhe hartimit të specifikimeve teknike, llogaritjes së fondit limit dhe hartimit të Dokumenteve të Tenderit. Zj. B është me pozicion pune Drejtor i Dejtorisë së Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues, është njëkohësisht dhe anëtar dhe sekretar i Grupit të Menaxhimit Strategjik të institucionit. Vendosija e zj. M.B me detyrë shef finance dhe nëpunës zbatuesi i Bashkia Dimal, si kryetari i Njesisë së Prokurimit, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Çdo urdhër i titullarit për caktimin e në komisione të nëpunësit zbatues i cili bie ndesh me veprimtarinë, duhet të refuzohen nga ky i fundit, gjë e cila nuk rezulton të jetë kundërshtuar në asnjë rast. Veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5, Rregulloren e brendshme të Bashkia Dimal miratuar me vendimin nr. 1043, datë 31.03.2021, Kreu 9, pika 6, e cila ndër të tjera përcaktohet se: “*Kontrollet pas faktit nuk kryhen nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit*”.

Veprim për të cilin mban përgjegjësi titullari i Bashkisë zj. J.M dhe znj. M.B.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve.

-Në Rregulloren e Brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

-Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësi. Në bazë të Planit të Veprimit për Kontrollin e Brendshëm për vitin 2022, u konstatua se Bashkia Dimal ishte në proces të hartimit të një Rregulloreje për Menaxhimin e Aktiveve.

-Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Dimal.

-Bashkia Dimal në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

-Titullarja e Bashkisë Dimal nuk ka miratuar gjurmën e auditimit. Kjo bie në kundërshtim me nenin 16 pika 2 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Në lidhje me parimin nr. 11, “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

- Bashkia Dimal nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Bashkia Dimal nuk ka një sistem elektronik back-up për të dhënat e institucionit.

-Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT. Aktualisht Bashkia Dimal nuk ka një punonjës IT që të mbulojë këtë aspekt në institucion- -Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin MicrosoftOfficeExcel në kundërshtim me përcaktime e manualit të MFK.

Në lidhje me parimin nr. 12, “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

-Në rregulloren e brendshme janë përcaktuar dhe ndarë detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorëve dhe Përgjegjësve të sektorëve, ku vihen re mbivendosje/mbingarkesë të funksioneve.

-Me vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve merret Drejtoria Ekonomike dhe Financave, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi dhe rregullores së brendshme.

- Ekzistojnë procedurë kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregulime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjene ditareve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimine listë-pagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedurë janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësit në të gjitha nivelet e Drejtorisë Ekonomike dhe Financave.

IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”

Në lidhje me parimin nr. 13:

Bashkia Dimal disponon faqen e saj të veb-it ëëë.bashkiadimal.gov.al

Në këtë ëëb faqe pasqyrohet aktiviteti i saj si: Rregullorja e Brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, buxheti vjetor, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve. Nuk janë përditësuar raportet periodike apo publikimet vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin e prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale.

-Çdo drejtori ka e-mail-in zyrtar dhe është e përcaktuar apo menaxhohet nga Drejtori i Drejtorisë.

Komunikimi me publikun, ankesat dhe kërkesat për informacion menaxhohen nga organet e parashikuara në Rregulloren e brendshme.

Në lidhje me parimin nr. 14, Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal, shkresor dhe atë elektronik, i cili rregullohet në nenin 35 të Rregullores së brendshme.

V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”

Në lidhje me parimin nr. 16, “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

- Proçedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin bashkisë. Raportimet e drejtuesve të sektorëve dhe drejtorive bëhen në me shkresa dhe në mënyrë verbale drejtuar eprorëve.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili duhet hartohet cdo 4 muaj, dhe është dorëzuar brenda afateve në MFE.

-Procesi i vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm realizohet nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit të menaxherëve e strukturave, hartimit e deklaratës mbi cilësinë e kontrollit të brendshëm, si dhe me anë të njësisë të auditimit të brendshëm, e cila vepron sipas një plani vjetor dhe strategjik të miratuar nga titullari i institucionit.

- Bashkia Dimal lidhur me pyetësorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MFE për vlerësimin e sistemeve për vitin 2022. . Raporti i Cilësisë së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm paraqet në mënyrë të përmbledhur problematikat në 5 komponentët e MFK dhe është deri diku në përputhje me problematikat e evidentuara në këtë akt konstatimi. Të pesta elementet e MFK janë trajtuar në Raport, së bashku me çfarë është menduar të zgjidhet dhe organet përgjegjëse për problematikat e caktuara. Nuk është konstatuar nga ana e institucionit paligjshmëria e pjesëmarrjes së Drejtorit të Ekonomisë dhe Financës në Njësinë e Prokurimit, duke treguar njohurinë e cekët të menaxhimit mbi Ligjin për MFK.

Në lidhje me parimin nr. 17, “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm.

Konkluzion: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen dhe nuk funksionojnë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa proçedura në lidhje me 5 komponentët si:

“Mjedisi i kontrollit”

-Nga shqyrtimi i Strukturës dhe Organigramës së Bashkisë Dimal në Rregulloren e saj, u konstatua se në disa raste ka mbivendosje dhe mbingarkesë kompetencash.

-Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.

-Në bazë të pyetësorit dërguar njësive të menaxhimit, nuk ka një urdhër nga titullari i institucionit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi.

-Nuk ka raporte periodike mbi zhvillimin e aktiviteteve të kontrollit sipas afateve të përcaktuara në Plan.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

- Bashkia Dimal nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim.
- Në Bashkinë Dimal nuk është hartuar dhe miratuar Harta e Menaxhimit të Burimeve njerëzore.
- Bashkia Dimal nuk ka hartuar dhe miratuar hartat e procesit të punës në kundërshtim me Manualin e MFK.
- Bashkia Dimal nuk ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik” në kundërshtim me Udhëzimin nr 15 dt 20.07.2016 për Koordinatorin MFK dhe koordinatorin e riskut në njësinë publike, pika 2.3.
- Në Bashkinë Dimal nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, në kundërshtim me me Udhëzimin nr. 15 dt 20.07.2016 pika 3.2.3.

“Menaxhimi i Riskut”

- Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se dhe nuk është hartuar plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit afatmesëm të Bashkisë Dimal, sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr.68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Dimal nuk punon me sistemin HRMIS, por me hedhje manualisht nëprogramin MicrosoftOfficeExcel në kundërshtim me përcaktime e manualit të MFK.
- Drejtoritë e tjera nuk punojnë me aplikacione dhe programe të posaçme për menaxhimin e të dhënave, por vetem me programet Word/Excel, duke krijuar hapësirë për cënimin e integritetit të dhënave që institucioni menaxhon dhe përpunon.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Nga komunikimi me personat përgjegjës në Bashkinë Dimal, u konstatua se institucioni nuk ka hartuar dhe miratuar Hartat e Proceset e Punës, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi 3.3, Udhëzimi nr. 16, dt.20.07.2016 pika 2.3.
- Konstatohet se** Bashkia Dimal nuk ka miratuar një plan pune vjetor të GMS lidhur me aktivitetet dhe çështjet që do të analizohen.
- Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit rezulton se në 12 procedura prokurimi për periudhën objekt auditimi, është caktuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Dimal, znj. M.B si anëtare e Njesisë së Prokurimit dhe hartimit të specifikimeve teknike, llogaritjes së fondit limit dhe hartimit të Dokumenteve të Tenderit. Zj. B.është në pozicion pune Drejtor i Dejtorisë së Ekonomisë dhe Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues, është njëkohësisht dhe anëtar dhe sekretar i Grupit të Menaxhimit Strategjik të institucionit. Vendosija e zj. M.B me detyrë shef finance dhe nëpunës zbatuesi i Bashkia Dimal, si kryetari i Njesisë së Prokurimit, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Çdo urdhër i titullarit për caktimin e në komisione të nëpunësit zbatues i cili bie ndesh me veprimtarinë, duhet të refuzohet nga ky i fundit, gjë e cila nuk rezulton të jetë kundërshtuar në asnjë rast. Veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, 12, pika 3, gërma 3), neni 22, pika 5, Rregulloren e brendshme të Bashkia Dimal miratuar me vendimin nr. 1043, datë 31.03.2021, Kreu 9, pika 6, e cila ndër të tjera përcaktohet se: *“Kontrollet pas faktit nuk kryhen nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit”*.
- Bashkia Dimal nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Bashkia Dimal nuk ka një sistem elektronik back-up për të dhënat e institucionit.

-Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT. Aktualisht Bashkia Dimal nuk ka një punonjës IT që të mbulojë këtë aspekt në institucion- -Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

-Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin MicrosoftOfficeExcel në kundërshtim me përcaktime e manualit të MFK.

“Informimi dhe komunikimi”

Nuk janë përditësuar raportet periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin e prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale.

Në zbatim të pikave 1.2 dhe 1.3 të programit të auditimit “nr. 121/1prot., datë 31.01.2023, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njesisë së AB të Bashkisë Dimal;
2. Planet Strategjike dhe vjetore, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Plani i auditimeve të brendshme për vitin 2022;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
6. Projekt-raportet dhe raportet përfundimtare të auditimit të brendshëm të njësive publike;
7. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Kriteret e Vlerësimit:

- 1) Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- 2) Urdhëri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”;
- 3) VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”
- 4) Urdhëri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”;
- 5) Ligji Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”
- 6) Normat Teknike Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.
- 7) Manuali i Auditimit të Brendshëm:

Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.

Në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, është krijuar njësia e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Ky sektor përgjatë periudhës 2022, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Vendim Këshillit Bashkiak nr.4, datë 02.02.2017, duke pasur në strukturën e saj tre punonjës. Përgjegjësi i kësaj njësie është z.Q.M.

Struktura e njësisë AB për periudhën 2022

Nr	2022	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime te vijueshme
1	Q.M	Përgjegjës	i lartë	38	6	i certifikuar	40 Ore
2	V.S	Specialiste	i lartë	8	5	në proces	
3	L.B	Specialiste	i lartë	5	3	në proces	

Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për periudhën 2022.

Përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, nga sektori i auditit të brendshëm pranë Bashkisë Dimal, janë kryer 6 auditime nga 7 të tilla të planifikuara, miratuar me planin e punës me nr prot. 2932 datë 19.10.2021.

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditim e ta planifikuara	Auditime te realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit				Të tjera
				Perputh	Financ	Kombi	Performace	
3	Viti 2022	7	6	6				

-Plani strategjik 2022-2024 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2022 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr.2932/1 prot. datë 19.10.2021.

Për aktivitetin e vitit 2022 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr.250/1 prot. datë 09.02.2023.

-Karta e Auditimit të Brendshëm është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë me nr.508 prot. datë 21.02.2019 dhe nuk ka pasur përditësime.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2022, rezulton se janë dhënë 37 rekomandime, nga të cilat janë pranuar të gjitha. Nga 37 rekomandimet e dhëna nuk është zbatuar asnjë, ndërkaq në proces zbatimi janë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Subjekti Audituar	Rek. të dhëna në vitin 2022	STATUSI I REKOMANDIMEVE				REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT					AUDITUESI
		Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandime të përmirësimit e sistemeve	Rekomandime të përmirësimit e kuadrit ligjor	Rekomandime të karakterit organizativ	Rekomandime për arkëtime	Rekomandime të tjera	
Drejtorit, Njësit dhe Sektorë të Bashkisë Dimal, Zbatimi i Rekomandime të Lëna nga auditimet e mëparshme !		1	1		1			1			
Sektori të Ndihmës Ekonomike dhe Qendrës Komunitare Multifunkionale dhe mbrojtjes së Fëmijës, të Bashkisë Dimal		2	2		2			2			
Drejtorin e Ekonomisë dhe Financës Auditim i përpunshmërisë financiare dhe i detyrimeve të prapambetura		5	5		5			5			
Drejtoria e Tatimeve dhe Menaxhimit të Aseteve në Bashkinë Dimal		5	5		5			5			
Drejtorin e Planifikimit të Territorit, Investimeve, Kontrollit të Projekteve, Shërbimeve Publike, Transportit, Administrimit të Ujrave, Diasporës Migracionit dhe Integritit Europian Auditim i Sektorit të E-Lejet		2	2		2			2			
"Drejtoria Juridike, Prokurimeve, Burimeve Njerëzore, Arkiv Protokollit dhe		2	2		2			2			

Subjekti Audituar	Rek. të dhëna në vitin 2022	STATUSI I REKOMANDIMEVE				REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT					AUDITUESI
		Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandime të përmirësimit të sistemeve	Rekomandime të përmirësimit të kuadrit ligjor	Rekomandime të karakterit organizativ	Rekomandime për arkëtime	Rekomandime të tjera	
Shërbimeve mbështetëse”, Auditim i Prokurimeve											
“Ujësjetës Kanalizime sh.a.”,		20	20		20			20			

Titulli i gjetjes: Mangësi mbi proceset/veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Situata: Nga auditimi e veprimtarisë dhe përbërjes së Sektorit të Auditimit të Brendshëm, u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.

-Niveli profesional i punonjësve në Sektorin e Auditimit të Brendshëm nuk është në standartin e përcaktuar nga ligji.

-Ka shmangie nga Planit Vjetor i miratuar nga titullari i institucionit, si dhe nuk është miratuar apo dokumentuar ndryshimi i Planit në Raportin Vjetor referuar Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

-Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njesisë vendore

-Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit.

-Në dosjet e auditimit të realizuar nga Njësia e Auditimit nuk është dokumentuar plani i veprimit.

-Nga shqyrtimi i një prej dosjeve të auditimit të përzgjedhura, u konstatua mungesa e një sërë dokumentash, të cilat parashikohen nga Manuali i Auditimit të Brendshëm.

Kriteret:

-Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, neni 12 pika b.

-Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, neni 13.

-Ligji nr. 114 dt. 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 11 pika ç.

-VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 3.

-Ligji nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm Publik” neni 14 pika ç.

-Normat Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19

-Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kreu VI, paragrafi 6.3.

-Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kreu IV paragrafi 4.1.13.

-Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kreu IV, paragrafi 4.1.

Shkaku: Njohja e përciptë e legjislacionit për auditimin e brendshëm

Ndikimi: Ulja e cilësisë së punës të Auditimit të Brendshëm në kontrollin e veprimtarisë ligjore të institucionit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Titullari i institucionit të miratojë Komitetin e Auditimit të Brendshëm në përputhje me ligjin dhe të certifikohen dy punonjësit e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, sipas kërkesave të Ligjit për Auditimin e Brendshëm.

- Dosjet e auditimit të arkivohen sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Më hollësisht trajtohen më poshtë problematikat e konstatuara e konkretisht:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me nenin 12, pika b dhe neni 13 i Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;

-Karta e Auditimit të Brendshëm është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016”;

-Për vitin 2022 niveli profesional i punonjësve në Sektorin e Auditit të Brendshëm nuk është sipas përcaktimeve të bëra në nenin 11 pika ç të Ligjit nr. 114 dt. 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, si dhe pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”. Sipas këtyre dispozitave numri i punonjësve të pa certifikuar si “Auditues i Brendshëm” nga autoritetet përkatëse, nuk mund të kalojë 1/3 e numrit total të punonjësve në Njësinë e Auditimit. Në Sektorin e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Dimal dy nga tre punonjësit janë të pa certifikuar. Për rrjedhojë përbërja e strukturës së Auditit të Brendshëm është në kundërshtim me çfare parashikojnë dispozitat e sipërcituara.

-Plani strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2022-2024, dhe është hartuar në përputhje me standardet e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe aneksin me modelin përkatës në fundin e kapitullit III.

-Plani vjetor i auditimeve për vitin 2022 është përgatitur në mënyrë të rregullt, në përputhje me paragrafin 3.2 të Kapitullit III të MAB, si dhe me modelet përkatëse në po këtë kapitull.

-Në planin vjetor të auditimit për vitin 2022, Sektori i Auditimit të Brendshëm kishte parashikuar të kryente 7 auditime, ndërkaq janë realizuar vetëm 6 prej tyre. Mos realizimin e Auditimit të Ujësjiellës SHA, përgjegjësi i Njësisë e ka argumentuar në Raportin Vjetor. Përveç numrit të auditimeve, në Planin Vjetor ishte parashikuar të realizohej edhe auditimi financiar përpos atij të përputhshmërisë, respektivisht në auditimin e Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financës dhe në atë të Ujësjiellës Kanalizimeve SHA (ku nuk u realizua as auditimi i përputhshmërisë për arsyen e përmendur më lart). Nga verifikimi fizik i dosjes së Auditimit për Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financës u konstatua se nuk ishte realizuar auditimi financiar në zbatim të Planit Vjetor të miratuar. Për sa më sipër konstatohet shmangie nga Plani Vjetor i miratuar nga titullari i institucionit, si dhe nuk është miratuar apo dokumentuar ndryshimi i Planit në Raportin Vjetor referuar Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Për sa më sipër është shkelur “ Ligji nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm Publik” neni 14 pika ç, sepse mungon arsyetimi mbi devijimin nga realizimi i planit.

-Plani strategjik 2022-2024 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2022 janë hartuar nga përgjegjësi i sektorit të auditimit të brendshëm. Këto dy raporte janë hartuar së bashku me njëra tjetrën, në një kohë kur ky format hartimi ku dy planet gjenden të integruara së bashku nuk parashikohet në Ligjin për Auditimin e Brendshëm, aktet nën ligjore apo Manualin për Auditimin e Brendshëm.

-Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2022, ka qenë përgjithësisht në përputhje me urdhërin nr, 4 dt. 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

-Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 dhe nenin 19 pika 1 e Normave Teknike Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë

-Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit, duke rënë në kundërshtim me paragrafin 6.3, Kreun 6 të Manualit të Brendshëm të Auditimit.

Shënim: Tabela e mëposhtme përmban 7 auditime, sepse Auditimi i Ujësjetës SHA është filluar në vitin 2021 dhe vazhdon në vitin 2022. Kjo e fundit rezulton të mos jetë përfunduar në vitin 2022.

Nr	Subjektet e Audituar	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Gjithsej	Auditime të realizuara sipas llojit të tyre						Statusi i Angazhimit		
			Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Këshillimi	Angazhime me kërkesë të titullarit	Angazhime të përfunduara	Angazhime në proces
			A. të përputhshmërisë	A. të performancës	A. financiare	A. tek. Informacionit	A. të kombinuara				
1	Drejtorit, Njësit dhe Sektorë të Bashkis Dimal, Zbatimi i Rekomandime të Lëna nga auditimet e mëparshme !	1	1						1		
2	Sektori të Ndihmës Ekonomike dhe Qendrës Komunitare Multifunksionale dhe mbrojtjes së Fëmijës, të Bashkisë Dimal	1	1						1		
3	Drejtorin e Ekonomisë dhe Financës Auditim i përputhshmërisë financiar dhe i detyrimeve të prapambetura	1	1						1		
4	Drejtoria e Tatim Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve në Bashkin Dimal	1	1						1		
5	Drejtorin e Planifikimit të Territorit, Investimeve, Kontrollit të Projekteve, Shërbimeve Publike, Transportit, Administrimit të Ujrave, Diasporës Migracionit dhe Integritimit European Auditim i Sektorit të E-Lejet	1	1						1		
6	"Drejtoria Juridike, Prokurimeve, Burimeve Njerëzore, Arkiv Protokollit dhe Shërbimeve mbështetëse", Auditim i Prokurimeve	1		1					1		
7	"Ujësjetës Kanalizime sh.a.",	1									

-Për vitin 2022, konstatohet se janë mbuluar me auditim 6 subjekte, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë në Planin Strategjik për Sektorin e Auditimit të Brendshëm, për vitin 2022-2024.

- Në dosjet e auditimit të realizuar nga Njësia e Auditimit nuk është dokumentuar plani i veprimit, i cili duhet të realizohet nga subjekti i audituar në vazhden e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit. Edhe pse vërtetohet se grupi i auditimit të brendshëm ka lënë për detyrë

hartimin e një plani veprimi për zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi fizik i disa prej dosjeve të përzgjedhura u konstatua mungesa e planeve të veprimit nga ana e subjekteve të audituara. Duke qenë se plani i veprimit nga ana e subjektit të audituar është fillimi i procesit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve nga ana e NJAB, duhet të ishte bërë një punë më këmbëngulëse nga kjo njësi për ecurinë e këtij procesi. Në dosjet e auditimit nuk janë konstatuar shpresa rikujtuese nga ana e përgjegjësit të njësisë së auditimit drejtuar njësive të menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Këto mosveprime bien në kundërshtim me Kreun IV paragrafi 4.1.13.1 të Manualit për Auditimin e Brendshëm.

-Nga informacionet në media dhe njoftimi publik i Strukturës së Posaçme Anti-Korrupsion, grupi i auditimit në Bashkinë Dimal u informua se disa zyrtarë dhe ish-zyrtarë të Bashkisë Dimal janë arrestuar nga organet e Policisë pasi dyshohen për kryerjen e disa veprave penale. Sipas burimeve mediatike, shkak për nisjen e procedimit penal është kallëzim i një shtetasi, banues në Bashkinë Dimal, lidhur me dhënien e një leje ndërtimi. Një nga shtetasit e arrestuar është z.A.P, drejtor i Drejtorisë së Drejtorisë së Planifikimit të Territorit. Nga dosjet e auditimit të administruara, u konstatua se kjo drejtori është audituar nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, duke verifikuar ligjshmërinë e dhënies së lejeve nga periudha 01.01.2020 deri në 30.06.2022.

Në dosjen e përzgjedhur për auditim, u konstatua se:

1.Në dosjen e auditimit të Drejtorisë Juridikepër periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, janë lënë 2 rekomandime. Nuk janë administruar: Formulari i Vlerësimit të Riskut, Reagimet për Auditimin nga subjekti i audituar duke shkelur Kreun IV, Paragrafi 4.1 të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Nuk është plotësuar formulari për buxhetin dhe afatin kohor të auditimit. Nuk është administruar një plan veprimi nga subjekti i audituar lidhur me rekomandimet e dhëna, për rrjedhojë nuk është zbatuar Rubrika Ndjekja e Rekomandimeve në zbatim të Kreut IV, paragrafi 4.1 i Manualit të Auditimit të Brendshëm. Nuk është pjesë e dosjes së auditimit njoftimi që duhet të kryejë drejtuesi i njësisë së auditimit ndaj titullarit të njësisë publike, në rastet kur subjekti i audituar nuk njofton për planin e masave.

2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhemonitorimin e planit të buxhetit.

2. 2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2021;

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID -19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Situacioni i shpenzimeve rakorduar me Degën e Thesarit;
- Situacioni i të ardhurave rakorduar me Degën e Thesarit;

- PBA dhe buxheti vjetor;
- Raportet e monitorimit;
- Vendimet e Këshillit Bashkiak “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Dimal”;
- Vendime të tjera të Këshillit Bashkiak, në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Dokumente të bankës etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet :

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022;

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallë e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i tavaneve të shpenzimeve sipas programeve, etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projekt buxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

Në 000/lekë

	Emërtimi	Faza e I PBA 2022	Faza e II PBA 2022	Projekt Buxhet 2022
600	Paga	167,220	167,220	173,169
601	Sigurime Shoqërore	28,522	28,522	30,420
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	110,056	110,056	113,255
604	Transferta Korente të brendshme	25,000	25,000	25,100
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	6,244	6,244	6,808
609	Frezerve emergjenca	21,200	21,200	11,076
I	Shpenzime Korrente	358,242	358,242	359,828
230	Kapitale të Patrupëzuara			7,850
231	Kapitale të Trupëzuara	124,114	124,114	149,178
	Shp. Kapitale me financim te brendshëm	124,114	124,114	157,028
Totali I Shpenzimeve		482,356	482,356	516,856

Për vitin 2022 buxheti bazë fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 82 datë 24.12.2021, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat me shkresën nr 905/3 datë 13.01.2022. Buxheti vjetor është miratuar brenda afateve që përcakton pika e nenit 41 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (brenda datës 25 dhjetor).

Në këtë VKB të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2022 kanë vlerën 257,881,000 lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 142,830,000 lekë, transfertat specifikë ka vlerën 88,868,000 lekë. Të ardhura të trashëguara nga viti i mëparshëm 27,276,000 lekë. Në total të ardhurat kanë vlerën 516,856,000 lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 516,856,000 lekë.

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetet për vitin 2022 sipas tabelave në vijim:

Tabela nr.1

Burimi: Bashkia Dimal

Gjatë vitit 2022, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2021). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me VKB nr.16, datë 28.02.2022 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Dimal për miratimin e buxhetit shtese për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2021, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 22,902,365 lekë.

- Me VKB nr.36, datë 04.07.2022 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Dimal për miratimin e buxhetit shtesë, të ardhura vendore financim nga Ministri i Shtetit dhe Sipërmarrjes, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 8,000,000 lekë.

- Me VKB nr.75, datë 13.12.2022 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Dimal për miratimin e buxhetit shtese për alokimin e fondeve grant i pakushtëzuar dhe specifik për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Përdorimi për investimet e objekteve :,

1. Blerje konteneri pastrimi në vlerën, 1,800,000 lekë;
2. Studim Projektim për godinën e Bashkisë në vlerën, 2,340,000 lekë;
3. Studim projektim rrugët në vlerë 862,400 lekë;
4. Rikonstruksion i sheshit të lagjes “18 Tetori” në vlerë 5,000,000 lekë;
5. Likuidim për rikonstruksion rruga për në Dimal në vlerën 6,995,042 lekë;
6. Rikualifikim i zonës së llixhave lagjia “ 28 Nëntori” në vlerën 751,558
7. Likuidim objekti “ rikonstruksioni i rrugës unaza e re” në lagjen “28 Nëntori” në vlerën 10,000,000 milion lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për investime për vitin 2022 ka vlerën 212,517,000 lekë, realizimi i këtij plani është, në vlerën 157,618,245 lekë në 74.17%. Nuk janë realizuar në shumën prej 54,898,755 lekë, si rezultat i mos realizimit të ardhurave të parashikuara. Kanë mbetur disa objekte të parealizuara sipas parashikimit të domosdoshme këto për komunitetin, të miratuara në buxhet, si: Rikonstruksion pallati i kultures Drenovice per tu pershtatur kopësht, Hartim Projekt-Preventiv për rikonstruksion të plote dhe shtesë të shkollës Ciflik, Rikonstruksion pallati I kulturës Drenovicë për tu përshtatur kopësht, Rikonstruksion rruge në lagjen " 18 Tetori ", E. A. Ura-Vajgurore, Ndërtim Ure mbi lumin Osum Ura-Vajgurore, Guri i Bardhë (Lagja 28 Nëntori) etj.

Pasqyra përmbledhëse për planifikimin e buxhetit për vitin 2022 në 000/lekë paraqitet në (Aneksin nr.1) bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

-Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plan përfundimtar 2022	Sipas PBA 2022-2024	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601)	205,289	195,742	-9547
2	Shpenzime (602.604.609)	172,041	162,500	-9541
3	Investime Bashkia	212,517	124,114	-88403
4	Investime nga FZSH	0	0	0
	Total i planit fillestar	589,847	482,356	-107,491
	Shtesat nga Pushteti Qendror	279,271	279,271	0
5	Investime	104,903	103,603	0
6	Shpenzime për pagat	3,115	3,102	0
7	Shpenzime operative	171,197	168,721	0
	Gjithsej	869,118	761,527	-107,491

Burimi: Bashkia Dimal

Konkluzione:

Plani përfundimtar i buxhetit ka diferenca prej 107,491 mijë lekë nga plani në PBA për shkak se në planin përfundimtar janë pasqyruar rritja e grantit të pakushtëzuar, transfertat specifike lekë dhe të ardhurat e trashëguara të cilat për shkak se alokohen pas miratimit të buxhetit fillestar, nuk janë pjesë e këtij të fundit.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë viteve janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/ paksime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla. Tabela e ndryshimeve në buxhetin 2022 paraqitet në vijim në 000/lekë:

Tabela nr. 2

Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022 dhe rishpërndarja e fondeve										
Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar	Buxheti shtesë				Shtesat dhe Pakësimet në buxhet në total	Rishpërndarjet : Shtesa/ Pakësime të Buxhetit			Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	miratuar me VKB nr. 82 dt 24.12.2021	Miratuar me VKB nr. 16 datë 28.02.	Miratuar me VKB nr. 48 dt 19.09.2022	Miratuar me VKB nr 75 dt 13.12.2022	Shkresat e Ministrise se Financave Nr. 130 dt		Miratuar me VKB nr. 36 dt. 04.07.2022	Miratuar me VKB Nr.46 dt. 15.08.2022	Rishpërndarje total	

		2022			05.01.2 3					
	1	2	3	4	5	7=2+3+4+ 5+6	8	9	12=8+9+10 +11	13=1+7+12
Art. 600 Paga	173,169	1,700				1,700				174,869
Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	30,420	0				0				30,420
Art.602 Shpenzime operative	113,255	2,702		13,000		15,702		-240	-240	128,717
Art. 603 Sponsorizime	0	0				0				0
Art.604 Transferime korrente të brendshme	25,100					0				25,100
Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	6,808				1,340	1,340				8,148
Art. 230-231 Investime	157,028	18,500	8,000	27,749		54,249	1,000	240	1,240	212,517
Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	11,076	0				0	-1000		-1000	10,076
TOTALI SHPENZIMEVE	516,856	22,902	8,000	40,749	1,340	72,991	0	0	0	589,847

Burimi: Bashkia Dimal

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2022, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Plani dhe fakti i buxhetit te Bashkisë viti 2022 000/lekë

Art.	Emertimi	Plan	Fakti	%
600	Paga	177,579	169,402	95,40%
601	Sigurime Shoqërore	30,860	28,410	92%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	125,693	116,084	92.15%
604	Transferta Korente të Brendshme	5,201	5,201	100%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	178,084	172,246	97%
609	Fondi Rezervë	3,076	0	0%
230	Kapitale të Patrupëzuara	104,44	9,844	94%
231	Kapitale të Trupëzuara	296,523	251,377	84.77%
	TOTAL	827,461	752,188	90.91%

Konstatohet se plani i buxhetit i gjeneruar nga thesari ka vlerën 548,191,180 lekë e cila nuk përputhet me vlerën e planit të buxhetit të miratuar nga këshilli bashkiak që ka vlerën 589,847,000 lekë, ose 40,456,000 lekë më shumë se plani buxheti i gjeneruar nga thesari.

Më poshtë paraqitet buxheti përfundimtar plan-fakt për vitin 2022.

Tabela nr. 4

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt. Në 000/lekë									
N r.	Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi ne %	Nga të ardhurat e veta	Burimi i financimit të shpenzimit të realizuar			
						Nga Granti Qeveritar			
						Nga transfertat e pakushtëzuar	Nga transfertat e kushtëzuar specifike	Nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara	Nga transfertat e kushtëzuar për investimet
1	Paga600	177,579	169,401	95.39	79,530	28,300	58,868	2,702	0
2	Sigurime shoqërore 601	30,860	28,411	92.06	0	17,906	10,105	400	
3	Shp. Operat602	125,693	116,084	92.35	74,248	25,172	16,754	0	
4	Fond. Emergj . 609	3,076	0	0					
5	Transferta Korrente te brendshme 604	5,201	5,201	100				5,201	
6	Transferta per familje dhe individe 606	178,084	171,870	95.51 %	7,346	0	1,380	163,144	
7	Investime 230-231	306,967	261,221	85.1%	30,754	118,067	87,97		10,3603
	Totali	827,461	752,188	90.9%	191,878	189,455	95,904	171,448	103,603

-Planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transfertat e pa kushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën **827,461 mijë** lekë, ndërsa realizimi **752,188 mijë** lekë, ose në masën 90.9%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën 177,579 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 169,401 mijë lekë, ose në masën 95.3%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 92%.

-Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën 125,693 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 116,084 lekë, ose në masën 92.3 %.

-Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 306,967 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 261,221 mijë lekë, ose në masën 85.1 %.

Konkluzion: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 me të ardhurat e veta (pa transfertën e palushtëzuar) të Bashkisë Dimal ka diferencë të me vlerën e planifikuar.

Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën 335,674,180 lekë, ndërsa realizimi në vlerën 319,520,908 lekë, ose në masën 95,16%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë shtë planifikuar në vlerën 212,517 mijë lekë, realizuar 157,618 mijë lekë, ose në masën 74,16 %.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Dimal në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe ngarkojnë me përgjegjësi kryetaren e bashkisë Dimal znj. J.Mj, si dhe znj. M.B, me detyrë Drejtore e Financës.

Gjithashtu edhe gjatë vitit 2022 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2022.

Titulli i gjetjes: *Mangësi në programimin dhe zbatimin e buxhetit për vitin 2022.*

Situata: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 me të ardhurat e veta (pa transfertën e palushtëzuar) të Bashkisë Dimal ka diferencë me vlerën e planifikuar.

Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën 335,674,180 lekë, ndërsa realizimi në vlerën 319,520,908 lekë, ose në masën 95,16%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë shtë planifikuar në vlerën 212,517 mijë lekë, realizuar 157,618 mijë lekë, ose në masën 74,16 %.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Dimal në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Kriteri: Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.

Ndikimi: Në treguesit e gjendjes ekonomike dhe financiare të Bashkisë Dimal dhe performancës në përgjithësi.

Shkaku: Zbatimi jo i duhur i legjislacionit në fuqi dhe metodologjisë në zbatimin e buxhetit vjetor. Mos zbatimi i kërkesave ligjore për kontabilitetin me efekt rritjen e detyrimeve kreditore dhe mos programimi si zë më vete në buxhet për shlyerjen e tyre.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Bashkia Dimal, të marrë masat për programimin e buxheteve afatmesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore. Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.

Fondi rezervë

Bazuar në pikën 6 neni 40 i nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenit 6 të ligjit nr. 9936, datë 26. 06. 2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, është planifikuar fondi rezervë deri në 3% të totalit të shpenzimeve të planifikuara (duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara).

-VKB nr 34 datë 04.07.2022 konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut me shkresën nr 498/1 datë 07.07.2022, përdorim fondi rezervë në masën 1,000,000 lekë, për Fiskalizimi i faturave elektronike të ndërmarjes së Ujësjellës Kanalizimi SHA Ura Vajgurore.

Subvencionet

Në vitin 2022 Bashkia Dimal ka marrë subveccion për ndërtimin e një shkolle 9-vjecare në Njësinë Administrative Poshnje në fshatin Ciflik. Kontrata e lidhur me Donatorin IADSA është në shumën 40,608,800 lekë, për vitin 2022 është financuar në masën 20,453,000 lekë.

Objekti ka përfunduar është vënë në funksion. Sipas raportimit nga Drejtoria e Financës, Bashkia Dimal nuk ka dhënë subvencione për vitin 2022.

2.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizmit të të ardhurave (faturat e pa likujduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE)

Detyrimet e prapambetura viti 2022

Vlera e raportuar nga Bashkia Dimal në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2022 është në vlerën 266,150,796 lekë.

Nuk ka diferenca midis vlerës së detyrimeve të prapambetura të raportuar në MFE dhe me vlerën e rakorduar me të dhënat e e disponuara nga KLSH. Bashkia Dimal në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 101,357,088 lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti vlera 101,357,088 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 91,926,520 lekë, ose 90,69% e vlerës së planifikuar, diferenca prej 9,430,568 lekë e pa likuiduar gjatë vitit 2022. Por gjatë vitit 2022 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 137,394,223 lekë, duke e çuar në 31.12.2022 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 146,824,791 lekë. Peshën kryesore të detyrimeve e zënë ato për investime në vlerën 122,634,948 lekë, ose në masën 83% të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta bashkisë.

Pra, në datën 31.12.2022 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022) është rritur me 45,467,703 lekë, ose në masën prej 44%.

Përveç sa më lartë më 31.12.2022 Bashkia Dimal ka krijuar detyrime të tjera të reja gjatë vitit 2022, me burim financimi nga granti (FZHR), të cilat janë detyrime për dy ujësjellës, në vlerën 119,326,005 lekë, duke çuar vlerën totale të detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022 në 266,150,796 lekë.

Peshën kryesore të detyrimeve totale (së bashku me detyrimet e FZHR) e zënë ato për investime në vlerën 223,961,553 lekë, ose në masën 84% të totalit prej 266,150,796 lekë.

Të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më 31.12.2022 jepen në rubrikën *Aneksin nr.1/1 bashkëlidhur PRA*), ndërsa të konsoliduara paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela nr.5 Në/lekë

Emertimi i detyrimit te prapambetura	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2021	Vlera e planifikuar për likuidim në planin e buxhetit 2022 për detyrimet e prapambetura	Vlera e paguar gjatë vitit 2022 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2020 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2022)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2022 (situata më 31.12.2022)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur a më 31.12.2022
2	3	4	5	6=3-5	7	8=6+7
I. Detyrime që kanë si burim financimi të ardhurat e veta						
Detyrime për vendime gjyqësore	15,640,021	7,000,000	6,500,000	9,140,021	0	9,140,021
Detyrime për shërbime	17,493,834	11,942,184	11,801,789	4,744,582	1.242.702	5,987,284
Detyrime për mirembajtje	8,595,954	6,595,954	3,695,890	4,327,724	3.112.650	7,440,374
Detyrime për investime	50,916,417	50,916,417	42,064,506	10,446,729	94.189.819	104,636,548

Detyrime për mallra	8,710,862	6,710,862	4,871,228	7,311,222	2,674,288	9985510
Detyrime të tjera	0			0	9,635,054	9,635,054
Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta	101,357,088	83,165,417	68,933,114	35,970,278	110,854,513	146,824,791
Detyrime për Investime nga Ministrite e Linjes (Min. e Infrastruktues)	32,151,954	32,151,954	22,993,406	9,158,548	110,168,057	119,326,605
Detyrime për vendime gjyqësore (Min. e Brendshme per punonjes te GJ.Civile)	0	0	0	0	0	0
Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi nga (Fzhr)	32,151,954	32,151,954	22,993,406	9,158,548	110,168,05	119,326,605
Detyrime ne total nga të ardhurat e veta + granti		133,509,042				266,151,396

Burimi: Bashkia Dimal

Konkluzione:

Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Janë marrë ditari i bankës për shpenzimet e kryera gjatë periudhës Janar – Maj të vitit 2022 ku ka rezultuar se: Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga Dega e Thesarit, rezulton se gjatë vitit 2022 janë likujduar 23 raste në shumën **32,531,665 lekët** cilat i përkisnin si datë fature vitit 2019 një faturë dhe 22 fatura të vitit 2021, ndërkohë që janë regjistruar si fatura gjatë vitit 2022 për tu likujduar. Më poshtë në formë tabelare paraqiten faturat e konstatuara:

Tabela nr. 6 Në lekë

PERSHKRIMI LLOGARISE EKONOMIKE	Furnitori	Shuma	Data_Furnitorit	Data_Urdher_Shpenzimit	Regjistruar Në Thesar	Data_ekzekutimit
Shpenz.per miremb.e rrugeve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike, elektrike, telefonike, ngrohje etj	H. S.	583,350	23-SEP-21	24-FEB-22	24-FEB-22	28-FEB-22
Shpenz.per miremb.e rrugeve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike, elektrike, telefonike, ngrohje etj	H.S	583,350	25-OCT-21	24-FEB-22	24-FEB-22	28-FEB-22
Shpenz. per rritjen e AQT - kamione dhe mjete transporti te renda	L.M.	2,300,000	14-OCT-21	17-MAR-22	17-MAR-22	24-MAR-22
Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rrugeve	T.	8,130,000	31-JUL-19	17-MAR-22	17-MAR-22	23-MAR-22
Shpenz. per rritjen e AQT - ndertesa shkollore	F.	2,904,823	12-APR-21	18-MAR-22	18-MAR-22	28-MAR-22
Shpenz. per rritjen e AQT - ndertesa shkollore	F.	82,540	12-APR-21	18-MAR-22	18-MAR-22	28-MAR-22
Shpenz. per rritjen e AQT - ndertesa shkollore	F.	54,756	12-APR-21	18-MAR-22	18-MAR-22	28-MAR-22
Shpenz. per rritjen e AQT - ndertesa shkollore	F.	50,000	12-APR-21	18-MAR-22	18-MAR-22	28-MAR-22
Shpenz. per rritjen e AQT - ndertesa shkollore	F.	4,681	12-APR-21	18-MAR-22	18-MAR-22	28-MAR-22
Shpenz.per miremb.e rrugeve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike, elektrike, telefonike, ngrohje etj	B.	379,920	30-JUL-21	24-MAR-22	24-MAR-22	31-MAR-22
Karburant dhe vaj	G.	300,000	30-AUG-21	28-MAR-22	28-MAR-22	05-APR-22
Karburant dhe vaj	G.	100,000	30-AUG-21	28-MAR-22	28-MAR-22	05-APR-22
Karburant dhe vaj	G.	366,819	30-AUG-21	28-MAR-22	28-MAR-22	05-APR-22
Karburant dhe vaj	G.	214,109	30-AUG-21	28-MAR-22	28-MAR-22	05-APR-22
Karburant dhe vaj	G.	685,891	31-JUL-21	28-MAR-22	28-MAR-22	05-APR-22
Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit	E.K	1,664,563	16-JUL-21	29-MAR-22	29-MAR-22	08-APR-22
Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit	E.K	1,674,039	04-AUG-21	29-MAR-22	29-MAR-22	05-APR-22
Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit	E.K	3,191,076	30-SEP-21	29-MAR-22	29-MAR-22	08-APR-22
Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rrugeve	K.	1,947,830	21-JUL-21	11-APR-22	11-APR-22	22-APR-22
Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rrugeve	K.	306,775	21-JUL-21	11-APR-22	11-APR-22	22-APR-22

Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rrugeve	K.	1,707,143	21-JUL-21	11-APR-22	11-APR-22	22-APR-22
Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rrugeve	K.	3,300,000	21-JUL-21	11-APR-22	11-APR-22	22-APR-22
Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime operative	S.K.V	2,000,000	15-SEP-21	27-APR-22	27-APR-22	05-MAY-22

Konkluzione:

Këto veprime janë jo në përputhje me parimet, udhëzimet dhe rregullat kontabël për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare, dhe sistemin buxhetor për të cilat auditimi gjykon se kanë ndikuar në mosparaqitjen e vërtetë dhe të sigurtë, të saktë dhe të besueshme të pasqyrave financiare për shpenzimet e kryera për vitet paraardhëse duke rritur detyrimet në këtë mënyrë në vitet pasardhëse pasi, regjistrimi i transaksioneve/veprimeve është bërë kur janë paguar dhe jo kur ato kanë ndodhur si ngjarje pra duke vepruar mbi baza cash në lidhje me këto shpenzime dhe jo mbi parimin e të drejtave dhe detyrimit të konstatuar. Kjo ka ardhur si pasojë e marrjes së angazhimeve duke mos patur fonde buxhetore në dispozicion duke mos lejuar ekzekutimin e tyre. Pra duke mos patur fonde faturat nuk deklarohen si të pagueshme brenda 30 ditëve, por mbahen të pa regjistruara deri në hapjen e fondeve të nevojshme për pagesën e tyre, çka do të thotë se strukturat përgjegjëse kanë patur dijeni për këto detyrime dhe duke mos patur fonde në dispozicion, kanë shlyer vetëm një pjesë të tyre. Këto veprime çojnë në prishjen e hallkave të kontrollit të brendshëm në lidhje me parandalimin dhe detektimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Veprime të cilat janë jo në përputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 61 dhe neni 54, “Kryerja e pagesave”, Ligjin nr. 25 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15 pika 1 dhe nenin 11 pika 1, Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pikën 164.

Titulli i gjetjes : Mos likuidim në kohë i faturave.

Situata: Vlera e raportuar nga Bashkia Dimal në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2022 është në vlerën 266,150,796 lekë. Bashkia Dimal në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 101,357,088 lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta, dhe Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti **32,151,954 lekë nga investimet e FZHR-së**, vlera 101,357,088 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 91,926,520 lekë, ose 90,69% e vlerës së planifikuar, diferenca prej 9,430,568 lekë e pa likuiduar gjatë vitit 2022. Por gjatë vitit 2022 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 137,394,223 lekë, duke e çuar në 31.12.2022 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 146,824,791lekë. Peshën kryesore të detyrimeve e zënë ato për investime në vlerën 122,634,948 lekë, ose në masën 83% të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta bashkisë.Pra, në datën 31.12.2022 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022) është rritur me 45,467,703 lekë, ose në masën prej 44%.

Përveç sa më lartë më 31.12.2022 Bashkia Dimal ka krijuar detyrime të tjera të reja gjatë vitit 2022, me burim financimi nga granti (FZHR), të cilat janë detyrime për dy ujësjellës,në vlerën 119,326,005 lekë, duke çuar vlerën totale të detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022 në 266,150,796 lekë. Peshën kryesore të detyrimeve totale (së bashku me detyrimet e FZHR) e zënë ato për investime në vlerën 223,961,553lekë, ose në masën 84% të totalit prej 266,150,796 lekë.

Kriteri:Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 61 dhe neni 54, “Kryerja e pagesave”, Ligjin nr. 25 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15 pika 1 dhe nenin 11 pika 1,

Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pikën 164.

Ndikimi: Në treguesit ekonomik dhe financiar të Bashkisë.

Shkaku: Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Dimal të marrë masa për hartimin sa më real të buxhetit, mbështetur në realizimin sa më objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve duke pasur parasysh shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

Bashkia Dimal për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën 9,920,574 lekë, nga e cila vlera 420,574 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim mospagese në afat, faturë shërbimi 332,894 lekë dhe për 1 rast dhe gjobë të INUV 87,680 lekë për 1 rast, ndërsa vlera 6,500,000lekë për 1 rast i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore, njëri prej të cilëve lidhet me dëmshpërblim për shlyerje të vonuar investimi nga fondet e buxhetit të shtetit (FZHR), ndërsa vendimi tjetër me objekt dëmshpërblim për probleme pronësie. Si rezultat i fenomenit të mos likuidimit në kohë të detyrimeve kontraktuale nga fondet e buxhetit të shtetit (FZHR), Bashkia Dimal ka administruar vendimin gjyqësor nr. 2270 datë 05.02.2019, me objekt dëmshpërblim për shlyerje të vonuar investimi, vlerë të vendimit 16,640,021 lekë, kreditor subjekti G.K ShPK, prej të cilit gjatë vitit 2022 është likuiduar vlera 6,500,000 lekë, ndërsa vlera 9,140,021 lekë është detyrim për tu shlyer në vijim.

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për vitin 2022 janë financuar me fonde të buxhetit të shtetit 5 investime publike, për 4 prej të cilave kontrata është lidhur në vitin 2020, ndërsa për 1 investime kontrata është lidhur në vitin 2021, sipas të dhënave në tabelën në vijim:

Tabela nr.7 Në lekë

Nr	Objekti i prokurimit	Kontrata nr..datë	Vlera e plotë me TVSH	Vlera e likuiduar	Vlera e pa likuiduar	Arsyet e mos likuidimit
1	Rrjeti i shperndarjes Ura Vajguore	16.10.2020 S. shpk	71,774,494	45,000,000	0	Likuidim i plotë
2	Supervizim punimesh per objektin Rrjeti i shperndarjes Ura Vajguore	16.10.2020/A.A-M.	1,739,783	1,739,783	0	Likuidim i plotë
3	Rrjeti i Brendshem dhe i jashtem Njesia Cukalat Bashkia Dimal	16.10.2020 S. shpk	238,203,283	88,341,009	149,862,274	Mungesë fondi
4	Supervizim punimesh per objektin Rrjeti I brendshem dhe i jashtem Njesia Cukalat Bashkia Dimal	16.10.2020 /I.K.	3,132,505	1,142,477	1,990,028	Mungesë fondi
5		28.09.2021/Z.	7,884,382	7,884,382	0	Likuidim i

	Ndertim banesa sociale	SHPK			plotë
			322,734,447		151,852,302

Nga lista e mësipërme në vlerën 151,852,302, bënë pjesë edhe vlera e detyrimit 119,326,005 lekë, e cila përfaqëson vetëm detyrimin për të cilin janë prerë faturat tatimore.

Për sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr.2 dhe subjekti i audituar nuk ka paraqitur kundërshtime.

Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2022, ngarkohet me përgjegjësi kryetare e Bashkisë Dimal znj. J.M, në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. M.B, me detyrë drejtor i financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

2.6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

U shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Dimal për miratimin e paketave fiskale të vitit 2022, me ndryshime;
- Dokumentacioni i sektorit të taksave dhe tarifave vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga Programi Excel i mbajtjes së sistemit të taksave, dosje fizike të mbajtura për subjektet tatimpagues;
- Relacione periodike të punës së kryer për periudhën objekt auditimi nga specialistët e pranim-faturimit dhe specialistët e kontrollit në terren dhe evidencat e korespondencat zyrtare për ndjekjen e debitorëve;
- Kontrata, aktmarrëveshje, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, për taksat dhe tarifave vendore;
- Miratimet e buxheteve në lidhje me planifikimin e të ardhurave për vitin 2022;
- Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimin faktik të të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacioni në lidhje me agjentët tatimorë, rakordimet me ta, me thesarin, etj.;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe zyra e tatim-taksave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatua:

➤ **Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.**

Për vitin 2022, Bashkia Dimal ka miratuar Strukturën dhe Organigramën e saj me Vendimin 224 datë 21.01.2022, ku përfshihet edhe struktura e drejtorisë së Tatim Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve, e cila përbëhet nga 13 punonjës, me përbërje: 1 Drejtor, 3 specialistë dhe 9 Inspektorë.

Struktura e Drejtorisë të Ardhurave Lokale për vitin 2022 është paraqitur në tabelënmë poshtë:

Nr.	Emër Mbiemer	Pozicioni	Ndryshimi gjatë 2022	
1	I.S	Drejtor	1017/7 dt. 15/04/2020	
2	L. H	Sp/ Tatim Taksave	2791 Dt. 11/10/2019	1778/2 dt 01.07.2022 emërohet përgjegjes i sektorit te Tatim Taksave
3	M.G	InspektoriTatimTaksave	2323/1 Dt.09.08.2021	
4	S.D	Inspektor	30, dt. 10.08.2007	
5	B.P	InspektoriTatimTaksave	2849/8 Dt. 01.11.2019	
6	A.K	InspektoriTatimTaksave	1053/17 Dt.18.07.2018	
7	Xh.V	InspektoriTatimTaksave	2204/1 Dt. 27.10.2016	
8	M.B	SpecialisteNjësia Administrative Kutalli	2791/1 datë 16/10/2019	
9	L.C	InspektoriTatimTaksave	430/13 datë 01.03.2016	Larguar shkresa nr 1435/1 prot. Datë 17/05/2022

10	A.L	InspektoriTatimTaksave	2205/1,datë 01.07.2021	
11	D.K	InspektoriTatimTaksave	2849/15datë 01.11.2019	
12	E.H	InspektoriTatimTaksave	26///2 dt. 23.11.2022	
13	M.S	Specialist per menaxhimin e asetëve	1778/10 datë 15/11/2022	

Burimi: Bashkia Dimal

Konstatohet se: DTV Bashkia Dimal megjithëse ka rritur lehtësisht arkëtimet ka mangësi në funksion të realizimit të ardhurave. Masat Shtrenguese nuk kanë qenë në nivelin e duhur dhe jo efektive, pasi evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të paarkëtuara (debitor), në vlerën progresive **317,757 mijë lekë**, nga e cila: subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore në vlerë 69,920 mijë lekë për 125 subjekte, si dhe abonentë familjarë dhe tokë bujqësore në vlerë 199,755 mijë lekë, në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me shkresën nr. 737 prot datë 07.02.2018.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2022, Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 80, datë 24.12.2021, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat. Nga të dhënat e **e disponuara të cilat paraqiten aneks nr. 2.6/1** më poshtë, shihet se për vitin 2022 planifikimi i të ardhurave është në vlerën **257, 881** mijë lekë të planifikuara, janë realizuar **180,975** mijëlekë ose 70 %, mos realizim në vlerën **76,906** mijë lekë, kryesisht në taksat e popullatës, si p.sh. taksa e tokës bujqësore, taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërimit. Konstatohet se:

-Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mos patur një databazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit. Drejtoria e të Ardhurave, duke mospatur një bazë të dhënash nuk ka bërë rakordime me Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat (DRTB), Agjensinë Shtetërore të Kadastrës Berat (ASHKK) dhe Drejtorinë e Shërbimit të Transportit (DSHTR).

Taksë e tokës, taksë ndërtesë, tarifë pastrimi, ndriçimi dhe gjelbërimi, për abonentët familjarë Bashkia Dimal e realizon nëpërmjet agjentit tatimor që në rastin konkret është UK Dimal, sipas kushteve të akt-marveshjes, në të cilën sanksionohet të përfshijë në faturën e ujit për kategorinë abonentë “Familjarë” detyrimet për Taksa e tarifa si më sipër.

Akt rakordimet me agjentët tatimorë nuk janë mbajtur sipas formatit të përcaktuar me Udhëzim të posaçëm nga Ministria e Financave. Rakordimet janë bërë në formë proces-verbalesh, duke marrë informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve, por nuk mund të konsiderohen rakordime pasi nuk ka asnjë të dhënë statistikore në bazë të së cilës të bëhen llogaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 117 “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”, ku përcaktohet se: “Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifën e mbledhura, apo i shmanget mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhura apo të shmangu.”, UMF Nr. 26, datë 4.9.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, Formularët e akt-rakordimeve.

Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2022” paraqitet më hollësisht në **Aneks nr.2.6/1**

➤ **Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:**

Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimit nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (*Drejtoria Rajonale Tatimore, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Dimal, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura*) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të bashkisë Dimal dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Berat.

Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është Ujësjetllës-Kanalizime sipas marveshjes së bashkëpunimit me nr. 128/1 prot datë 23.01.2018 protokolluar në bashkinë Dimal. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime krahasuar me vitin e kaluar pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duket se vjen si mangësi e planifikimit jo mbi baza reale por sipas regjistrimit të gjendjes civile.

- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave.

- Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithëshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare”

Konstatohet se sipas DTV Bashkia Dimal, mos arkëtimet nga ana e Drejtoria Rajonale Vendore ASHK Berat, janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Dimal është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektsh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër, Bashkia Dimal duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme. Gjithashtu Bashkia Dimal, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Nënin 117⁴ të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”.

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë gjatë periudhës së audituar janë paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë:

AGJENTI TATIMOR	LLOJI I TAKSES	2022/ lekë
DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE	TatimiThjeshtuarmbiFitimin e BV	93,101
DPRSHTRR	Taksavjetore e mjetevetëpërdorura	18,161,575
UJESJELLES KANALIZIME	Taksadhe Tarifa Familjare, T.Pastrimi, ndricimi, gjelberim, arsim, toke bujqesore, T.ujitje dheKullim, Tarife, mirambajtje, infransimore)	20,294,054

	TOTAL	38,548,730
--	-------	------------

Burimi: *Bashkia Dimal*

➤ **Detyrimet e familjarëve:**

Mënyra e parashikimit të detyrimeve të familjarëve

Tarifa e pastrimit parashikohet në bazë të numrit të familjeve rezidente aktive të bashkisë.

Taksa e ndërtesës parashikohet në bazë të regjistrimit të taksës që kanë njësitë, të përditësuar me numër njësi pronësie të reja, saktësim dhe shtim sipërfaqesh.

Nga auditimi u konstatua se bashkia Dimal ka lidhur kontratë me Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Dimal për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësitë e mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime.

-Njoftimet e bëra për familjarët, masat e maradhe masat shtrënguese.

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifatat vendore.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërënga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Nga auditimi i të dhënave, rezultoi se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë për abonentët familjarë në vlerë progresive **131,553,676 lekë, pa përfshirë taksën e tokës, ndërsa detyrimet e vitit ushtrimorë janë në vlerën 36,946,754 lekë** sipas rakordimit me Drejtorinë e Financës. Vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Dimal, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjarë deri në datën 31.12.2022. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar.

Në **Pasqyrën** më poshtë janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifatat vendore të vitit ushtrimor 2022 si vijon: Debitor familjarë në nr., dhe lekë (pa përfshirë taksën e tokës bujqësore).

Nr	Njësi Administrative	Progresive deri në 31.12. 2021		Debitorë krijuar gjatëvitit 2022		Progresive deri në 31.12.2022	
		Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë
1	UraVajgurore	1,250	22,445,144	1,903	6,030,254	1,903	20,023,260
2	Kutalli	2,874	51,629,680	2,227	13,290,220	2,348	56,635,954
3	Poshnje	2,809	33,905,592	1,526	11,860,860	1,526	36,225,617
4	Cukalat	1,135	16,609,261	775	5,765,420	775	18,668,846
	TOTAL	8,068	124,589,677	6,431	36,946,754	6,552	131,553,676

Burimi: *Bashkia Dimal*

➤ **Taksa bujqësore:**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore për vitin 2022, u konstatua se kishte rezerva në planifikim, pasi sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit të AMTP, mbi ndarjen e tokës bujqësore për familje dhe

boniteti, evidentohet planifikim në vlerën 23,496mijë lekë, konkretisht sipas aneksit nr. 2.6/2 bashkëlidhur në rubrikën anekse.

Pritshmëria e taksës së tokës bujqësore për vitin 2022.

Aneksi nr. 2.6/2

Kategoria e tokës	Sip/HA UraVajg urore	Sip/HA Nj.A. Kutalli	Sip/HA Nj.A. Poshnje	Sip/HA Nj.A. Cukalat	Sip/HA Total bashkia	Vlera/Ha	Plani/Lekë
Kategoria I	231	x	745	x	976	4200	4,099,200
Kategoria II	258	862	410	x	1530	3500	5,355,000
Kategoria III	95	332	1168	x	1595	2800	4,466,000
Kategoria IV	132	x	263	x	395	2300	908,500
Kategoria V	584	1837	127	x	2548	1900	4,841,200
Kategoria VI	x	620	273	x	893	1600	1,428,800
Kategoria VII	x	x		1713	1713	1400	2,398,200
Kategoria VIII	x	x		x	x	x	x
e. Totali sip. ha sipas planifikimit	1300	3651	2986	1713	9650	x	23,496,900

Burimi: *Bashkia Dimal*

-Më poshtë paraqiten në mënyrë progresive paraqiten vlerat e trashëguara në celje të periudhës 2022, gjithashtu dhe maturimi, likuidimi dhe mbetja në fund të vitit 2022 sipas njësive administrative numrit të poseduesve dhe sipërfaqes së tokës bujqësore. Për sa është konstatuar ka një menaxhim të përmirësuar në arkëtime duke mbajtur nën kontroll debitorët, gjithsesi vlera prej 68,201,327 lekë është sërish një vlerë që duhet arkëtuar dhe jo mbajtur në të njëjtin nivel.

NJ.A.	Debitorë krijuar në vitin 2022 (Lekë)						TOTAL DEBIA PROGRESIVE 2022
	Debitor të trashëguar deri në fillim të vitit 2022	Familje me tokë bujqësore	Sip (m2)	Maturimi	Likuidimi	Debia 2022	
Ura Vajgurore	5,663,274	1,231	13,000,000	5,663,274	1,384,213	1,152,412	5,186,108
Kutalli	24,452,384	2,881	36,510,000	24,452,384	3,330,409	5,505,288	26,627,263
Poshnje	30,008,600	2,493	29,860,000	30,008,600	7,614,394	5,279,552	28,122,175
Cukalat	8,464,476	990	17,130,000	8,464,476	1,932,513	1,754,189	8,265,781
Total	68,588,734	7,595	96,500,000	68,588,734	14,261,529	13,691,441	68,201,327

Burimi: *Bashkia Dimal*

➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Administrimi i taksave vendore nuk bëhet me program, nuk janë të pasqyruara regjistrat, sipas aktiviteteve, njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që kërkohen për auditim, konstatohet se informacionet që kërkohen të dhënat nuk dalin të analizuar për çdo zë tatimor që DTV Bashkia Dimal aplikon. Referuar të dhënave të marra nga DTV Bashkia Dimal, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktivit	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	2022	569	72	26	615
2	Biznesi Madh	2022	150	26	8	168
(1+2)	Gjithsej	2022	715	98	34	783

Burimi: *Bashkia Dimal*

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Dimal në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Berat janë dërguar zyrtarisht

me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Berat.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.12.2022, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në celje të vitit 2022 paraqitet vlerën 5,600,456 lekë për 200 persona, janë sistemuar 28 persona me vlerë **686,093** lekë, rakorduar me thesarin dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2022 gjithsej **137** persona me vlerë **3,822,253 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Dimal (sipas listës të administruar në). Lista analitike paraqitet në *aneks nr.2.6/3 bashkëlidhur PRA*.

Natyra e debitorëve	Detyrime gjithsej 2017-2022		Shtesa/pakësime		Debitorë me 31.12.2022	
	Person	Lekë	Pakësuar	Shtuar	Person	Lekë
Taksa infrastrukture (legalizim)	172	4,914,363	2,620,875	1,528,763	137	3,822,253

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Dimal për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Dimal të jetë drejtuar ASHK, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje.”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 2/1 dhengarkohen me përgjegjësi Drejtorin e PZHT dhe DTV Bashkia Dimal.*

➤ **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifave vendore.**

Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultuan të ardhura të munguara progresive 2016-2022, për buxhetin e bashkisë Dimal në vlerën totale **317,757,340 lekë**.

1. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave të familjarëve në vlerën **199,755,053 lekë**.

2. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit në vlerën **69,920,905 lekë**

3. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksës së ndikimit në infrastrukturënë vlerën **3,822,253 lekë**.

4. Të ardhura të munguara nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre në vlerën **2,600,000 lekë**.

Të ardhura të munguara nga mospagimi i gjobave të vendosura nga IMT-ja në vlerën progresive **33,124,950 lekë**.

Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve sipas njësive administrative paraqitet në si vijon:

Njësia Administrative	Progresive deri në 31.12.2021		Krijuar brenda vitit 2022		Progresive deri në 31.12.2022	
	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë
Ura Vajgurore	49	24,366,446	26	3,655,309	49	26,577,069
Kutalli	50	3,284,412	29	442,004	55	3,889,306
Poshnje	13	1,462,748	14	1,220,598	18	2,577,040
Cukalat	3	206,890	1	18,000	3	224,890

Total	115	29,320,497	70	5,335,911	125	33,268,305
-------	-----	------------	----	-----------	-----	------------

Burimi: *Bashkia Dimal*

Sa me sipër dalim në konkluzionin se: nga strukturat e DTV të bashkisë Dimal, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, **pasi** janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk janë ndjekur procedurat ligjore bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se: “Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3., ku përcaktohet se:

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.” Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

Titulli i gjetjes : *Performancë e ulët në arkëtimin e të ardhurave vendore*

Situata: Detyrimet e papaguara total në progresiv deri në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën 317,757,340 lekë, shumë e cila përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Dimal .

Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultuan të ardhura të munguara progresive 2016-2022, për buxhetin e bashkisë Dimal në vlerën totale **317,757,340 lekë**.

Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave të familjarëve në vlerën **199,755,053 lekë**. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit në vlerën **69,920,905 lekë** Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksës së ndikimit në infrastrukturën në vlerën **3,822,253 lekë**. Të ardhura të munguara nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre në vlerën **2,600,000 lekë**. Të ardhura të munguara nga mospagimi i gjobave të vendosura nga IMT-ja në vlerën progresive **33,124,950 lekë**.

Kriteri: Aktet ligjore të sistemit të taksave dhe tarifave vendore, paketa fiskale miratuar me VKB, -Ligji nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 89 “Njoftimi dhe kërkesa për të paguar”, neni 90 “Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit”, neni 91 “Masa e sigurimit të detyrimit tatimor”, neni 93 “Sekuestrimi i pasurisë” neni 97 “Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë”, neni 98 “E drejta për të kërkuar detyrimet nga pala e tretë”.

Ndikimi: Mungesë e të ardhurave në buxhetin e bashkisë, për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.

Shkaku: Mos zbatim i akteve të miratuara nga Këshilli i Bashkisë për Taksat dhe Tarifatat vendore dhe Ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”

Rëndësia: I mesëm.

Rekomandimi:a) Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Dimal, të marrë masa ligjore ndaj subjekteve debitorë me qëllim mbledhjen e detyrimeve të prapambetura dhe të zbatojë procedurat ligjore për realizimin dhe arkëtimin e tyre.

b) Të marrë masa për arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në momentin që lind detyrimi me qëllim mos krijimin e detyrimeve të prapambetura për secilën kategori biznesi.

c) Drejtorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **3,822,253,lekë** ndaj **137** personave sipas listës, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Sipas dokumentacionit të venënë dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e licencave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Dimal dhe në Njësitë Administrative, ushtornin aktivitetin 16 subjekte nga të cilat janë 2 subjekte janë mbyllur dhe kanë ngelur aktiv 14 që rezultojnë aktiv dhe tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, si vijon:

Nr	Subjekti	Nipt	Afati I autorizimit		Detyrimi per autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	R.Shpk	J.....J	11.12.2018	10.12.2023	1,000,000	1 000 000	Ska
2	B. sh.p.k	L.....R			1,000,000	400 000	600 000
3	G.Z shpk	K.....I	03.02.2020	02.02.2025	1,000,000	1,000,000	
4	R. shpk	K.....I	06.10.2020	05.10.2024	1,000,000	1,000,000	Ska
5	B.o shpk	L.....F			1,000,000	600,000	400,000
6	D.O shpk	L.....J	31.12.2021	30.12.2022	1,000,000	600,000	400 000
7	N.S shpk	K.....L	10.08.2020	09.08.2025	1,000,000	1,000,000	Ska
8	N.S shpk	K.....L			1,000,000	1,000,000	Ska
9	M.P shpk	L.....J	13.03.2020	12.03.2025	1,000,000	1,000,000	
10	K.shpk	J.....P	05.08.2020	04.08.2023	1,000,000	1,000,000	
11	E. shpk	L.....F	24.08.2021	23.08.2022	1,000,000	800,000	200,000
12	C. shpk	K.....T	23.06.2020	22.06.2024	1,000,000	1,000,000	
13	M.sh.p.k	K.....E	Sekuestro/permb				
14	A.shpk	K.....J	Ska lejen		1,000,000		1,000,000
15	G.o	L.....I	Pezulluar				
16	Z.O	L.....I			1,000,000	1,000,000	
					14,000,000	11,200,000	2,600,000

Burimi: *Bashkia Dimal*

Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me Liçensë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejimin e subjekteve të ushtrojnë aktivitet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën.

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, rezulton se në territorin e Bashkisë Dimal dhe në Njësitë Administrative në vartësi, ushtrojnë aktivitetin 14 subjekte aktualisht të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga 14 subjekte janë pajisur me autorizim 12 subjekte, nga të cilat 2 subjekte janë përpara periudhës objekt auditimi si dhe janë pajisur me licenca/autorizime të reja subjekti 12 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, kanë mbyllur aktivitetin e tyre 2 subjektet të cilat nuk ushtrojnë më aktivitetin në tregtimin me pakicë të hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre si dhe nuk paguar tarifën për tu pajisur me autorizim tregtim karburanti gjithsej 5 subjekte të cilët ushtrojnë aktivitet dhe papaguar detyrimin fiskal, evidentohen në **vlerën 2,600,000 lekë** e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Dimal.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- 1) Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar neni 35.
- 2) VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15 ku citohet:

15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë. Veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi komisioni për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënproduktet e saj sipas shkresës nr 1685 prot datë 26.06.2020.

Titulli gjetjes: Lejimi i subjekteve që tregtojnë hidrokarbure me Licencë të bashkisë dhe papaguar tarifën në zbatim të VKM nr. 344, datë 19.04.2017.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me Liçensë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejimin e subjekteve të ushtrojnë aktivitet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën.

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, rezulton se në territorin e Bashkisë Dimal dhe në Njësitë Administrative në vartësi, ushtrojnë aktivitetin 16 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre

Nga 16 subjekte janë pajisur me autorizim 12 subjekte, nga të cilat 2 subjekte janë përpara periudhës objekt auditimi si dhe janë pajisur me licenca/autorizime të reja subjekti 12 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, kanë mbyllur aktivitetin e tyre 2 subjektet të cilat nuk ushtrojnë më aktivitetin në tregtimin me pakicë të hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre si dhe nuk janë licensure me leje tregtim karburanti. **Vlera 2,600,000 lekë është** e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Dimal. ***Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:***

- 1) Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar neni 35.
- 2) VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15 ku citohet:

15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë Veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi komisioni për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënproduktet e saj sipas shkresës nr 1685 prot datë 26.06.2020.

Kriteri: Me nenin 35 të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4. e VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar si dhe kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15 të VKM nr.

970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos ndjekja e procedurës për pajisjen dhe pagesën për Liçensë së tregtimit të karburanteve, çon në mungesë të ardhura për Bashkinë Dimal me vlerë **2,600,000 lekë**.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit dhe mos ndjekja e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për mos lejimin e ushtrimit të aktivitetit pa dokumentacion të rregullt.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Dimal, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për pajisjen me liçenca të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe arkëtimin e tarifës së patakshuar prej **2,600,000 lekë** ndaj 5 subjekteve, sipas pasqyrës më sipër. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për pagesën e tarifës së liçencë/autorizimit, Bashkia Dimal në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik të ndërmarrin veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve, sipas pasqyrës si vijon :

Nr	Subjekti	Nipt	Afati I autorizimit		Detyrimi per autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
I.2	B.O sh.p.k	L.....R			1,000,000	400 000	600 000
I.5	B.O shpk	L.....F			1,000,000	600,000	400,000
I.6	D.O shpk	L.....J	31.12.2021	30.12.2022	1,000,000	600,000	400 000
V.11	E. shpk	L.....F	24.08.2021	23.08.2022	1,000,000	800,000	200,000
V.14	A. shpk	K.....J	Ska lejen		1,000,000		1,000,000
	Total				14,000,000	11,200,000	2,600,000

➤ **Të ardhurat nga gjobat e IMTV.**

Grupi i auditimit, për periudhën objekt auditimi 01.01.2022 – 31.12.2022, kërkoi vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme siç janë dosjet e procedurave të mbajtura nga IMTV, në të cilat duhet të përfshihen procesverbalet e konstatimit të mbajtura nga inspektorët, vendimet e gjobave, vendimet e pezullimit, vendimet e prishjeve dhe procesverbalet e ekzekutimit të këtyre prishjeve, kallëzimet penale, kërkesat drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv, informacioni periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT, planet vjetore dhe planet mujore të punës të miratuara nga k/inspektori. Në menyrë të përmbledhur paraqiten si vijon;

Nr.	Lloji i aktit	2022
1	PV/Akte kontrolli	-
2	PV/Akte konstatimi	11
3	Vendime gjobe	11
4	Vendime pezullimi	
5	Vendime prishje	PO
6	PV ekzekutimi të prishjeve	4
7	Kallëzime penale	JO
8	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	JO
9	Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT	PO
10	Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori	
11	Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori	

➤ **Burimi: Bashkia Dimal**

Aktet e mbajtura nga IKMT për periudhën e vitit 2022.

Për vitin 2022, janë mbajtur 11 procesverbale konstatimi, dhe në zbatim të tyre janë nxjerrë vendime me gjobë në vlerën **2,600,000 lekë** të cilat nuk kanë arritur të arkëtohen, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për bashkinë Dimal. Sa më sipër rezulton se për të gjitha praktikatat IMT-ja, nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, në kundërshtim me:

a-neni 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime, **përcaktohet se:** -Gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, **deri në një muaj**. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.

-Neni 15-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007,), Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2), (Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3);

- Nenet, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

Aneksi nr.11 i gjobave të IMT për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022 si vijon;

Nr.	Subjekti	Nr.Serial, Datë VendimGjobe	Vlera/lekë	Paguar	Debitor
1	A. H	0000468 Nr.468,, Datë 08.02.2022	500,000		500,000
2	E.F	0000469 Nr 469, Datë 14.02.2022	100,000	paguar ne datë 15.02.2022	0
3	G.S. S	0000470 Nr.470, Datë15.02.2022	50,000		50,000
4	H.S	0000471 Nr.471, Datë 03.03.2022	500,000		500,000
5	K.V	0000472 Nr.472, Datë 11.04.2022	500,000		500,000
6	B.S	0000473 Nr.473, Datë 10.05.2022	500,000		500,000
7	F.H	0000474 Nr.474, Datë 07.07.2022	500,000		500,000
8	E.H	0000475 Nr.475, Datë 10.07.2022	10,000	paguar ne datë 06.05.2022	0
9	E. F	0000476 Nr.476, Datë 13.07.2022	100,000	paguar ne datë 11.10.2022	0
10	Q.B	0000477 Nr.477, Datë 24.10.2022	50 000	paguar ne datë 08.11.2022	0
11	L.X	0000478 Nr.478, Datë 19.12.2022	50,000		50,000

Titulli i gjetjes: Krijimi i debitorëve nga mos arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) në vlerën 2,600,000 lekë

Situata: Për vitin 2022, janë mbajtur 11 procesverbale konstatimi, dhe në zbatim të tyre janë nxjerrë vendime me gjobë në vlerën **2,600,000 lekë** vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për bashkinë Dimal. Sa më sipër rezulton se për të gjitha praktikat IMT-ja, nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, në kundërshtim me:

a-neni 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime, **përcaktohet se:** -Gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, **deri në një muaj**. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.

-Neni 15-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni), (Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2) (Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3);

- Nenet, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

Për veprime dhe mosveprime ngarkohet me përgjegjësi z. K.C me pozicion Kryeinspektor i IMTV – së.

Kriteri: Neni 16, i ligjit nr.8402, datë 10.09. 1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime; **Neni 15**-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni) (Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në

fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3); - **Nenet**, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 ”Për kundërvajtjet administrative”.

Shkaku: Mos vjelja e gjobave të vendosura nga IMTV – ja.

Ndikimi/Efekti Mungesë të ardhurash nga mos arkëtimi i penalieteve nga ndërtimet pa leje dhe në kundërshtim me lejet e ndërtimit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojnë në Gjykatë të marrin masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv për shumat e gjobave së papaguar sipas **aneksit nr.3/1 pika 2.6 bashkëlidhur projek raportit të auditimit.**

Ligjshmëria e lidhjes së kontratave dhe arkëtimi i detyrimeve.

Kontratat publike me qira për truall dhe/ose objekte, që janë lidhur gjatë vitit 2022. Konstatohet se: Bashkia Dimal ka lidhur 5 kontrata me persona fizik, kryesisht konsistojnë në hapësirë publike. Gjatë auditimit të këtyre kontratave nuk kemi evidentuar mangësi si në ligjshmëri apo dhe në vjeljen e detyrimeve. Më poshtë në formë tabelare paraqiten subjektet me të cilët Bashkia Dimal ka lidhur kontratë;

Nr.	Qiramaresi	Zona	Objekti	Afati Vjet	Kontrate Nr., Datë	Detyrim vjetor lek/ha	Paguar
1	G.H	ZK.3682, 44m2	Bar kafe dhe pasticeri/ hapësirë publike	2 vite	Nr. 1228/1, datë 23/05/2022	31,680leke/vit	6/4/2022
1	S. Q	ZK.3682, 54m2	Bar. Fast Food/ hapësirë publike	2 vite	Nr. 576/2 datë 11/03/2022	38,880 leke/vit	18/05/2022
3	B.S	Kutalli/ 10M2	Ushqim i Shpejtë/ Hapësirë publike	1 vit	Nr.434/2 datë 25.02.2022	3,600 leke/ vit	20/05/2022
4	P.T	ZK 3682,30m2	Tregti/ hapësirë publike	1 vit	Nr.4247/2, datë 28/01/2022	21,600 leke/vit	29/04/2022
5	L. H	Zk 3682 35m2	Bar Kafe/ hapësirë publike	2 vite	nr 3308/2 dt 05/12/2022	25,200l eke/vit	

Për periudhën objekt auditimi lidhur me arkëtimet dhe vjeljen e gjobave, përgjegjësi mbajnë punonjësit e mëposhtëm:

z. I.S, me pozicion Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore;

z. K.C me pozicion Kryeinspektor i IMTV – së.

z. A.P me pozicion ish/Drejtor në Drejtorin e Zhvillimit të Territorit, Kontrollit të Lejeve, Administrimit të Ujrave.

Përgjegjësi për vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 42 “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 2, ku përcaktohet se: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore.”

Sa më sipër subjekti i audituar dhe punonjësit e atakuar në akt-konstatim nuk kanë paraqitur kundërshtime deri në këtë fazë.

2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2021.

2. 3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.3.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

Në lidhje me këtë drejtim të auditimit, rezulton se kjo pikë nuk është audituar për arsye se pasqyrat financiare nuk ishin përfudnuar nga subjekti, gjithashtu procesi i inventarizimit nuk ishte

kryer dhe njëkohësisht nuk ishin bërë rakordimet me degën e thesarit Berat, për mbylljen e të gjitha llogarive kontabël. Kjo pasi, edhe afati i përfundimit të auditimit në terren u mbyll me datë 24.03.2023, brenda afatit të cilin subjekti ka për mbylljen e llogarive të Pasqyrave Financiare. Për sa më sipër grupi i auditimit nuk mund të japë një opinion, çka sjell se kjo pikë do të auditohet në përgjatë vitit 2023.

2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

2.4.4. Auditim mbi hartimin e zbatimit e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomike fitues.

2.4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendimet përkatëse të KB.

Në zbatim të drejtimit 4, të programit të auditimit nr. 121/1 Prot, datë 31.01.2023, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë;

- 1) Regjistri i realizimeve të prokurimeve për periudhën 01.04.2020 – 31.12.2022.
- 2) Dosjet e procedurave të prokurimit të realizuara për periudhën objekt auditimi.
- 3) Shpenzimet e kryera për procedurat e realizuara dhe marrja në dorëzim sipas rastit.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SEP, u konstatuan disa shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon:*

-Nga Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Dimal, në disa raste nuk është bërë e mundur që përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëvjeçare, të merret konfirmim nga Ministria përgjegjëse për Financat, në strukturat e degëve të thesarit, që fondet të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime, në kundërshtim me pikën 81 të UMF nr. 9, datë 20.07.2018, “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”.

-Nga Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Dimal, në disa rast nuk është bërë e mundur që urdhër prokurimet të konfirmohen në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 02, datë 19.01.2018 të MF “*Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018*”, i ndryshuar.

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Dimal (*regjistrat e parashikimit dhe realizimit*), për periudhën 01.04.2020 – 31.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Procedura 01.04.2020 – 31.12.2020	Nr. i procedurave	Vl. Fond limit në lekë	Vl.Kontrate në lekë
Gjithsej	1	1.053.563.500	1.014.220.809
E hapur ndërkombëtare	18	112.728.140	106.036.898
E hapur	12	36.059.647	809.995.051
E hapur e thjeshtuar	16	55.963.999	53.943.321
Kërkesë për propozim	1	48.811.714	44.245.539

Burimi: Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Dimal

Në lidhje me këtë pikë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se;

Për periudhën objekt auditimi nga 01.04.2020-31.12.2022, Bashkia Dimal ka realizuar **47** procedura prokurimi (tender) me vlerë të fondit limit në shumën **1,053,563,499** lekë dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën **1,014,220,808** lekë nga të cilat:

Për vitin 2020 janë realizuar 14 procedura me fond limit në shumën **338,605,907** lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën **334,154,262** lekë pa TVSH, ose 98.7% e fondit limit.

Për vitin 2021 janë realizuar 20 procedura me fond limit në shumën **416,221,805** lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën **393,548,214** lekë pa TVSH ose 94.6% e fondit limit.

Për vitin 2022 janë realizuar 13 procedura me fond limit në shumën **298,735,787** lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën **286,518,332** lekë pa TVSH ose 96% e fondit limit.

Gjithashtu për të njëjtën periudhë objekt auditimi, ka realizuar 78 procedura blerje me vlera të vogla me fond limit në shumën **27,573,720** lekë dhe vlerë kontrate në shumën **21,961,772** lekë.

Nga këto, për vitin 2020 janë realizuar 32 procedura me fond limit në shumën **11,195,256** lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën **7,931,587** lekë. Për vitin 2021 janë realizuar 28 procedura me fond limit në shumën **9,197,522** lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën **7,591,948** lekë. Për vitin 2022 janë realizuar 18 procedura me fond limit në shumën **7,180,942** lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën **6,438,237** lekë. (*Bashkëlidhur Projekt Raportit paraqitet aneksi nr. 1, pika 4, "Mbi realizimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.04.2020-31.12.2022"*).

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Më poshtë trajtohen disa nga procedurat e prokurimit të audituara në Bashkia Dimal, e konkretisht si vijon:

1. Procedura e prokurimit me objekt "Rrjeti jashtëm dhe brendshëm, njësia administrative Cukalat, Bashkia Ura Vajgurore" me të dhënat si më poshtë;

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rrjeti i brendshëm, Njësia Administrative Cukalat-Bashkia Ura Vajgurore			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur REF-68799-08-14-2020 Urdhri nr.2199 prot, datë 11.08.2020	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Preventivi dhe specifikimet teknike janë hartuar nga Instituti i Konsulencës në Ndërtim	2 Njësia e Prokurimit 1. M.B 2. N.C 3. A. P	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhr2199/1 prot., datë11.08.2020 1. R.S 2. I.S 3. I. D
4. Fondi Limit (pa tvsh) 201 420 870 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: 200 412 476.25 lekë pa tvsh. Operatori Fitues: BOE S. ShPK dhe G.C. ShPK.	6. Diferenca me fondin limit 1 008 394 lekë pa tvsh	
7/1 Data e hapjes së	8. Burimi Financimit	9. Operatorët Ekonomike	

tenderit: Data :21/09/2020 7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës.	Buxheti i shtetit.	a)Pjesëmarrës në tender, 1-Bashkimi i operatorëve ekonomikë S. ShPK nipt J.....G, dhe G.C ShPK, nipt J.....V- <u>200,412,476</u> 2-E.K SHPK, NIPT K.....I- 201,027,592 3- B. SHPK, NIPTR- 201,396,066 b)S’kualifikuar: E.K SHPK, B. SHPK, c)Kualifikuar: -Bashkimi i operatorëve ekonomikë S. ShPK dhe G. C ShPK.
10.Ankimime AK-s’ka/ka; ka Në AK në lidhje me Kriteret OE 4 – AM me shkresën nr.2276 prot., datë 21.08.2020 APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 2199/12prot, datë 16.10.2020	12.Përgjigje Ankesës nga Operatori Ekonomik 1-Ankesë ng a operatori ekonomik A.M SHPK 2-Urdhër nr 2276/1 datë 21.08.2020 për shqyrtimin e ankesës i përbërë nga: 1-B.R 2-M.K 3-L.H 2-Proces-verbal nr 2276/2 datë 23.08.2020,nga grupi i punës për shqyrtimin e ankesës ku pas analizës së fakteve dhe interpretimit juridik të tyre u vendos mos-marrja parasysh e ankesës së paraqitur nga operatoeri ekonomik A.M -ShPK 4-Me shkresën nr 2276/4 datë 26.08.2020, operatorit ekonomik ankimes ju kthye pergjigje mbi mosmarrjen parasysh të ankesës.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlogaritjen e Fondit Limit” :

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se Preventivi dhe specifikimet teknike janë hartuar nga **INSTITUTI I KONSULENCËS NË NDËRTIM.**

Sipas shkresës me nr. 2199 prot., datë 11.08.2020 është bërë hartimi dhe miratimi i Kriereve të Përgjithshme dhe të Veçanta të kualifikimit nga ana e anëtarëve të NJP si dhe i DST dhe me shkresën nr. 2199/3 prot., datë 11.08.2020 është bërë miratimi i Njoftimit të Kontratës nga ana e Titullarit të AK znj. J.M. Me publikimin në buletin të njoftimit të kontratës, është bërë ankesë nga ana e OE “A.M” në lidhje me kriteret e vendosura. Me marrjen e njoftimit për ankesën, sipas shkresës me nr. 2276/1 prot., datë 21.08.2020 është bërë pezullimi i procedurës deri në marrjen e vendimit në lidhje me shqyrtimi e ankesës si dhe ngritja e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës (KSHA) me përbërje z. B.R, znj. M K si dhe znj. L.H. Sipas shkresës me nr. 2276/2 prot., datë 23.08.2020 ky komision ka mbajtur procesverbalin mbi shqyrtimin e ankesës ku në konkluzion është shprehur mbi mos marrjen në konsideratë të ankesës dhe mos ndryshimin e tyre dhe në lidhje me këtë përfundim, KSHA ka marrë vendimin nr. 2276/3 prot., datë 23.08.2020. Me shkresën nr. 2276/4 prot., datë 26.08.2020 i është kthyer përgjigje OE A.M nga ana e Titullarit të AK znj. J.Mj (në mungesë e me urdhër nga Sekretari i Përgjithshëm znj. R.S).

Sipas shkresës nr. 2276/5 prot., datë 26.08.2020 është bërë heqja e pezullimit të procedurës nga ana e Titullarit të AK znj. J.M (në mungesë e me urdhër nga Nën Kryetari znj. L.B). Me shkresën nr. 2199/4 prot., datë 14.09.2020 është bërë miratimi i shtojcës së modifikimit të DST në lidhje me preventivin e punimeve.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se në dosje nuk disponohen Deklaratat e Konfliktit të Interesit të anëtarëve të KSHA.

b-Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Krieteve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej (A.P arkitekt, 2-M.B-Ekonomiste, 3-N..C-juriste) të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 11.08.2020, nga të cilat disa prej tyre janë të pa argumentuara e konkretisht si më poshtë:

1. Kriteri “Vërtetim nga Bashkia – Autoriteti Kontraktor, se ofertuesi nuk ka detyrime ndaj Autoritetit Tonë, të lëshuar jo më vonë se 5 ditë përpara datës së hapjes së ofertës. Do të konsiderohen detyrime të gjitha shumat që janë rrjedhojë e një detyrimi të lindur për taksat vendore”

Në fakt ky kriter nuk rezulton i argumentuar teknikisht dhe ligjrisht pasi afati prej 5 ditësh nuk është i shoqëruar me ndonjë domosdoshmëri që ka AK dhe si e tillë jo vetëm që nuk është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës por është edhe diskriminuese. Gjithashtu, ky kriter nuk bën pjesë në asnjë prej atyre të caktuara nga neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” i LPP dhe neni 26 “Kontratat për punë publike” i RrPP.

2. Kriteri Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Licenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

NP – 1/G Punime gërmimi në tokë.

NP – 2/G Ndërtime Civile dhe Industriale

NP – 4/G Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.

NP – 5/G Punime nëntokësore, ura e vepra arti.

NP – 7/G Ujësjellsa, gazsjellsa, vajsjellsa, vepra kullimi e vaditje.

NP – 12/G Punime të inxhinierisë së mjedisit.

NS – 1/D Punime për prishjen e ndërtimeve

NS – 4/E Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese

NS – 6/E Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.

NS – 14/E (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiofoni TV)

NS – 16/E (Ndërtim i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimi i tij)

NS – 18/D Punime topogjeodezike

NS – 20/E Shpime Gjeologo – inxhinierike, puse e shpime për ujë sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI;

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Në fakt referuar preventivit të hartuar nga ana e Projektuesit OE I. K. N. N, rezulton se këto kategori licencash nuk janë në raport të drejtë me ato që nevojiten për kryerjen e punimeve sipas kategorive dhe zërave të preventivit duke u bërë kështu shkak për kufizimin e pjesëmarrjes së OE. Konkretisht, referuar VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrijnë Veprimtari Ndërtimi”, i ndryshuar, Lidhja nr. 4 rezulton se është përcaktuar se niveli i shoqërisë (niveli i licencës/kategorisë) në raport me vlerën në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi është si më poshtë:

Niveli i Shoqërisë	i Sipas Vlerave në Lekë të Punimeve të Kryera për çdo Kategori Punimi
---------------------------	--

A	0 – 20 milion lekë
B	21 – 50 milion lekë
C	51 – 100 milion lekë
D	101 – 200 milion lekë
E	201 – 400 milion lekë
F	401 – 800 milion lekë
G	Mbi 800 milion lekë

Duke krahasuar kriteret e vendosura nga ana e NJP me tabelën si më sipër rezulton se 6 kategoritë e licencave:

NP – 1/G Punime gjërmimi në tokë.

NP – 2/G Ndërtime Civile dhe Industriale

NP – 4/G Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.

NP – 5/G Punime nëntokësore, ura e vepra arti.

NP – 7/G Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.

NP – 12/G Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Në lidhje me kërkesat për licenca konstatohet se ato janë kërkuar për vlerë punimesh deri në masën mbi 800,000,000 lekë kur në fakt vlera e gjithë kontratës së punimeve sipas fondit limit është parashikuar në masën 201,420,870 lekë pa TVSH.

Nga këto, përveç faktit se janë vendosur kategori për ndërtimet e përgjithshme licence me nivele shumë më të larta nga ato që nevojiten për kryerjen e punimeve, rezulton se kategoritë:

NP – 5/G Punime nëntokësore, ura e vepra arti.

NP – 12/G Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Janë vendosur pavarësisht se referuar preventivit të punimeve nuk ka asnjë zë që lidhet me punimet e lidhura me këto dy kategori licence.

Në mënyrë të ngjashme, janë vendosur pa asnjë domosdoshmëri kategoritë e licencave për punimet speciale me nivelet përkatëse si më poshtë:

NS – 1/D Punime për prishjen e ndërtimeve kur në fakt, referuar preventivit nuk ka asnjë zë të vetëm për prishje ndërtimesh;

NS – 6/E Sinjalistika rrugore jo ndriçuese kur në fakt, referuar preventivit nuk ka asnjë zë të vetëm për sinjalistikë rrugore;

NS – 20/E Shpime Gjeologo – inxhinierike, puse e shpime për ujë kur në fakt, referuar preventivit nuk ka asnjë zë të vetëm për punime në lidhje me shpimet gjeologo inxhinierike;

Siç shihet nga sa më sipër rezulton se kriteret e vendosura nga ana e NJP:

- në 6 raste kanë diktuar nivele licencash 4 herë më të larta se vlera e fondit limit të vënë në dispozicion të investimit;
- në 5 raste kanë qenë jashtë kontekstit dhe pa lidhje me zërat e preventivit;
- në 8 raste kanë qenë shumë herë më të larta se vlera respektive e punimeve të parashikuara në preventiv;

Nga sa më sipër rezulton se kategoritë e kërkuara nga ana e NJP janë krejtësisht të paargumentuara, diskriminuose, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme, situatë e cila, në gjykim të grupit të auditimit, krijon një dyshim të arsyeshëm mbi vendosjen e kriterëve me një OE fitues të paracaktuar.

3. Kriteri “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar me eksperiencë pune të paktën 5 (pesë) vjeçare një inxhinier të licencuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit për “Projektim dhe zbatim në Restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së Arkitekturës” të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezë pune, licencë profesionale personale lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit, si dhe të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë për periudhën Korrik 2019 – Qershor 2020”.

Në fakt kriteri si më sipër, jo vetëm që është i paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht se përse nevojitet një profesionist i kësaj fushe, por gjithashtu konstatohet se nga ana e NJP është kërkuar që i punësuar i të ketë licencë edhe në projektim edhe në zbatim për restaurimin e monumenteve. Në fakt, kontrata objekt prokurimi është kontratë për punime civile dhe si e tillë është në kushtet kur projekti i zbatimit është hartuar e miratuar përpara nisjes së procedurës së prokurimit. Për rrjedhojë ky kriter rezulton të jetë kufizues në drejtim të pjesëmarrjes së OE dhe si i tillë nuk duhet të ishte vendosur e as miratuar.

4. Kriteri “Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm si dhe të ketë eksperiencë pune minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.

i. Libreze pune (përkatëse)

ii. CV përkatëse

iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)”

Në lidhje me këtë kriter rezulton se vendosja e eksperiencës së inxhinierit nuk është e argumentuar teknikisht se përse duhet me të paktën 15 vite eksperiencë (dhe jo 14 apo 16). Së pari duhet sqaruar fakti se VKM nr. 759, datë 12.11.2014 ‘Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim’, e ndryshuar, ka përcaktuar qartë se cilat janë kriteret e dhënies së licencave profesionale në zbatim për drejtuesit teknik dhe në mënyrë të ngjashme ka diktuar edhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008 ‘Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi’ për firmat sipërmarrëse. Për rrjedhojë rezulton se edhe ky kriter nuk është i argumentuar dhe as në përputhje me nevojat e investimit.

5. Kriteri “Një punësim mesatar i të paktën 270 (dyqind e shtatëdhjetë) personave, për periudhën Korrik 2019 – Qershor 2020 të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Korrik 2019 – Qershor 2020.

- Listë – pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Korrik 2019 – Qershor 2020.”

Në fakt sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezulton ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër prej 270 të punësuarish në lidhje me këtë kontratë.

6. Kriteri “Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë,

librezat e punës, të përfshirë në licencën e shoqërisë si dhe të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë për periudhën Korrik 2019 – Qershor 2020 si më poshtë:

Nr.	Kualifikim
1.	2 (dy) Inxhinier Ndërtimi
2	3 (tre) Inxhinier Hidroteknik
3.	2 (dy) Inxhinier Elektrik
4.	1 (një) Inxhinier Elektronik
5.	2 (dy) Inxhinier Mekanik
6.	3 (tre) Inxhinier Gjeodet
7.	2 (dy) inxhinier Mjedisi
8.	1 (një) Inxhinier Gjeoteknik
9.	1 (një) Inxhinier Gjeolog

Në fakt sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezulton ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër specialistësh si më sipër, pra përse 2 inxhinierë ndërtimi, 3 hidro e kështu me radhë. Gjithashtu, konstatohet se në mënyrë krejtësisht të paargumentuar dhe jo në përputhje me domosdoshmëritë që paraqet realizimi i punimeve, janë kërkuar inxhinierë gjeoteknike dhe inxhinierë gjeolog. Për inxhinierin gjeolog përveçse nuk është argumentuar kërkesa për këtë profesion, as nuk është saktësuar se cili ka qenë profili i kërkuar për këtë inxhinier gjeolog (Gjeoinformatikë, Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji, vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji, Gjeologji e Vendburimeve Hidrokarbure).

7. Kriteri “Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të punësuar në listë-pagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2020 – Qershor 2020, stafin Teknik të certifikuar si më poshtë:

1 (një) inxhinier ndërtimi

1 (një) inxhinier hidroteknik

1 (një) inxhinier mekanik,

1 (një) Inxhinier Telekomunikacioni

1 (një) Inxhinier Mekatronik

1 (një) inxhinier Gjeofizik

1 (një) ekspert zjarrfikës të certifikuar (i pajisur me Certifikatë)

1 (një) inxhinier Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetin në Punë i pajisur me Certifikatë, lëshuar nga autoritete të akredituara.

2 (dy) Inxhinier Inspektorë Cilësie të pajisur me Certifikatë, lëshuar nga autoritete të akredituara.

6 (gjashtë) punonjës të pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2 (dy) Inxhinier si “Përgjegjës për dëmet në mjedis” gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Për Stafin e sipërcituar të paraqitet, kontrate pune të vlefshme, diplomë/certifikatat përkatëse.

Në lidhje me kërkesat për stafin si më sipër nuk është e argumentuar arsyeja se përse stafi i mëparshëm është kërkuar të jetë në listë-pagesa që prej qershorit 2019 dhe në rastin e fundit është kërkuar të jenë në listë pagesa prej janari e deri në qershor të vitit 2020. Së dyti konstatohet se ashtu si edhe në rastin më sipër, edhe për këtë pjesë të stafit nuk rezulton ndonjë llogaritje

analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër specialistësh si më sipër, pra përse 2 inxhinierë specialistë cilësie, 6 punonjës ekspertë për ndihmën e parë dhe 2 inxhinierë përgjegjës për dëmet në mjedis dhe nuk është e argumentuar se përse këta specialistë duhet të jenë domosdoshmërisht edhe inxhinierë. Gjithashtu, konstatohet se në mënyrë të përsëritur, krejtësisht të paargumentuar dhe jo në përputhje me domosdoshmëritë që paraqet realizimi i punimeve, janë kërkuar profesionet Inxhinier Telekomunikacioni, Inxhinier Mekatronik si dhe Inxhinier Gjeofizik, të tre këta pa asnjë argument të qenësishëm dhe jashtë natyrës së investimit objekt prokurimi (rrjet ujësjellësi).

8. Kriteri “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të kualifikuar me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) si më poshtë:

4 (katër) Saldator (Kategoria II) nga të cilët njëri prej tyre të jetë i kualifikuar Saldator për montim tubash me ngjitje;

5 (pesë) punonjës elektrikist nga të cilët 3 (tre) kategoria III, 1 (një) Kategoria IV dhe 1 (një) Inxhinier Kategoria V

2 (dy) Punonjës Hidraulik (Kategoria II)

2 (dy) Teknik Ndërtimi (Kategoria II) nga të cilët 1 (një) profili Gjeometër

2 (dy) Mekanik (Kategoria II)

3 (tre) Hekurkthyes (Kategoria I)

2 (dy) Murator (Kategoria I)

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi, dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara si dhe të figurojnë në listë – pagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2020 – Qershor 2020.

Në fakt sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezulton ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër i tillë specialistësh në lidhje me këtë kontratë.

9. Kriteri Në mënyrë të ngjashme me si më sipër rezulton se janë të paargumentuara kriteret e vendosura në lidhje me:

- numrin prej 6 të punësuarve të certifikuar për punime në lartësi aq më tepër ku janë kërkuar nga këta që dy të jenë edhe inxhinierë ndërtimi;

- Numrin prej 8 manovratorësh;

10. Kriteri Për sa i takon kriterit në lidhje me certifikatat e kërkuar rezulton se nga ana e NJP nuk është kërkuar që këto certifikata ISO të kenë të saktësuar si objekt certifikimi në raport me natyrën e kontratës objekt prokurimi.

11. Kriteri “Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me:

Licencë III.2.A (1+2) Veprimtari ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis Ndikimi në mjedis Auditim Mjedisor”, Ndikim Mjedisor)

Në lidhje me këtë kriter të vendosur sqarojmë se Licenca e mësipërme lëshohet nga QKL për subjektet e licencuara juridike ose fizike tregtare, për të kryer veprimtarinë e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe auditimit mjedisor, si ekspertë të VNM-së dhe auditimit mjedisor, kjo pasi edhe raportet e thëlluara edhe raportet paraprake të VNM-ve pranohen si të tillë vetëm kur janë nënshkruar nga një ekspertë i certifikuar apo nga subjekte juridike ose fizike tregtare, të licencuara nga QKL-ja, për veprimtarinë e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe auditimit mjedisor.

Në nenin 1 Qëllimi, ky ligj ka cituar se:

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë:

a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, **përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;**

Pra, nga sa më sipër rezulton se procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis, është një fazë e cila ezaurohet përpara miratimit të Projektit dhe pasi Projekti është miratuar, marrë në dorëzim dhe nuk mundet kurrsesi të vendoset si kriter për firmat sipërmarrëse që do të marrin pjesë. Ajo që duhet theksuar në këtë rast është fakti se një licencë e tillë nuk mund t'i kërkohet një firme sipërmarrëse për një projekt të miratuar gjatë fazës së zbatimit dhe aq më tepër duke u zbatuar nga vetë ajo firmë zbatimi pasi do të ishte në konflikt të hapur interesi.

12. Kriteri “Licencë Kodi I.2.A “Studimi e përgatitja e projekteve për masat e mbrojtjes nga zjarri për ndërtesa të çdo lloji.”

Në lidhje me këtë kriter të vendosur sqarojmë se Licenca e mësipërme është krejtësisht jashtë çdo domosdoshmërie pasi aktualisht kontrata objekt prokurimi është kontratë për punime zbatimi (punime civile) dhe si e tillë ka patur një projekt të miratuar tashmë nga ane e AK. Për rrjedhojë ky kriter nuk duhet të ishte vendosur e miratuar nga ana e AK.

13. Kriteri “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Ekskavator me zinxhir	6 copë	Pronësi ose me qera
Mjete transporti vetëshkarkues kapaciteti mbajtës 12- 15 ton	4 copë	Pronësi ose me qera
Mjete transporti vetëshkarkues kapacitet mbajtës mbi 20 ton	6 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinç	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadroma	2 copë	Pronësi ose me qera
Auto betoniere	6 copë	Pronësi ose me qera
Autobot Uji	4 copë	Pronësi ose me qera
Pompa Uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Makineri për ngjitje tubash me saldim	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(pese) ton dhe maksimumi 5 (pesë) ton për secilin kamion.	2 copë	Pronësi ose me qera
Rula vibrues	2 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator	2 copë	Pronësi ose me qera
Motosaldatrice	2 copë	Pronësi ose me qera
Sonde Shpimi	2 cope	Pronësi ose me qera

Në fakt sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezulton ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër i tillë mjetesh në lidhje me këtë kontratë.

Gjithashtu, përveç mangësisë së argumentit në lidhje me numrin e mjeteve si më sipër rezulton se nga ana e NJP janë vendosur kërkesa për pajisje dhe mjete të cilat nuk kanë asnjë domosdoshmëri për realizimin e kontratës. Konkretisht rezulton se janë kërkuar që OE pjesëmarrës të disponojnë:

a. Asfalto shtruese – 1 copë dhe autobitumatrice – 1 copë, fabrikë asfalti – 1 copë kur në fakt asnjë zë në preventiv nuk ka parashikuar punime shtrimi me asfalt.

b. Fabrikë betoni – 1 copë, kur në fakt referuar preventivit të punimeve kemi të bëjmë me një sasi prej gati 650 m³, sasi kjo e cila mund të gjendet lehtësisht nga furnitorë në treg të prodhimit të betonit, pa qenë e nevojshme të disponohet nga OE pjesëmarrës në tender;

Të paargumentuar gjithashtu janë edhe kapacitet në ton të mjeteve të kërkuara.

14. Kriteri “Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

Kokore minimumi 40 (dyzetë) copë;
Fikse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 (pesë) copë;
Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 (pesë) copë;
Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 (pesë) copë;
Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 (dhjetë) copë”

Në fakt sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezulton ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër i tillë pajisjes në lidhje me këtë kontratë. Vlen të theksohet në këtë rast se ka një disproporcion mes numrit të stafit të kërkuar (270 persona) me numrin e kokoreve (40 copë) si dhe numrin e fikseve prej 5 copësh apo 10 tabela paralajmëruese në një kantier me shtrirje si ajo e një rrjeti ujësjellësi.

Titulli i gjetjes: Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara dhe të panevojshme për pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Rrjeti jashtëm dhe brendshëm, njësia administrative Cukalat, Bashkia Ura Vajgurore*”, me fond limit në shumën **201,420,870 lekë pa TVSh** dhe me vlerë kontrate në shumën **200,412,476lekë pa tvsh**, me BOE fitues “S. ShPK dhe G.C...ShPK”, rezulton se: Nga Bashkia Dimal, Njësia e hartimit të kriterëve të kualifikimit, miratuar nga titullari i AK, rezulton se në mënyrë krejtësisht të paargumentuar dhe justifikuar, janë hartuar dhe miratuar kriterë diskriminues duke ulur ndjeshëm edhe efektivitetin, eficiencën dhe ekonomikitetin e procedurës së prokurimit përmes vendosjes së kriterëve për një OE thuasje të paracaktuar. Këto kriterë nuk duhet të vendoset pasi referuar LPP vendosja e tyre, *ndikon në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, dhe mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik.* Referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përlllogaritja e orëve të punës dhe argumentimi i stafit të kërkuar se si rezultat i kujt llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë punonjësish. Gjithashtu vendosja e kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, nuk është e sqaruar në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, liçencat, certifikatat e kërkuara, mjetet e punës, numri i fuqisë punëtore etj.

Me publikimin në buletin të njoftimit të kontratës, është bërë ankesë nga ana e OE “..A.M” në lidhje me kriteret e vendosura. Me marrjen e njoftimit për ankesën, është bërë pezullimi i procedurës, është krijuar Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës (KSHA) me përbërje z. B.R, znj. M. K. si dhe znj. L.H. Komisioni ka arritur në përfundim mbi mos marrjen në konsideratë të ankesës dhe mos ndryshimin e tyre dhe në lidhje me këtë konkluzion duke vijuar më pas me heqjen e pezullimit dhe vijimin e procedurës. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se në dosje nuk disponohen Deklaratat e Konfliktit të Interesit të anëtarëve të KSHA. *Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Titullari i AK znj. J.Mj, anëtarët e NJP znj. M.B, znj. N.Ç si dhe z. A.P.*

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, “*Objekti dhe qëllimi*”, ku përcaktohet se:

- | |
|--|
| <p>a) të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;</p> <p>b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;</p> <p>c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;</p> |
|--|

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”, ku përcaktohet se:

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

- a) mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;*
- b) transparencë në procedurat e prokurimit;*
- c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.*

neni 20, “Mosdiskriminimi”, ku përcaktohet se:

Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 26, “Kontratat për punë publike”, ku përcaktohet se:

3) Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës;

5) Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve

neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, ku përcaktohet se:

3) Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Rregulloren e Përgjithshme të punës.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Dimal, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

c-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr 2199/7 të datës 25/09/2020, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	BOE S. ShPK dhe G. C ShPK.	200,412,476	Kualifikuar-Dokumentacioni i paraqitur është i saktë.
2	E. K SHPK,	201,027,592	S'kualifikuar-Për mangësi dokumentacioni
3	B.. SHPK,	201,396,066	Skulaifikuar-Për mangësi të theksuara dokumentacioni

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 02/10/2020 në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 3 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 2 OE, dhe **janë kualifikuar 1 OE**. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 06.10.2020 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “Bashkimi i operatorëve ekonomikë S. ShPK nipt J.....G, dhe G. C ShPK, nipt J6324443V” për të cilën është lidhur kontrata datë 16/10/2020, për vlerën lekë **200,412,476 leke pa TVSH dhe vlera 238,203,283 lekë me TVSH**, dhe me afat 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Titulli i gjetjes: Kualifikim i BOE dhe lidhja e kontratës në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara.

Situata: Bashkia Dimal nëpërmjet Komisionit të vlerësimit të ofertave të procedurës me objekt nga 3 OE pjesëmarrës ka s'kualifikuar 2 OE dhe ka kualifikuar 1 OE. Nga verifikimi i dokumentacionit të BOE të kualifikuar dhe shpallur fitues rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara nga AK, pra në këtë rast tenderi duhej të anulohet. Mos anulimi i procedurës së prokurimit ka çuar në kualifikim dhe shpallje fitues të OE i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, duke sjellë si rezultat lidhjen e kontratës në kushtet e paligjshmërisë të procedurës së prokurimit publik në vlerën 238,203,283 lekë me TVSH. Konkretisht, sipas aktit me nr. 2199/6 prot., datë 21.09.2020 është mbajtur proces verbali i hapjes së ofertave nga ku është konstatuar se kanë marrë pjesë 3 OE. Në vijim sipas shkresës nr. 2199/7 prot., datë 25.09.2020 është mbajtur procesverbali i vlerësimit sipas të cilit është kualifikuar dhe shpallur fitues vetëm BOE S. & G. C, njëkohësisht edhe OE i renditur i pari dhe me shkresën nr. 2199/9 prot., datë 02.10.2020 është miratuar Raporti Përmbledhës i procedurës nga ana e Titullarit të AK znj. J.Mj. Me shkresën nr. 2199/10 prot., datë 06.10.2020 është bërë njoftimi i *Fituesit* dhe sipas aktit nr. 2199/12 prot., datë 16.10.2020 është bërë lidhja e kontratës së punimeve mes Titullarit të AK dhe BOE me vlerë të kontratës 238,203,28.50 lekë me TVSH dhe afat zbatimi kontratë 18 muaj.

Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se BOE S. & G. C është krijuar sipas aktit noterial me nr. 5496 rep. 2057 kol. datë 19.09.2020 sipas të cilës pjesëmarrja e këtyre dy shoqërive do të jetë në masën 70 % OE S. dhe 30 % OE G. C dhe po sipas kësaj % është parashikuar të jetë edhe kontributi i tyre në punime. Sipas prokurës së posaçme me nr. 5497 rep. 2058 kol. datë 19.09.2020 është caktuar OE S. si përfaqësues i këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

1. Kriteri: “Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit, datë e përlllogaritur nga data e hapjes së ofertave.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit, është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet, datë e përlllogaritur nga data e hapjes së ofertave.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular Vlerësimi, shoqëruar me:
- Kontratë
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular Vlerësimi, shoqëruar me:
- Kontrate;
- Situacionin përfundimtar;
- Akt kolaudimi objekti/ Certifikate marrje në dorëzim
- Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në lidhje me punët e ngjashme nga ana e OE S. janë paraqitur:

A. Një kontratë e datës 24.04.2017 e lidhur mes Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe S. SHPK e cila ka si objekt “Ndërtimin i Aksit rrugor Skrapar – Përmet, Loti 1” me vlerë 1,219,030,410 lekë me TVSH si dhe një kontratë shtesë me nr. 19.07.2018 “Ndërtimin i Aksit rrugor Skrapar – Përmet, Loti 1 shtesë punimesh)” me vlerë 242,220,517 lekë me TVSH;

Për këtë praktikë është paraqitur:

- Formulari i vlerësimi;
- Akti i kolaudimit;
- Situacion;
- Fatura tatimore të shitjes;

Në fakt nga analiza e dokumentacionit të mësipërm konstatohet se kjo nuk është punë e ngjashme dhe si e tillë nuk përmbush kriterin e vendosur në DST.

Gjithashtu, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në SPE rezulton se kjo kontratë është lidhur me datë 24.04.2017 dhe sipas aktit të kolaudimit, pjesa më e madhe e kësaj kontrate me vlerë totale 1,219,030,410 lekë me TVSH, konkretisht vlera 864,033,431.6 lekë me TVSH, ose 70 % e saj është kryer përpara periudhës 3 vjeçare të kërkuar në DT.

B. Një kontratë e lidhur me datë 20.06.2017 me afat 18 muaj dhe amenduar deri me datë 31.03.2020, mes FSHZH dhe S. SHPK e cila ka si objekt “Ndërtimin Asfaltim i rrugës Cërrik – Belsh – Dragot – Kuçovë – Urë Vajgurore” me vlerë 689,987,164 lekë pa TVSH.

Për këtë praktikë është paraqitur:

- Formulari i vlerësimi;
- Akti i kolaudimit;
- Situacion përfundimtar;
- Fatura tatimore të shitjes;

Në fakt nga analiza e dokumentacionit të mësipërm konstatohet se kjo nuk është punë e ngjashme dhe si e tillë nuk përmbush kriterin e vendosur në DST.

C. Një kontratë e lidhur me datë 17.08.2017 me afat deri me datë 17.08.2018, mes AK Bashkia Dimal dhe S. SHPK e cila ka si objekt *“Rikonstruksion i rrugës kthesë e Pilurit (Dimal) – Vumblo”* me vlerë 136,485,450 lekë pa TVSH.

Për këtë praktikë është paraqitur:

- Formulari i vlerësimi;
- Akti i kolaudimit;
- Situacion përfundimtar;

Në fakt nga analiza e dokumentacionit të mësipërm konstatohet se kjo nuk është punë e ngjashme dhe si e tillë nuk përmbush kriterin e vendosur në DST.

D. Një kontratë e lidhur me datë 15.11.2017 me afat deri me datë 02.08.2019, mes subjektit privat A.H.C dhe S. SHPK e cila ka si objekt *“Faza e tretë e punimeve në objektin ‘Ndërtim, përmirësim, shfrytëzim, mirëmbajtje, të autostradës Milot – Morinë’”* me vlerë 2,006,398,074 lekë me TVSH.

Për këtë praktikë është paraqitur:

- Formulari i vlerësimi;
- Akti i marrjes në dorëzim;
- Fatura tatimore të shitjes;
- Situacion përfundimtar;
- Akti i kolaudimit;

Në fakt nga analiza e dokumentacionit të mësipërm konstatohet se OE S. ka patur si objekt kontratë (neni 3 i kontratës së datës 15.11.2017) punimet si më poshtë:

1. Ndertimi i sheshit te pagesave (Toll Plaza) km 80+712
2. Zbatimi i disa masave te caktuara zbutese mjedisore
3. Riparim i defekteve te fshehura te tunelit te Thirres (me ane te riparimit dhe zevendesimit) Autostrada Milot – Morine .
4. Masa Korrigjuese ne Ura Autostrada Milot Morine
5. Rehabilitim i Ures se Vjeter mbi lumin Drin
6. Vendosje e gardhit rrethues pergjate segmentit te Autostrades Milot – Morine \
7. Furnizim dhe vendosje e Ndricimit ne te gjitha nyjet ekzistuese pergjate segmentit te Autostrades Milot – Morine
8. Mbyllja e pikave hyrese dhe dalese sipas kategorise se Pare Shtojca 9 e Kontrates Se koncesionit
9. Kryerja e punimeve civile ne rruge per realizimin e menaxhimit te trafikut ne autostraden Milot – Morine
10. Ndertim i rrugëve lidhese dhe ndihmese te Ures se Re te Kukesit .
11. Ndertim i nyje ne disnivel dhe elementeve te tjere gjeometrike si dhe mbikalimi i rii kembesoreve Kukes.
12. Realizimi i Infrastruktures per menaxhimin e Ujerave te Bardha te Autostrades Milot – Morine
13. Punime Emergjente ne Autostraden Milot- Morine
14. Ndertim Ura e Re e Drinit ne Kukes.
15. Punime gjeoteknike fillestare sipas Shtojcën 6

E. Një kontratë e lidhur me datë 07.12.2017 me afat deri me datë 02.08.2019, mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë dhe S. SHPK e cila ka si objekt *“Ri konceptim i parkut të lojërave të fëmijëve dhe parkim publik 2 kate nën tokë në rrugën e Elbasanit”* me vlerë 331,429,699 lekë me TVSH.

Për këtë praktikë është paraqitur:

- Formulari i vlerësimi;
- Akti i marrjes në dorëzim;
- Fatura tatimore të shitjes;

- Situacion përfundimtar;
- Akti i kolaudimit;

Në fakt nga analiza e dokumentacionit të mësipërm konstatohet se kjo nuk është punë e ngjashme dhe si e tillë nuk përmbush kriterin e vendosur në DST.

F. Një kontratë e lidhur me datë 07.12.2017 me afat deri me datë 02.08.2019, mes Autoritetit Kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe S. SHPK e cila ka si objekt “*Rehabilitimi i rrugës hyrëse Mihal Komнено për në Kala dhe Tabja*” me vlerë 123,433,670 lekë pa TVSH.

Për këtë praktikë është paraqitur:

- Formulari i vlerësimi;
- Akti i marrjes në dorëzim;
- Fatura tatimore të shitjes;
- Situacion përfundimtar;
- Akti i kolaudimit;

Në fakt nga analiza e dokumentacionit të mësipërm konstatohet se kjo nuk është punë e ngjashme dhe si e tillë nuk përmbush kriterin e vendosur në DST.

Nisur nga sa më sipër dhe mbi të gjitha nga fakti se OE S., sipas kontratës së bashkëpunimit ka marrë përsipër të kryejë 70 % të të gjithë punimeve, rezulton se BOE në total nuk përmbush kriterin e punëve të ngjashme pasi asnjë prej referencave të analizuar rast pas rasti nuk është dhe nuk mund të konsiderohet punë e ngjashme, kjo për sa kohë nuk kanë objekt ujësjellësi por edhe për faktin se zërat e të gjithë preventivëve janë të një natyre jo të ngjashme me ato të preventivit objekt prokurimi.

2. Kriteri “*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar me eksperiencë pune të paktën 5 (pesë) vjeçare një inxhinier të licencuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit për “Projektim dhe zbatim në Restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së Arkitekturës” të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezë pune, licencë profesionale personale lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit, si dhe të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë për periudhën Korrik 2019 – Qershor 2020.*”

Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se OE G. C nuk e disponon këtë licencë edhe pse ndarja e punimeve është kryer në raportin 70%–30% mes OE S. dhe G. C.

3. Kriteri “*Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm si dhe të ketë eksperiencë pune minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.*

i. *Libreze pune (përkatëse)*

ii. *CV përkatëse*

iii. *Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)*

Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ana e OE S. është nënshkruar një deklaratë e cila paraqitet në rubrikën (anekse) të raportit përfundimtar të auditimit.

Në fakt referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës, u konstatua se nga ana e OE S. nuk është angazhuar ky i punësuar si Drejtues Teknik por është angazhuar ing. A. S. nga ana e të cilit janë firmosur situacionet nr. 1 për periudhën 13.11.2020 – 07.12.2020 si dhe situacionit nr. 2 për periudhën 07.12.2020 – 24.05.2021. Në asnjë prej dokumenteve të vëna në dispozicion nga ana e AK Bashkia Dimal nuk u konstatua prezenca e këtij Drejtuesi Teknik. Nga kryqëzimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga faqja e APP në cilësinë e Audituesit Shtetëror të KLSH, është konstatuar se nga ana e OE S., për një kontratë me

objekt "Punime për mbrojtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës së HEC Koman" është nënshkruar një deklaratë e datës 22.02.2021.

Në përfundim të procedurës së mësipërme ky OE është shpallur fitues duke lidhur edhe kontratën përkatëse sipas aktit me nr. 4100/8 prot., datë 17.03.2021 mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor të KESH SHA dhe z. L. S. Administrator i shoqërisë S..

Në mënyrë të ngjashme me stafin teknik, edhe në lidhje me mjetet e ofruara në drejtim të realizimit kontratës rezulton se nga ana e OE S. janë ofruar edhe 13 mjete në dispozicion kur në fakt po këto mjete janë vënë në dispozicion të kontratës tjetër të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor të KESH SHA dhe z. L.S. Administrator i shoqërisë S. me nr. 4100/8 prot., datë 17.03.2021. Nga analiza dhe krahasimi i fakteve si më sipër rezulton se nga ana e OE S. janë paraqitur deklaratatë të rreme me qëllim kualifikimi duke mos ju përmbajtur kështu deklaratave të bëra gjatë fazës së procedurës së prokurimit.

4. Kriteri "Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezat e punës, të përfshirë në licencën e shoqërisë si dhe të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë për periudhën Korrik 2019 – Qershor 2020 si më poshtë:

Nr.	Kualifikim
1.	2 (dy) Inxhinier Ndërtimi
2	3 (tre) Inxhinier Hidroteknik
3.	2 (dy) Inxhinier Elektrik
4.	1 (një) Inxhinier Elektronik
5.	2 (dy) Inxhinier Mekanik
6.	3 (tre) Inxhinier Gjeodet
7.	2 (dy) inxhinier Mjedisi
8.	1 (një) Inxhinier Gjeoteknik
9.	1 (një) Inxhinier Gjeolog

Në fakt, sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se OE S., në cilësinë e përfaqësuesit të BOE dhe njëkohësisht të ortakut me 70 % të kontributeve në këtë kontratë bashkëpunimi, nuk përmbush kriterin në lidhje me inxhinierin gjeoteknik.

5. Kriteri "Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me :

Licencë III.2.A (1+2)Veprimtari ekspertizës lidhur me ndikimin ne mjedis Ndikimi ne mjedis Auditim Mjedisor" . Ndikim Mjedisor)

Licencë Kodi III.2B Grumbullim dhe Transport i Mbetjeve Urbane

Licencë Kodi III.2.B "Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte e dherave"

Licencë Kodi III.2.B "Për Grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura".

Licencë Kodi I.2.A "Studimi e përgatitja e projekteve për masat e mbrojtjes nga zjarri për ndërtesa të çdo lloji."

Sipas dokumentacioni të ngarkuar në SPE rezulton se nga ana OE nuk përmbushet ky kriter pasi:

a. Leja mjedisore me numër seria LN-6731 – 02 – 2019 'Grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura', në aktin e miratimit të saj sipas shkresës me nr. 1659 prot., datë 18.02.2019 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në pikën 4 ka përcaktuar se 'Kjo licencë është e

vlefshme vetëm për grumbullimin dhe transportimin e ujërave të ndotura (nga gropat septike) në bazë të kontratës me Ujësjellës Kanalizime SHA Kavajë nr. 144 prot., datë 06.02.2019’;

b. Leja mjedisore III.2.B Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte e dherave me nr. LN-5996 – 10 – 2018 ‘Grumbullim e transportin i mbetjeve inerte e dherave’, i lëshuar sipas Aktit të miratimit me nr. 8213 prot., datë 12.10.2018 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ka cilësuar si vend të kryerjes së veprimtarisë Qarkun Tiranë, rrethin Tiranë, Vorë, Vorë, Adresa lagja Vorë, Rruga e Vjetër, Vorë – Marikaj, Km 1, Godina 4 – katëshe, kati i tretë, nr. 5;

Nga sa më sipër rezulton se OE S. SHPK nuk e plotëson këtë kriter pasi referuar VKM nr. 538, datë 26.05.2009 ‘Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta’, Fusha III Mjedisit dhe burimet mjedisore bazë, pika III ‘Licencimi i veprimtarive të nënkategorisë III.2.B’, pika 8 citohet se: ‘Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria’ e në kushte të tilla ky OE duhet të ishte s’kualifikuar.

Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE në lidhje me kontratat e realizuara dhe ato në proces si dhe Shtojcës 11 rezulton se ky OE ka në proces punime në vlerën e afërsisht 3,000,000,000 lekë.

Për sa më sipër u analizuar rezulton se OE S. nuk plotëson kriteret e përmendura rast pas rasti dhe si i tillë ky OE duhet të ishte s’kualifikuar.

Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE (Sistemi i Prokurimit Elektronik) rezulton se oferta e OE S. nuk është shoqëruar me analizat teknike për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të Udhëzimit nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave, si dhe VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Vendim nr. 664, datë 26.9.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave ‘Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit’”, pika 10 ku përcaktohet se:

Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit e që marrin pjesë në tenderë publike, detyrohen të paraqesin analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave”.

Gjithashtu, kjo mangësi nuk është evidentuar as nga ana e KVO, veprim ky i cili bie ndesh me pikën 11 të VKM si më sipër ku përcaktohet se:

“Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë prokurime të punimeve të ndërtimit me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të kontrollojnë çmimet për zërat e punës, të ofertave të paraqitura në tender, me çmimet e bazuara në manualin e çmimeve të ndërtimit dhe në analizat teknike të këtyre çmimeve. Në rastin kur zëri i punës nuk figuron në manual, institucioni u kërkon subjekteve ofertuese të paraqesin analizën teknike, bazuar në metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave dhe të paraqitur me formatin e unifikuar. ...”.

Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Titullari i AK znj. J.M, anëtarët e KVO znj. R. S, znj. I.D dhe z. I.S.

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”,ku përcaktohet se:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
 b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
 c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
 ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, ku përcaktohet se:

Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

Neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”, ku përcaktohet se:

Pika 3: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji;

Pika 5: Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë:

c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 54 të këtij ligji;

VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, Neni 66, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 3, ku përcaktohet se:

“Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.”

VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Vendim nr. 664, datë 26.9.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave ‘Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit’”, pika 10, pika 11.

Ndikimi/Efekt: Lidhja e kontratës në kushtet e paligjshmërisë.

Shkaku: Mos njohja e kuadrit ligjor që lidhet me këtë procedurë prokurimi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimeve në Bashkia Dimal, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, të marrë masat e duhura që, të mbajë në konsideratë të gjitha aktet ligjore në vlerësimin e OE pjesmarrës në kushtet kur ata plotësojnë të gjitha kërkesat e vendosura nga AK.

2. Procedura e prokurimit me objekt “Shërbimi i pastrimit në Bashkinë Dimal” me të dhënat si më poshtë:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Shërbimi i pastrimit në Bashkinë Dimal”		
1. Urdhër Prokurimi Urdhri nr. 2570 prot., datë 12.08.2021	3. Përlllogaritja e vlerës së Fondit Limit dhe Hartimi i Specifikimeve Teknike Zj. V. J M. B	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 2570/1 prot., datë 12.08.2021 zj. R. S – Kryetare zj. I. D – Anëtare

<p>2. Lloji i Procedurës “E hapur”, “Shërbime”, format elektronik Marrëveshje Kuadër me një OE</p>	<p>A.G M.A E. H A. A R.S LS</p> <p>Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 2570 prot., datë 12.08.2021 zj. M.B, Drejtor i Drejtorisë së Financës zj. N. Ç, Drejtor i Drejtorisë Juridike z. A. P, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit</p>	<p>z. I.S – Anëtar</p>
<p>5. Fondi Limit (pa TVSh) 112,728,140 lekë 5.1 Afati 4 vite</p>	<p>6. Oferta e kualifikuar e para BOE E.K & K. Kontrata me nr. 3401/6 prot., datë 20.10.2021 me vlerë 127,244,278 lekë me TVSH</p>	<p>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 6,691,242 lekë 5.9 %</p>
<p>8. Data e hapjes së tenderit 14.09.2021, ora 08:00</p>	<p>9. Burimi Financimit Bashkia Dimal</p>	<p>10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH) Pjesëmarrës: R.. – 30,641,458 A. C – 102,352,842 BOE E.K & K. – 106,036,898 A.I – G.C – 107,086,400 P. S – pa ofertë Skualifikuar A. C – 102,352,842 P. S – pa ofertë</p>
<p>11. Ankimime</p>	<p>12. Përgjigje Ankesës</p>	

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me shërimin e pastrimit si më sipër është miratuar vlera përkatëse e tij sipas Vendimit nr. 42 datë 09.07.2021 të Këshillit Bashkiak dhe në vijim, është Urdhëruar Drejtoria Juridike nga ana e Titullarit të AK zj, J.M për zbatimin e këtij Vendimi.

Me procesverbalin nr. 2570/2 prot., datë 12.08.2021 është bërë hartimi i Procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim nga ana e NJP. Me shkresën nr. 2570/3 prot., datë 12.08.2021 është bërë miratimi nga ana e Titullarit të AK zj. L.M. Njoftimit të Shkurtuar të Kontratës. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se procedura është anuluar 3 herë dhe është zhvilluar e plotë herën e katërt për shkak të mangësive të herëpashershme, kjo edhe për faktin e ndryshimit LPP dhe RrPP në kohën e zhvillimit të procedurës. Me shkresën nr. 2570/14 prot., datë 31.08.2021 janë dokumentuar sugjerimet e bëra nga a APP dhe me shkresën nr. 2570/17 prot., datë 03.09.2021 është bërë miratimi i Njoftimit për ndryshimin e dokumenteve të tenderit sipas të cilit rezulton se janë reflektuar pjesërisht këto sugjerime të APP. Sipas procesverbalit me nr. 2570/20 prot., datë 03.09.2021 është evidentuar nga ana e KVO se kanë marrë pjese 5 OE. Sipas procesverbalit të vlerësimit me nr. 2570/22 prot., datë 20.09.2021 rezulton se nga ana e KVO janë s’kualifikuar 3 OE dhe janë kualifikuar 2 prej tyre sipas tabelës së mësipërme. Me shkresën nr. 2570/24 prot., datë 20.09.2021 është bërë Njoftimi i Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër nga ana e Titullarit të AK zj. L.M(në mungesë dhe me urdhër porosi nga nën Kryetari zj. L.B). Ky njoftim është publikuar edhe në Buletinin nr. 142 të datës 27 Shtator 2021. Sipas shkresës me nr. 3401 prot., datë 20.10.2021 është bërë miratimi nga ana e Titullarit të AK (në mungesë dhe me urdhër porosi nga nën Kryetari zj. L.B) i Raportit Përmbledhës të Procedurës.

Sipas shkresës me nr. 3401/2 prot., datë 20.10.2021 është mbajtur procesverbali i inventarizimit të dokumentacionit të procedurës (dokumentacioni BOE të shpallur fitues) dhe me shkresën nr. 3401/3 prot., datë 20.10.2021 është lidhur Draft Marrëveshja Kuadër mes BOE dhe Titullarit të AK (në mungesë dhe me urdhër porosi nga N/Kryetari zj. L.B). Me shkresën nr. 3401/4 prot (dhe 34015, ka dy shkresa), datë 20.10.2021 është miratuar Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar dhe në përfundim, sipas aktit me nr. 3401/6 prot., datë 20.10.2021 është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit mes BOE dhe Titullarit të AK zj. J.M (në mungesë dhe me urdhër porosi nga nën Kryetari zj. L.B). Sipas shkresës me nr. 3401/8 prot., datë 21.10.2021 me Urdhër të Titullarit të AK është ngarkuar z. E.H me pozicion përgjegjës i sektorit të mjedisit për monitorimin e zbatimit të kontratës me objekt “Shërbimi i pastrimit në Bashkinë Dimal”. Me shkresën nr. 2401/9 prot., datë 21.10.2021 është miratuar Plani i Zbatimit të Kontratës nga ana e Titullarit të AK zj. J.M (në mungesë dhe me urdhër porosi nga nën Kryetari zj. L.B).

b-Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriereve”:

Titulli i gjetjes: Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara, të ekzagjeruara dhe të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit me objekt “Shërbimi i pastrimit në Bashkinë Dimal”, me fond limit në shumën 112,728,140 lekë pa TVSh dhe me vlerë kontrate në shumën 127,244,278 lekë pa tvsh, me BOE fitues “E.K&K”, rezulton se: Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se në lidhje me xhiron mesatare vjetore janë kërkuar si më poshtë:

1. Kriteri në lidhje me xhiron mesatare vjetore. “OE ofertues duhet të paraqesë xhiro mesatare vjetore e realizuar nga OE gjatë tre viteve të fundit (2018, 2019, 2020) sa dyfishi i vlerës së parashikuar të kontratës, ose xhiroja mesatare vjetore të jetë sa 100 % e vlerës së fondit limit të objektit të prokurimit”. Në fakt kjo kërkesë është kryer në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43 *Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare, pika 5 ku përcaktohet se:*

“Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër”. Sa më sipër rezulton se ky kriter nuk rezulton i argumentuar teknikisht dhe ligjërish. Nga ana e NJP është kërkuar një xhiro mesatare vjetore prej 225,456,280 lekë për 3 vitet ose që xhiroja mesatare vjetore të jetë sa vlera e fondit limit, ose vlera prej 112,728,140 lekë. Në fakt vlera vjetore e përlllogaritur e kontratës për marrëveshjen kuadër është maksimalisht shuma prej 29,419,535 lekë dhe asnjë prej shumave të mësipërme pasi referuar neni 43 është përcaktuar të jetë në bazë të vlerës së kontratës së parashikuar dhe jo në bazë të vlerës së fondit limit, i cili për marrëveshjen kuadër nuk është e njëjta gjë. Për rrjedhojë rezulton se është vendosur një kriter diskriminues për sa i takon kapaciteteve ekonomiko-financiare duke kërkuar një xhiro mesatare vjetore 4 deri në 7.5 herë më të lartë nga ato të parashikuar nga kuadri rregullator përkatës. Gjithashtu konstatohet se në këtë rast NJP nuk ka kryer modifikimin e kriterin edhe pas sugjerimit të bërë nga ana e APP.

2. Kriteri 2.3.4 Vërtetim nga Bashkia –Autoriteti Kontraktor, se ofertuesi nuk ka detyrime ndaj Autoritetit Tonë, të lëshuar jo më vonë se 5 ditë përpara datës së hapjes së ofertës. Do të konsiderohen detyrime të gjitha shumat që janë rrjedhojë e një detyrimi të lindur për taksat vendore”

Në fakt ky kriter nuk rezulton i argumentuar teknikisht dhe ligjërish pas afati prej 5 ditësh nuk është i shoqëruar me ndonjë domosdoshmëri që ka AK dhe si e tillë jo vetëm që nuk është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës por është edhe diskriminuese. Gjithashtu, ky kriter është në kundërshtim me neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të LPP si dhe neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” e RrPP. Në mënyrë të ngjashme si më sipër edhe ky kriter nuk është hequr edhe pas sugjerimeve të bëra nga ana e APP.

3. Kriteri 2.3.2 OE duhet të dëshmojë se disponon një punësim mesatar të paktën prej 35 (tridhjetepesë) personave, për periudhën janar 2021 – qershor 2021, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit duke paraqitur dokumentacionin e poshtëshënuar.

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e kërkuar.

- Listë-pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Në fakt një numër i tillë nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish se përse duhet një staf prej 35 të punësuarish, kjo për vetë faktin se ky numër është shumë më i lartë se mjetet e kërkuara, stafi teknik i kërkuar dhe as nuk përputhet me turnet e parashikuara për të kryer proceset e punës sipas preventivit. Ky sqarim nuk është dhënë nga ana e NJP as pas sugjerimit të APP për të argumentuar këtë numër të punësuarish.

Nga ana e NJP dhe më pas me miratimin e Titullarit të AK zj. J.Mj (në mungesë dhe me urdhër porosi nga nën Kryetari zj. L.B) **rezulton se në mënyrë krejt të paargumentuar specifikimet teknike** të hartuara nga ana e zj. Valentina Jance, zj. M.B, zj. A.G, z. M. A, z. E.H, zj. A.A, zj. R.S si dhe z. I.S janë modifikuar, ndryshim për të cilin nuk është marrë asnjë miratim nga ana e grupit hartues të tyre.

Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se, edhe pas ndërhyrjes dhe sugjerimit të APP rezulton se nga AK nuk janë kryer ndryshimet të kriterëve dhe argumentimi i tyre, të cilat **ndikojnë në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen**, veprime të cilat **bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrin ligjor për prokurimin publik**. Veprime e mosveprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK zj.J.M, zj. L.B si dhe hartuesit e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike Zj. N.C, z. A.P, zj. Valentina Jance, zj. M.B, zj. A.G, z. M.A, z. E. H, zj. A.A, zj. R.S si dhe z. I. S.

Kriteri:Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, në të cilin citohet se;

Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

nenin 3, parimet e përgjithshme në të cialt citohet se;

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Kreu V, neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, pikat 1 dhe 5 ku përcaktohet se;

Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu X, neni 40, pika 3 e cila citon se;

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Nenin 43, pika 5, në të cilën citohet se:

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritjet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

neni 78, pika 2, paragrafi dytë i cili citon se;

... Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Dimal, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 BOE, për të cilët, referuar procesverbalit nr 3086/6 të datës 03/12/2020, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	BOE E. K. SHPK dhe K.	106,036,898	Kualifikuar dhe shpallur fitues

2	BOE A.I G.C	107,086,407	Kualifikuar
3	R..ShPK	30,641,458	<p>S'kualifikuar për arsye se; 1.Ne DST eshte kerkuar makine teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, raport kompaktimi 1:4 - 1:6 0.5-1 ton Ndersa OE ka paraqitur makinen me targa AA 449 PT e cila nuk eshte teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor me raport kompaktimi ,ne lejen e qarkullimit jane shenuar 4 vende gjithsej dhe nuk eshte e pershtatshme per transportimin e mbetjeve.</p> <p>2. Ne DST per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin: leje qarkullimi,certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore (te vlefshme), si dhe mjeti te jete i shoqëruar me foto.</p> <p>Mjeti me targa AA.....A I ka perfunduar siguracioni ne daten 13/08/2021,I ka perfunduar kolaudimi ne daten 31/08/21 dhe nuk ka paguar taksat vjetore per vitin 2021.Taksat vjetore te ketij automjeti kane perfundar me date 19/08/2021</p> <p>3. Ne DST esht kerkuar qe OE per produktin dezinfektues te konteniereve duhet te paraqese autorizim prodhuesi, ose nga distributori i autorizuar i prodhuesit, shoqëruar me kontrate ose dokument angazhimi midis prodhuesit dhe distributorit. Nuk ka paraqitur nje autorizim prodhuesi shoqëruar me kontrate ose dokument angazhimi midis prodhuesit dhe distributorit. - Faza: Kriter i pergjithshem</p>
4	P.. S..	Pa ofertë	S'kualifikuar për arsye se; Nuk ka paraqitur asnjë dokument
5	A..C	102,352,841	<p>S'kualifikuar për arsye se: Nuk ka paraqitur çertifikatë ISO 45001:2018 "Shendeti ne pune dhe sistemi i menaxhimit te Sigurise" (te vlefshme) ose ekuivalente, Nuk ka paraqitur - çertifikatë ISO 14001 – 2015 "Sistemi per menaxhimin mjedisor" (te vlefshme) ose ekuivalente,</p> <p>2. Nuk ka license me kod: III.2.B, qe te mbulojne aktivitetin "Pastrim, grumbullim, transportim i mbetjeve urbane.</p> <p>3. Nuk ka përvojë te suksesshme në realizimin "Pastrim, grumbullim, transportim i mbetjeve urbane</p> <p>4. Nuk ka paraqitur Makinerite dhe Mjetet teknologjike te kerkuara ne DST.</p> <p>5..Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes</p> <p>6.Nuk eshte paraqitur numri i kerkuar i shofereve etj.</p>

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës me nr. 3086/8 datë 11/12/2020, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, në të cilën ka marrë pjesë dhe është kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 11/12/2020. ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë Bashkimi i operatorëve ekonomikë M..SHPK, nipt J.....R, N.. 2.. SHPK nipt L.....L, për të cilën është lidhur kontrata datë 17/12/2020 për vlerën 33,785,665 lekë pa TVSH dhe vlera 40,536,199 lekë me TVSH, dhe me afat 6 muaj, nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Sigurimi i ofertës së lëshuar për OE-E. K është lëshuar me kusht nga ana e lëshuesit të sigurimit, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 285 datë 19.05.2021, neni 30 *Sigurimi i Ofertës*, pika 4 ku përcaktohet se:

4. Lëshuesi i sigurimit të ofertës duhet:
a) të mos vendosë asnjë kusht për pagimin;

b) të paguajë shumën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës zyrtare të autoritetit/entit kontraktor.

3. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje Karburant” me të dhënat si më poshtë;

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Blerje karburant”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e Hapur Marrëveshje Kuadër” Urdhri nr. 3474 prot., datë 24.11.2020	1.1 Specialistët e hartimit të fondit limit Urdhri nr. 3440, datë 20.11.2020 1. B. R, 2. A. G 3. A. A	2 Njësia e Prokurimit dhe sp.teknike Urdhri nr. 3474prot, datë 24.11.2020 1. M.B 2. N.Ç 3. A.P	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 3474/1 prot., datë 24.11.2020. 1.R.S 2.I.D 3.I.S
4. Fondi Limit (pa tvsh) 24,000,000 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: 24,000,000 lekë pa tvsh.		6. Diferenca me fondin limit Marzh fitimi
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data	8. Burimi Financimit Buxheti i shtetit.		9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE , c) Kualifikuar 1OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 24 muaj			
10. Ankimime AK-s’ka/ka; ka APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 3474/21 datë 27.01.2021		12. Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Me urdhrin e prokurimit nr. 3474 prot, datë 24.11.2020, nga titullari i AK zj. J.Mj është urdhëruar Njësia e Prokurimit e përbërë prej M.B, N.Ç dhe A.P, për fillimin e procedurës me objekt “Blerje Karburant”, për nevoja të AK, me afat për dy vjet, për vitin 2021 dhe vitin 2022, me fond limit në shumën 24,000,000 lekë pa TVSH. Lloji i procedurës është përcaktuar e Hapur, Marrveshje Kuadër.

AK në lidhje me “Përlllogaritjen e Fondit Limit”:

Titulli i gjetjes: Llogaritja e fondit limit të kontratës jo në përputhje me kuadrin ligjor.

Situata: Nga auditimi i dokumentacioni të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karburanti”, me fond limit në shumën 24,000,000 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate në shumën 24,000,000 lekë pa TVSh me marzh fitimi 16.1% ose 17 lekëliter, pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. 3440 datë 20.11.2020 “Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit”, i përbërë nga B. R., A.Gj. dhe G.H. Sipas procesverbalit të datës 3440/1, të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “çmimin në buletin e APP-së”, nr. 101 datë 16.11.2020 dhe kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë. Fondi limit është përcaktuar në shumën 24,000,000 lekë, për sasinë 204,877.8 litra. Në dosjen e prokurimit nuk rezulton të jetë argumentuar dhe justifikuar sasia e parashikuar. Referuar të dhënave të vëna në dispozicion për vitet e mëparshme rezulton se sasia e konsumuar për vitin 2018 është 71,707 litra, për vitin 2019 është 61,963 litra dhe për vitin 2020 është 79,960 litra. Pra referuar 3 viteve të mëparshme sasia mesatare e konsumuar është 71,210 litra. Për vitin 2021 janë parashikuar 102,439 litra sikurse edhe për vitin 2022. Kjo sasi nuk është argumentuar se përse është parashikuar reth 22,479 litra më tepër nga viti 2020, dhe 44,958 litra

më tepër për të dy vitet. Autoriteti Kontraktor nuk ka siguruar një përshkrim të mallrave që nevojiten për nisjen e procedurës, nuk ka siguruar të dhëna të nevojshme nga strukturat përkatëse për parashikimin e sasisë që nevojiten për realizimin e procedurës, të cilat duhet të argumentonin vlerën e kontratës, pra nuk është dokumentuar dhe argumentuar llogaritja e vlerës së kontratës pasi nuk justifikohet sasia e parashikuar në llogaritjen e vlerës së kësaj procedure. Bazuar në çmimin e ditës i cili është marrë për llogaritjen e fondit limit i cili është 117,143 lekë pa TVSH me sasinë prej 44,958 litra e pa argumentuar arrihet në konkluzion se vlera prej **5,266,514 lekë konsiderohet vlerë e pa argumentuar e fondit limit** me pasojë përdorimin e fondeve publike jo në përputhje me parimet e efijencës dhe efektivitetit. Gjithashtu nuk rezulton të jetë argumentuar përzgjedhja e llojit të kësaj procedure prokurimi si Marrëveshje Kuadër. *Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK Zj. J.M dhe komisioni i llogaritjes së fondit limit z. B.R, zj. A. G dhe zj. A.A.*

Veprime e mosveprime jo në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 12, pika 2/a, ku citohet se:

Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbal edhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit.

a) njëpërshkrimtë shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;

VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 45/1 pika 2, neni 59, pika 2, ku ndër të tjera citohet se;

Në rastin kur autoriteti kontraktor e ka të pamundur të përcaktojë sasinë e objektit të prokurimit, për efekt të përllogaritjes së vlerës së marrëveshjes kuadër duhet t’u referohet, për aq sa është e mundur, nevojave të planifikuara dhe/ose nevojave të mëparshme për këtë objekt.

Ndikimi/Efekti: Diferenca e pa argumentuar e fondit limit të përdorur në këtë procedurë prokurimi me ndikim në buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë, mund të përdorej për nevoja të tjera të saj, në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit.

Shkaku: Mos njohja e kuadrit ligjor që lidhet me këtë procedurë prokurimi.

Rëndësia: E ulët.

Rekomandimi: - Autoriteti Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimeve në Bashkia Dimal, të marrë masat e duhura që, të mbajë në konsideratë të gjitha aktet ligjore në llogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim përdorimin e fondeve me ekonomicitet.

- Autoriteti Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimeve në Bashkia Dimal, të marrë masat e duhura që përpara hartimit të urdhrimit të prokurimit të argumentojë përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit me qëllim kryerjen e një procesi transparent dhe të besueshëm të procesit.

Në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

Titulli i gjetjes: Kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike, të pa argumentuara dhe të panevojshme për pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Situata: Specifikimet teknike për këtë procedurë janë hartuar nga Njësia e Prokurimit e cila ka hartuar dhe Dokumentet e Tenderit. Nga dokumentat e dosjes rezulton se specifikimet teknike nuk janë në asnjë rast të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht. Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga Njësia e Prokurimit të cilat janë evidentuar në procesverbalin nr. 3474/2, te datës 24.11.2020, të cilat janë si më poshtë;

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilancit të 2017, 2018 dhe 2019, të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

2.2.2 Ofertuesi duhet të tregojë se teknikisht është në gjendje të realizojë qëllimin e prokurimit. Për të provuar mundësinë e tij teknike për këtë prokurim, ofertuesi duhet të paraqesë, kontratat e furnizimit të mallrave të ngjashme, me vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit të tre viteteve të fundit.

Për të vërtetuar pikën e mësipërme Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim nga Enti Publik që ka lidhur kontratën, për ekzekutimin e kontratës pa të meta, kontratën me entin publik si dhe faturën tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

2.2.3 Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore të vitit 2019, të jetë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

2.2.4 Formularin e ofertës sipas Shtojcës 1 ose shtojcë 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje); Ofertuesi në këtë formular, do të shprehë marzhin e fitimit, në vlerë absolute dhe përqindje; Ofertuesi së sistemit do të ofertojë me vlerën totale të përlllogaritur sipas cmimit të bursës, kursin e Bankës së Shqipërisë dhe taksat e tjera sipas ligjit.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një raport analizimi të cilësisë të karburantit që kërkohet, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror i Kontrollit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në Republikën e Shqipërisë brenda vitit 2020.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Akt Teknik të lëshuar nga PMNZH dhe Policë Sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë (me vetëdeklarim) se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatat e sigurisë si më poshtë:

- EN-ISO 9001:2015
- BS OHSAS 18001:2007
- EN-ISO 14001:2015
- BS PAS 99:2012

2.3.5 - Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi një pike karburanti nën juridiksionin e Bashkisë Ura Vajurore.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

2.3.6 Leje për tregtim të karburantit të lëshuar nga Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë vërtetim teknik të lëshuar nga IQT për depozitat me kapacitet jo më pak se 85,000 litra.

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë kalibrimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit për depozitat.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të ketë pasur mesatarishte jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për periudhën Janar 2019–Dhjetor 2019. Për të vërtetuar këtë, ofertuesi të paraqesë vërtetim nga organet tatimore për periudhën e mësipërme si dhe listëpagesat.

2.3.10 Ofertuesi të sigurojë furnizimin edhe në rastet e emergjencave për karburant gjatë punimeve për eliminimin e avarive në vende që ndodhen larg pikave të furnizimit. Për këtë qëllim ofertuesi duhet të ketë mjet të posaçëm (autobot) të kalibruar, jo më pak se 5,000 litra, të pajisur me aparat matës (debitmatës) dhe të licensuar me certifikate për transport mallrash të rrezikshme.

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të ketë një raport vetëmonitorimi të mjedisit, të vlefshëm për vitin 2019-2020, të realizuar dhe konfirmuar nga një inxhinier Mjedisit i licensuar.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë kopjen e certifikatës së pronësisë për sheshin, si dhe formularin për lidhjen e objektit me infrastrukturën.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, për më tepër që OE mund të ketë kontratë qiraje për ushtrimin e aktivitetit të tij, çka e bën këtë kriter kufizues për pjesëmarrësit.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të ketë certifikatën e përdorimit/shfrytëzimit të objektit, të lëshuar nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, për më tepër që ky kriter është objekt i legjislacionit të cilin janë organet kompetente që kontrollojnë zbatimin e tij.

2.3.14 Operatori ekonomik duhet të ketë vërtetimin e kontrollit të objektit, për respektimin e kushteve teknike, të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Përgjegjës.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, për më tepër që ky kriter është objekt i legjislacionit të cilin janë organet kompetente që kontrollojnë zbatimin e tij.

2.3.15 Operatori ekonomik duhet të paraqesë projektin teknik të kryqëzimit të rrugës me hyrje-daljen ku të jenë të përcaktuar të gjitha hyrje-daljet ekzistuese të kësaj zone, në përputhje me kërkesat e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.10488 datë 5.12.2011 “Hyrje dhe Degëzime” dhe VKM nr.153 datë 153 datë 7.4.2000 dhe gjithashtu kërkesën për hyrje-dalje e protokolluar nga organi kompetent.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, për më tepër që ky kriter është objekt i legjislacionit të cilin janë organet kompetente që kontrollojnë zbatimin e tij.

2.3.16 Operatori ekonomik duhet të paraqesë projektin teknologjik të depove dhe linjave, të miraturara nga organet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi referuar VKM nr. 970, dt 2.12.2015.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, për më tepër që ky kriter është objekt i legjislacionit të cilin janë organet kompetente që kontrollojnë zbatimin e tij.

2.3.17 Operatori ekonomik duhet të pajise me karta elektronike për identifikimin e mjetit dhe përdoruesit ekonomik të saj sipas kërkesës nga Autoriteti Kontraktor. Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesi një deklaratë me shkrim ku merr, përsipër realizimin e kartave elektronike.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

Nëpërmjet postës elektronike nga APP ka mbëritur një rekomandim i APP në lidhje me vendosjen e kriteve të pa argumentuara, specififikimet teknike të pa argumentuara dhe llogaritja e fondit limit e pa argumentuar. Në lidhje me këtë rekomandim, nga AK me nr. 3474/6prot, datë 16.12.2020, është urdhëruar pezullimi i procedurës së prokurimit, rishikimi i DT-ve në përputhje me rekomandimet e APP-së.

Njësia e Prokurimit ka vendosur modifikimin e kriteve si më poshtë:

1. Ishte

Në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: *“Operatori ekonomik duhet te kete pasur mesatarishte jo me pak se 10 (dhjetë) punonjës për periudhën Janar 2019 – Dhjetor 2019. Për të vërtetuar këtë, ofertuesi të paraqesë vërtetim nga organet tatimore për periudhën e mësipërme si dhe listëpagesat”*

Bëhet

Në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: *“Operatori ekonomik duhet te kete pasur mesatarishte jo me pak se 7 (shtatë) punonjës për periudhën Janar 2020 – Tetor 2020. Për të vërtetuar këtë, ofertuesi të paraqesë vërtetim nga organet tatimore për periudhën e mësipërme si dhe listëpagesat”*.

Ky kriter edhe pse është ndryshuar, nga 10 punonjës në 7 punonjës, përsëri nuk rezulton të jetë i argumentuar ligjërisht se përse janë kërkuar që OE ofertues të ketë jo më pak se 7 punonjës.

2. Ishte

Në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: *“Operatori ekonomik duhet të jetë I pajisur me Certifikatat e sigurisë si më poshtë:*

EN-ISO 9001:2015

BS OHSAS 18001:2007

EN-ISO 14001:2015

BS PAS 99:2012”

Bëhet:

SSH ISO 45001:2018 : Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë - Kërkesat me udhëzime për përdorim (ose ekuivalente).

Ky kriter edhe pse është ndryshuar, sipas rekomandimit të APP-së përsëri nuk rezulton të jetë i argumentuar ligjërisht.

-Nga sa më sipër rezulton se kriteret e mësipërme por jo vetëm, të kërkuara nga AK, ***ndikojnë në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen***, veprime të cilat ***bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik***. Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK zj. J.M dhe zj.N. Ç në cilësinë e përgjegjësit të prokurimeve, zj. M.B dhe z. A.P në cilësinë e anëtarëve të NjP.

Kriteri: Ligjinr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 ku citohet se;

Qëllimi i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;

- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë ëpjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

nenin 2, parimet e përgjithshme në të cialt citohet se;

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet nëp ërputhje me këto parime të përgjithshme:

- a) mos diskriminim dhe trajtimi barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;
- b) transparencë në procedurat e prokurimit;
- c) barazinë trajtimit të kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

neni 12, Përgjegjësia e autoritetit kontraktor, pikat 1 dhe 5 ku përcaktohet se;

Autoriteti kontraktor është ëpërgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 3 e cila citon se;

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

neni 61, pika 2, paragrafi dytë i cili citon se;

...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Dimal, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

Titulli i gjetjes: Në Njësinë e Prokurimit dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave nuk ka specialistë të fushës.

Situata: Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës të prokurimit me objekt “Blerje Karburant për vitin 2021 dhe vitin 2022”, rezulton se; në Njësinë e Prokurimit nuk asnjë specialist të fushës i cili të ketë njohuri të specializuara për objektin që prokurohet me qëllim argumentimin tekniko/ligjor të kriterëve të kualifikimit, referuar specifikimeve teknike të caktuara, në Dokumentet e Tenderit. Gjithashtu në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave nuk ka asnjë specialist apo ekspert të fushës së objektit që prokurohet i cili të ketë njohuri të

specializuara për objektin që prokurohet. *Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK zj. J.Mj dhe zj.N.C në cilësinë e përgjegjësit të prokurimeve.*

Kriteri: VKM nr. 914, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 57, pika 2, në të cilin citohet se;

Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit kontraktor krijon njësinë e prokurimit, në përbërje të së cilës është personi përgjegjës për prokurimin, i caktuar në fillim të vitit dhe të paktën një specialist fushë në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit.

dhe nenin 58 ku citohet se;

Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës.

Ndikimi/Efekti: Procedura e prokurimit paraqet një risk në përgatitjen e dokumentacionit të duhur ligjor, si dhe fazën e vlerësimit të ofertave.

Shkaku: Mosrespektimi i kuadrit rregullator ligjor për Prokurimin Publik.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Dimal, në ngritjen e komisioneve për kryerjen e procedurave të prokurimit, të ketë persona me njohuri në fushën e objektit të prokurimit, me qëllim vendimmarrje, menaxhim dhe vlerësim objektiv të procedurave të prokurimit.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 3474/15prot, të datës 12.01.2021, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	G. SHPK	17 lekë 16.1%	Kualifikuar
2	A&T SHA	11 lekë 10.22%	S'kualifikuar; (Me arsytet mbi mos plotësimin e dokumentacionit të kriterëve të kualifikimit sipas procesverbalit të mbajtur nga KVO)

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës me nr. 3474/16prot, më datë 20.01.2021, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 1 OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 20.01.2021 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “G. SHPK” për të cilën është lidhur kontrata me nr. 3474/21 datë 27.01.2021 për vlerën 12,000,000 lekë pa TVSH dhe vlera 14,400,000 lekë me TVSH, midis AK Bashkia Dimal përfaqësuar nga zj. L.B dhe OE fitues përfaqësuar nga z. G. H, me afat 11 (njëmbëdhjetë) muaj/deri më 31.12.2021 me marzh fitimi 17 lekë/litër.

Mbi zbatimin e kontratës:

Titulli i gjetjes: Në komisionin e marrjes në dorëzim, nuk ka specialistë të fushës, nuk është raportuar për zbatimin e kontratës në APP.

Situata: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi auditimin e zbatimit të kontratës së furnizimit me karburant për vitin 2021 konstatohet se; me urdhrin nr. 577, datë 12.02.2021 nga zj. J.Mj në cilësinë e titullarit të AK është krijuar komisioni për marrjen në dorëzim të

karburantit me përbërje A.G, A. G. e G.H. Nga përbërja e komisionit të krijuar për marrjen në dorëzim të mallit dhe zbatimit të kontratës konstatohet se asnjë nga anëtarët e komisionit nuk është specialist i fushës. Gjithashtu konstatohet se nuk është hartuar raport për monitorimin e zbatimit të kontratës, për t'u siguruar se cilësia e mallrave të furnizuara ka qënë ose jo në përputhje me cilësinë për të cilën OE kontraktues është shpallur fitues i kësaj procedure, ku më pas duhet të raportohet edhe në APP. *Veprime për të cilat mban përgjegjësi titullari i AK zj. J.M dhe përgjegjësi i prokurimeve zj. N.Ç.*

Kriteri: VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77, pika 3, pika 4, ku citohet se:

Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës.

Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin.

Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 43, ku citohet se:

Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale.

Ndikimi/Efekti: Nga ngritja e komisionit pa specialistë të fushës, nuk garantohet marrja e mallit në përputhje me kushtet e kontratës.

Shkaku: Mosrespektimi i kuadrit rregullator ligjor për Prokurimin Publik.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Dimal, në zbatimin e kontratave të furnizimit të marrë masat për të hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të kontratës, për t'u siguruar se cilësia e mallrave të furnizuara ka qënë ose jo në përputhje me cilësinë për të cilën OE kontraktues janë shpallur fitues.

Titulli i gjetjes: Furnizim me karburant jashtë fondeve të buxhetit të miratuar, pa kryer procedurë prokurimi.

Situata: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi auditimin e zbatimit të kontratës së furnizimit me karburant për vitin 2021 konstatohet se; Me datën 15.12.2012, referuar fletëhyrjes në magazinë me nr. 66, marrë në dorëzim nga magazinieria zj. G. H është bërë hyrje sasia me karburant 12,520 litra “Naftë”, sipas faturës së OE “G.”, me nr. 432, datë 15.12.2021. Është mbajtur procesverbali nga komisioni i përbërë prej z. A.G, zj. A.G, dhe zj G. H. Në këtë procesverbal komisioni shprehet se kjo sasi është bërë hyrje sipas kontratës së nënshkruar pa nr. __prot., datë 15.12.2021 me vlerë 2,140,419 lekë me TVSh. Në këtë procesverbal komisioni shprehet gjithashtu se “Sipas kërkesave të njëjstëve shpenzuese përkatëse komisioni mori në dorëzim sasinë prej 12,520 litra me vlerë 2,140,419 lekë. Nga sa më sipër konstatohet se **shuma prej 2,140,419 lekë është shpenzim financiar i pa argumentuar** për buxhetin e Bashkisë Dimal. Ky shpenzim është njohur dhe në kontabilitet nga nëpunësi zbatues, duke e njohur si detyrime në Pasqyrat Financiare të Bashkia Dimal të vitit 2021. Rast i cili konsiston në marrjen përsipër të një angazhimi të pa parashikuar në buxhetin e vitit 2021 për të cilin nuk janë

parashikuar fonde në dispozicion, duke shmangur gjithashtu kryerjen e procedurave standarte të prokurimit, mostrajtimin e barabartë të OE, shmangien e konkurrencës, etj. *Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e Bashkisë Dimal zj. J.M, zj. M.B dhe anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim z. A. G, zj A.G dhe zj. G.H.*

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshar, neni 3, pika 38, neni 40, ku citohet se;

“Fondet e miratuara në vendimin për buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore përbëjnë kufirin maksimal të shpenzimeve, brenda të cilit kryetari i njësisë së qeverisjes vendore është i autorizuar të marrë përsipër angazhime dhe të kryejë shpenzime”,

Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 2, neni 3.

Ndikimi/Efekti: Shpenzime buxhetore jashtë fondeve të miratuara në shumën 2,140,419 lekë të cilat konsiderohen shpenzime pa efektivitet, efizienz dhe efikasitet.

Shkaku: Mosrespektimi i kuadrit rregullator ligjor për Buxhetin dhe PP.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Drejtorja e Ekonomisë dhe Financës, të marrin masat e duhura për miratimin e fondeve përkatës në Këshillin Bashkiak para kryerjes së shpenzimeve dhe iniciativave të angazhimeve buxhetore.

Në lidhje me konstatimet e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karburanti”, nuk janë paraqitur observacione nga subjekti i audituar.

4. Procedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i shkollës Qëndër Komunitare “Llambi Mile Ciflig, Bashkia Ura Vajgurore” me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës Qëndër Komunitare “Llambi Mile Ciflig, Bashkia Ura Vajgurore”			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur Urdhrinr.3086 datë 22/10/2020	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit	2 Njësia e Prokurimit 1. M.B 2. N.C 3. A.P	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.3086/1 prot., datë 22/10/2020. 1. R.S 2.I.D 3.I.S
4. Fondi Limit (pa tvsh) 33,840,667 lekë Kontratë financimi prot 2889 datë 06/10/2020, me I.... P..., botuar në gazetën Koha Jonë datë 21 Tetor 2020.	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë M.SHPK, nipt J.....R, N. 2 .. SHPK nipt L.....L Oferta fituese: 33,782,665 Lekë pa tvsh.		6. Diferenca me fondin limi 58 001.17lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 23/11/2020	8. Burimi Financimit Projekti Italian –Albanian Debt for Development Sëap Agreement –IADSA II ,		9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Bashkimi i operatorëve ekonomikë M...SHPK, nipt J.....R, N.2.. SHPK nipt L.....L b) Kualifikuar: Bashkimi i operatorëve ekonomikë M. SHPK, nipt J.....R, N. 2.. SHPK nipt L.....L
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj nga momenti i nëshkrimit të kontratës .			
10.Ankimime AK-s’ka/ka; Nuk ka APP-s’ka/ka;	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 3086/10, prot, datë 17/12/2020.		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: Nuk ka

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

Bazuar në marrëveshjen e projektit të financimit me nr. 2889prot., datë 06.10.2020, nënshkruar nga Financuesi IADSA(Italian-Albanian Development Svrap Agreement), përfaqësues i Shteti Italian z. N..M Ambasador i Italisë në Shqipëri, përfaqësues i shtetit shqiptar zj. A. D Ministër i Financave dhe zj. J.M Kryetar i Bashkisë Dimal, është miratuar marrëveshja e financimit të projektit me objekt “Rikonstruksion i Shkollës Llambi Mile” në Ura Vajgurore”, me vlerë financimi në shumën 40,608,800 lekë, Grant për Bashkia Dimal. Kjo procedurë është shpallur në gazetën Koha Jonë me nr. 217, datë 21.10.2020 në artikullin e faqes nr. 5.

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit”:

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se relacioni teknik është hartuar nga A.D..Licensë M...../3, projekti teknik nga B. M nr.lic E-...../6, dhe Inxh L.M. dhe K.J..

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej 1-A.P-Arkitekt, M.B-Ekonomiste dhe N.C-Juriste, janë evidentuar në procesverbalin nr. 3086/2prot, të datës 22/10/2020. të cilat janë si më poshtë;

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Për të vërtetuar se operatorët ekonomikë janë të kualifikuar ofertuesi duhet të paraqesë:

-Shtojcat sipas DST

-Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë kete dokument).Kjo pike duhet te vërtetohen përmes dokumentit të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

2. Për të vërtetuar se operatorët ekonomikë janë të kualifikuar ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë,

1. Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të Kontrates.

a. **License profesionale sipas modelit të leshuar MPPT e Shoqërise e vlefshme me kategorie:**

- NP-1 A
- NP-2 A
- NP-3 A
- NS-1 A
- NS-4 A
- NS – 18 A

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

c. Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik ose Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt, te perfshire ne

licensen e shoqerise dhe të deklarojne se do të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem:

i. CV perkatese

ii. Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Vlerësimi i gjendjes ekonomike e financiare të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) **Kopje të deklarimit të xhiros mesatare vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit e cila duhet të ketë një vlerë minimalisht sa fondi limit pa tvsh lëshuar nga autoriteti përkatës;**

b) **Kopje të vërtetuara të bilanceve të tre viteve të fundit të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse;**

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

2.3 Kapaciteti teknik:

II. Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

1. Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a. Kontrata të ngjashme me punime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit, të paktën **50% e fondit limit pa tvsh**, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit; ose

b. Kontrata të ngjashme me punime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit, ku vlera totale e punës së tre viteve të fundit është të paktën sa dyfishi i fondit limit pa T.V.SH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

i. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me:

- Kontrate punimesh
- Situacionin përfundimtar
- Akt marrjen ne dorëzim
- Akt Kolaudimi i Objektivit
- Formular Vleresimesi

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim! Per kontrata të realizuara me subjekte private duhet te paraqiten Kontrata, Situacioni, Fatura tatimore dhe vertetim realizimi.

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

2. Një punësim mesatar i të paktën 30 personave, për periudhën Qershor 2020 deri ne Gusht 2020 të vërtetuar me;

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen perkatese

-List pagesat e punonjesve për periudhën perkatese te konfirmuar nga Administrata Tatimore.

Subjekti te kete te punesuar Ing.Ndertimi, Ing.Mekanik, Ing.Mjedisi (Me cerrifikim per auditim mjedisor), Ing.Elektrik, Ing.Hidroteknik, Ing.Topograf, Ing.Gjeolog, Keto Inxhiniera duhet te jene te punesuar me kontrate pune me kohe te plote.

Per Inxhinierat e mesiperm te paraqiten kontratat e punes, cv dhe diplomat e tyre.

Njeri prej Ing.te jete i certifikuar si koordinator per sigurine ne pune

Punonjes te certifikuar nga IQT, me profesione te ndryshme ne fushen e ndertimit, ku te jene: (, Manovrator 7, Karpentier 2, Hekurthyes 1, Teknik Ndertimi2, Shofera 5, Saldator 2,) te jene te deklaruar ne listepagesa me keto profesione. Per Teknikun e ndertimit te paraqitet edhe diploma/deftese e shkolles se mesme, 5 Punetor ne Lartesi. Te kete te punesuar Mjek me kontrate, Cv dhe Diplome.

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjrisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës

3. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 9)

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA Minimumi
1.	Kamiona mbi 18 ton	ne pronesi ose me qera	cope 3
2.	Betoniere	ne pronesi ose me qera	cope 4
3.	Vibratora	ne pronesi ose me qera	cope 2
4.	Kamioncina	ne pronesi ose me qera	cope 2
5.	Autovinc	ne pronesi ose me qera	cope 1
6.	Karroca dore	ne pronesi ose me qera	Cope 8
7.	Kokore	ne pronesi ose me qera	30 cope
8.	Jelek per veshje	ne pronesi ose me qera	30 cope
9.	Doreza pune	ne pronesi ose me qera	30 cope
10.	Tabela sinjalizuese	ne pronesi ose me qera	4 cope
11.	Fadroma	ne pronesi ose me qera	1 cope
12.	Eskavatora	ne pronesi ose me qera	2 cope
13.	Autopompe betoni	ne pronesi ose me qera	1 cope
14.	Autobetoniere	ne pronesi ose me qera	2 cope Njera te jete mjet teknologjik per prodhim betoni ne vend
15.	GPS (Total Station)	ne pronesi ose me qera	1 cope
16.	Saldatrice	Ne pronesi ose me qera	2 cope

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: Leje qakullimi, siguracion, kolaudim, taksa, leje transporti, foto dhe duhet të shoqerohet me kontraten përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Nëse mjetet janë të marra me qera, ofetuesi duhet të jete i pajisur me licence transporti për të trete.

b) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

c) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronesi ose me qera me qellim verifikimi).

Ç) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin kontrate furnizimi materiale me Beton, Inerte, Rere dhe Zhavorr. Furnizuesi duhet të jete i pajisur me

- Licence QKL III.1.B “Leje mjedisore tipi B, per aktivitetit Impiant Franksionim Inertesh”,
 - Licence QKL III.1.A “Autorizim mjedisor per aktivitetin Linje Prodhim Betoni”.
- e) Operatoret duhet te paraqesin nje maresveshje te dokumentuar me nje laborator te licencuar per kryerjen e analizave te betonit.

-Subjekti duhet te jete i pajisur me :

- Certifikate ISO 9001:2008
- Certifikate ISO 14001:2004
- Certifikate ISO 18001:2007
- Certifikate ISO 39001:2012

Certifikatat duhet te jene ne gjuhen e ofertes, dhe ne perputhje me natyren e objektit qe tenderohen. Ne rast bashkimi te operatoreve ekonomik, te gjitha oepatoret duhet te kene certifikatat ne perputhje me perqindjen dhe punimet perkatese qe marrin persiper te realizojne. Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjrisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

Nga sa më sipër rezulton gjithashtu se nga AK përveç shmangies nga kuadri ligjor për Prokurimin Publik, nuk ka mbajtur parasysh as rregullat e vendosura në Aneksin 1, bashkëlidhur Marrëveshjes së financimit e cila ka parashikuar një sërë kriteresh dhe kushtet për kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë konkurimi.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 BOE, për të cilët, referuar procesverbalit nr 3086/6 të datës 03/12/2020, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	Bashkimi i operatorëve ekonomikë M..SHPK,nipt J.....R, N..2.. SHPK nipt L.....L	33,782,665	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës me nr. 3086/8 datë 11/12/2020, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, në të cilën ka marrë pjesë dhe është kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 11/12/2020. ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë Bashkimi i operatorëve ekonomikë M. SHPK, nipt J....R, N..2..SHPK nipt L.....L, për të cilën është lidhur kontrata datë 17/12/2020 për vlerën 33,785,665 lekë pa TVSH dhe vlera 40,536,199 lekë me TVSH, dhe me afat 6 muaj, nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Titulli i gjetjes: Kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike, të pa argumentuara dhe të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Situata: Nga auditimi i procedurës me objekt “Rikonstruksion i shkollës Qëndër Komunitare “Llambi Mile Ciflig, Bashkia Ura Vajgurorë”, me fond limit në shumën 33,840,667lekë pa TVSh, dhe me vlerë kontrate në shumën 33,782,665 lekë pa TVSh, me BOE fitues “M. SHPK & N..2..SHPK”, në të cilën ka marrë pjesë 1 BOE, konstatohet se: Procedura e kryer për këtë invensitm është bazuar në marrëveshjen e projektit të financimit me nr. 2889prot., datë 06.10.2020, nënshkruar nga Financuesi IADSA(Italian-Albanian Development Svpap

Agreement), përfaqësues i Shteti Italian z. N. M. Ambasador i Italisë në Shqipëri, përfaqësues i shtetit shqiptar zj. A. D. Ministër i Financave dhe zj. J.M Kryetar i Bashkisë Dimal, është miratuar marrëveshja e financimit të projektit me objekt “Rikonstruktion i Shkollës Llambi Mile” në Ura Vajgurore”, me vlerë financimi në shumën 40,608,800 lekë, Grant për Bashkia Dimal. Kjo procedurë është shpallur në gazetën Koha Jonë me nr. 217, datë 21.10.2020 në artikullin e faqes nr. 5. Në këtë procedurë nuk janë mbajtur parasysh as kërkesat e udhëzuesit për implementimin e projektit për kërkesat dhe kushtet e vendosura në aneksin L-1, bashkëlidhur marrëveshjes së financimit me nr. 2889 prot., datë 06.10.2020. Në këtë procedurë vendosja e kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, si dhe specifikimet teknike të vendosura për mallrat e kërkuara, nuk është e sqaruar në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, si licencat e kërkuara, numri i fuqisë punëtore, certifikatat e kërkuara etj., veprim ky jo në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, ku përcaktohet se:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”, ku përcaktohet se:

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

- a) mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;
- b) transparencë në procedurat e prokurimit;
- c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 26, “Kontratat për punë publike”, ku përcaktohet se:

- 3) *Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës;*
- 5) *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*

Neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, ku përcaktohet ndër të tjera se:

.....Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjorisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Dimal, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kritereve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

5. Procedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Sheq-Gajdë”, me të dhënat si më poshtë”

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Rikonstruksioni i rrugës Sheq-Gajdë”			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur REF-40445-0-01-20 Urdhri nr.2406 prot, datë 29.08.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhrin 312/5datë 20.08.2022 4. M. D. 5. A.P 6. I.S	2 Njësia e Prokurimit 1. M.B\ 2. .B B 3. A.P	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr.2406/1 prot. datë 29/08.2022 1.R.S 2.I.D 3.I.S
4. Fondi Limit (pa tvsh) 60 391 938 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: 57,305,850 lekë pa tvsh. Operatori Fitues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë K ShPK, nipt J.....H, dhe F. ShPK, nipt K....C	6. Diferenca me fondin limit 19,891,557 lekë pa tvsh	
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 26/09/2022	8. Burimi Financimit Të ardhurat e veta	Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender: 1.Bashkimi i operatorëve ekonomikë K.... ShPK, nipt J....H, dhe Fled ShPK, nipt K.....C. 2.Bashkimi i operatorëve ekonomikë L.. ShPK, nipt K.....K, V. K. SHPK, nipt K.....L, E-A ShPK, nipt K.....H. b) OE S’kualifikuar, Bashkimi i operatorëve ekonomikë L..ShPK, nipt K.....K, V. K. SHPK, nipt K.....L, E.A ShPK, nipt K.....H. c) Kualifikuar 1.Bashkimi i operatorëve ekonomikë K..... ShPK, nipt J....H, dhe F. ShPK, nipt K.....C	
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 28 ditë			
10.Ankimime AK-s’ka/ka; ka APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 2406/29 prot, datë 05/01/2023.	12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK	

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

Nëse për t skam argumentuar proceduren e prokurimit me objekt rikualifikimi urban në zonën e dimalit si dhe rruga e skualifikuar specifikimiet teknike.

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlogaritjen e Fondit Limit” :

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr.312/5 datë 20/08/2022“Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit”, i përbërë nga A.P, M.. D., I. S. Sipas procesverbalit të datës 25/08/2022 të mbajtur për efekt të pasqyimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për

përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e Vendimin nr 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të cimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre” duke përlllogaritur si fond limit vlerën e cila rezulton të jetë 60 391 938 lekë pa tvsh. Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, është ngritur një komision me urdhrin nr.312/5 datë 25/08/2022 “Për krijimin e komisionit të hartimit të specifikimeve teknike”, i përbërë prej A.P, M. D., I. S. Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me nr. 312/6 datë 29/08/2022, nga komisioni i krijuar për këtë qëllim.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej M.B-Ekonomiste, A.P-inxhinier, B. B -Ekonomiste, të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 01/09/2022.

Titulli i gjetjes:Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara dhe të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, gjithashtu specifikimet teknike nuk janë të argumentuara.

Situata: Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës Sheq-Gajdë”, me fond limit në shumën 60,391,938 lekë, në fazën e kryerjes së procedurës për hartimin e kriereve u konstatua se; kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish. Gjithashtu konstatohet se edhe pas ndërhyrjes dhe sugjerimit të APP rezulton se nga AK nuk janë kryer ndryshimet të kriereve dhe argumentimi i tyre, të cilat ndikojnë në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik, konkretisht si më poshtë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Kopje të deklaramit të xhiros mesatare vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) e cila duhet të ketë një vlerë mesatare, jo me te ulet se 40% të vlerës se fondit limit të kontratës që prokurohet, lëshuar nga administrata tatimore;

2. Kopje të vërtetuara të bilanceve të konfirmuara pranë autoriteteve përkatëse (administrata tatimore) të tre viteve të fundit (2019, 2020, 2021) (ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter duhet të plotësohet nga cdo anetar i bashkimit).

3. Dokument që vërteton se ka shlyer detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për vitin 2021 dhe 2022, prane të gjitha njesive vendore ku operatori ekonomik ka ushtruar apo ushtron aktivitetin sipas ekstraktit të QKR. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomike,ky vërtetim duhet të paraqitet nga secili prej pjesëtareve të bashkimit)

4. Vërtetim nga Bashkia Dimal-Autoriteti Kontraktor, se ofertuesi nuk ka detyrime ndaj Autoritetit Tonë, të lëshuar jo me vonë se 5 dite përpara dates se hapjes se ofertes. Do të konsiderohen detyrime të gjitha shumat që janë rrjedhojë e një detyrimi financiar të cfareldolloj natyre.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

3.Kapaciteti teknik:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme e realizuar në një kontrate të vetme në një vlerë jo më e vogël se 40 % e fondit limit, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së kontratës, ku zërat e punimeve respektive plotësojnë kriteret minimale të preventivit të objektit në prokurim.

Ose

b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e kontratave te punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë sa vlera e fondit limit.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e bene oferten te kualifikueshme.

3.1/aPër kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vleresimit;
2. Kontratën/Kontratat;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikaten/certifikatat e marrjes ne dorezim;
6. Faturat tatimore;

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

3.1/bPër kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontrate;
2. Lejen e ndertimit
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt kolaudimi objekti;
5. Çertifikatë përdorimi
6. Faturat tatimore

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

Pika **3.a** plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika **3.b** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

1.Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zoterojë Liçencën Profesionale të lëshuar nga institucionet e autorizuara me ligj në kategoritë si më poshtë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

NP-1-C Punime gërmimi në tokë

NP-4-C Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

NP-5-A Punime nentoksore Ura e VepraArti

NP-9-A Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.

NP-12-B Punime të inxhinierisë së mjedisit.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS-6-A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese

NS-7-A Barriera dhe mbrojtje rrugore

NS-9-B Punime strukturore special

NS-10-A Shtresa dhe mbistruktura speciale

NS-18-A Punime topogjeodezike

Per operatorët e huaj të bëhet njësimi i licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës nga institucioni i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dënimin e licencave profesionale në fushën e studimit dhe projektimit në ndërtim, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

2. Operatori Ekonomik ofertues duhet që të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) Inxhinier (Drejtnes Teknik në licencë) i cili të jetë i Çertifikuar për Sigurim dhe Shëndetin në Pune. Për këtë operatori ekonomik duhet të dorëzojë:

- ❖ Certifikatën për Inxhinierin
- ❖ Diplome
- ❖ Kontrata pune notoriale
- ❖ Librezen e punës
- ❖ CV përkatëse

- Në rast të bashkimit të Operatoreve Ekonomik (JV) çdo anëtar i bashkimit duhet të plotësojë kriterin e mësipërm.

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

5.1 Kandidati ofertues duhet të deklarojë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtnesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, gjithashtu të gjithë drejtnesit teknik të shoqërisë të jenë të deklaruar në listë pagesat e shoqërisë sipas formularit të deklarimit.

Kjo e provuar me dokumentacionin i mëposhtëm:

- CV përkatëse
- Kontrata punenotoriale
- Diplome
- Libreza pune

Në rast të bashkimit të Operatoreve Ekonomik (JV) çdo anëtar i bashkimit duhet të plotësojë kriterin e mësipërm.

3. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë një punësim mesatar jo më pak se 30 (tridhjetë) punonjësish, për periudhën **Janar 2022-Korrik 2022** të vërtetuar me;

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën **Janar 2022-Korrik 2022**.

b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi të konfirmuara nga administrata tatimore për periudhën **Janar 2022-Korrik 2022**, të shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Për këtë operatori duhet të paraqesë formularin E-SIG 025 për periudhën e kërkuar.

4. Operatori ekonomik duhet të ketë drejtnes teknikë në licencë dhe të figurojnë në listëpagesa të punësuar në shoqëri :

- Inxhinier Ndërtimi (2)
- Inxhinier Topograf, Gjeodet (2)
- Inxhinier Mjedisi (1)
- Inxhinier Mekanik (1)
- Inxhinier Hidroteknik (1)
- Inxhinier Gjeolog (1)

Sa me sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë, kontratë pune, diplomë, CV dhe të jenë në listepagesë. ***Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish të përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.***

5. Gjithashtu operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e shoqërisë të punësuar dhe në Listepagesa:

- Mjek 1 (një) të pajisur me licencë, kjo të shoqërohet me Kontratë pune Noteriale dhe Leje Individuale për Ushtrimin e Profesionit të Mjekut, CV dhe të jenë në listepagesë.
- Punonjës të Ndhimes së Shpejte 3 (tre) për të cilët duhet të paraqesë certifikatën e trajnimit të vlefshme, dhe të jenë në listepagesë, ku 1 (një) nga punonjësit duhet të jetë Ekspert për ndihmën e parë dhe nderhyrjen ndaj emergjencave.
- Minimalisht 3 (tre) Specialist Ndertimi shoqëruar me certifikatë trajnimi dhe kontratë pune dhe të jenë në listepagesë.
- Minimalisht 1 (një) Teknik Topograf shoqëruar me certifikatë trajnimi dhe kontratë pune dhe të jenë në listepagesë.
- Minimalisht 1 (një) Teknik ndertimi shoqëruar me diplomë ose License të jetë me kontratë pune dhe në listepagesë.
- Manovratore 5 (pesë), të pajisur me Deshmi e aftësi profesionale për përdoruesit e makinerive të renda të ndertimit dhe punimeve në tokë të shoqëruar me kontratat e punës dhe të jenë në listepagesë.
- Shofer me CAP 3 (Tre), kontratë pune dhe të jenë në listepagesë.
- Minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të pajisur me deshmi nga IQT ose Ekuivalente me të, të cilët të figurojnë në listepagesë. Nga të cilët të jenë të pajisur me deshmi nga IQT, të kenë kontratë pune dhe të figurojnë në listepagesë :
1 (një) Inxhinier Ndertimi, 1 (një) Inxhinierë Mekanik, 2 (dy) Teknikë Ndërtimi, 2 (dy) Hidraulikë, 1 (një) Saldator, 2 (dy) Mekanik, 1 (një) Elektracist, 2 (dy) Karpentier, 1 (një) Murator, 1 (një) Hekurkthyes.

9. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të deshmojnë se disponojnë mjetet për realizimin me sukses të objektit të prokurimit, për këtë duhet të paraqesin:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamiona vetshkarkues mbi 16 ton	4 cope	Pronësi ose me qera
Kamiona vetshkarkues 7.5-16 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçina	3 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	3 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Betoniere Kantieri	5 cope	Pronësi ose me qera
Fadrome (Skrep) me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Motosaldatrice	2 cope	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 cope	Pronësi ose me qera
Autopomp për hedhjebetoni	1 cope	Pronësi ose me qera
Gjeneratorë	2 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavator	4 cope	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrulangjeshës	3 cope	Pronësi ose me qera
Rrulasfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Grejder	1 cope	Pronësi ose me qera

Aparat Topogjeodezik GPS	1 cope	Pronësi ose me qera
Tabela (kantieri)	15 cope	Pronësi ose me qera
Kaska-kokore	30 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	2 cope	Pronësi ose me qera
Tokmak elektrik	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 cope	Pronësi ose me qera
Fikse Zjarri	5 cope	Pronësi ose me qera
Kuti ndihme e shpejte	5 cope	Pronësi ose me qera
Karro dore	15 cope	Pronësi ose me qera
Depozita uji	6 cope	Pronësi ose me qera
Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobitumatrice	1 cope	Pronësi ose me qera
Bot Uji	1 cope	Pronësi ose me qira

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe certifikaten e transportit të leshuar nga bashkia perkatese. Per mjetet e siguruara me qera, te vertetohet me kontraten e qerese te noterizuar, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.

b) Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes, të përkthyer dhe noterizuara në gjuhën shqipe.

c) Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mjetet e paraqitura në oferte nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe do të jenë në dispozicion të zbatimit të punimeve në objektin që tenderohet, Gjithashtu duhet të deklarojë vendodhjen e tyre me qëllim verifikimi.

d) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të vetdeklaruar.

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës referuar sasisë së volumeve të punës dhe grafikut të punimeve.

10. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë:

Impiant prodhim Betoni me QKL	1 cope	Pronësi ose me qira
Impiant prodhim Inertesh per betonin me QKL	1 cope	Pronësi ose me qira
Linje per thyerje Guri me QKL	1 cope	Pronësi ose me qira
Impiant per prodhimin e asfaltit	1 cope	Pronësi ose me qira

Per sa mesiper duhet te paraqesin dokumentacionin e pronësisë apo marrjes me qera, te shoqeruar me leje mjedisore te leshuar nga QKL si me poshte:

-QKL-Leje Mjedisi te tipit B, Kodi: III.1.B “Per impiant betoni, prodhimin e produkteve te betonit, shoqeruar me planvendosjen per Impiantin, monitorimin mjedisor.

-QKL-Leje Mjedisi Kodi: III.1.B. “Per Impiant Inertesh”

-QKL-Leje Mjedisi Kodi: III.1.B. “Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret” per linjen e thyerjes se gurit.

Sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjes. Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktës, Republika e Shqipërisë, sic percaktohet në Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008

-Per linjat e mesiperme, Operatori Ekonomik ofertues duhet qe te kete ne stafin e tij mbeshtetes minimalisht 1 (një) Inxhinier Mekanik i specializuar per Impiantet. Per kete operatori ekonomik duhet te dorezoje Kontrate noteriale pune, Liçencen per Inxhinierin si dhe te jete ne listepagese.

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës.

11. Operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje dhe te paraqese kete certifikatat e vlefshme si më poshtë:

a)Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mesiperme.

b)Çertifikatën mbi sitemet e menaxhimit të ambientit **ISO 14001-2015** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mesiperme.

c)Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë **SSH 45001-2018**, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mesiperme.

d)Çertifikatën mbi sistemet e menaxhimit të integruar **Pas 99:2012** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mesiperme.

e) Çertifikatën mbi sitemet e menaxhimit të pergjegjshmerise sociale **SA 8000-2014** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne rast te bashkimit te Operatoreve Ekonomik (JV) ky kriter mund te plotesohet nga i gjithe bashkimi i operatoreve.

f) Çertifikatën mbi sitemet e menaxhimit të energjise per kompanine **ISO 50001-2018** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne rast te bashkimit te Operatoreve Ekonomik (JV) ky kriter mund te plotesohet nga i gjithe bashkimi i operatoreve.

g) Çertifikatën mbi sistemin e menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor **ISO 39001:2012** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mesiperme.

Certifikatat e mesiperme duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akredimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.

Këto certifikata nuk janë argumentuar ligjërisht se përse u janë kërkuar OE pjesëmarrës.

1-Në datë 06/09/2022, ne platformën e Prokurimit Elektronik është paraqitur një kërkesë për sqarim nga nje person i interesuar :

1-Ne DST ne piken 4 eshte kerkuar si me poshte: Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zoterojë Liçencën Profesionale të lëshuar nga institucionet e autorizuara me ligj në kategoritë si më poshtë: PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI NP-

1-C Punime gjurmimi në tokë NP-4-C Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. NP-5-A Punime nentoksore Ura e VepraArti NP-9-A Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime. NP-12-B Punime të inxhinierisë së mjedisit. PUNIME SPECIALE NDËRTIMI NS-6-A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese NS-7-A Barriera dhe mbrojtje rrugore NS-9-B Punime strukturore special NS-10-A Shtresa dhe mbistruktura speciale NS-18-A Punime topogjeodezike

Per operatorët e huaj të behet njehsimi i licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës nga institucioni i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dënimin e licencave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës. Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, kategoria e secilës pike të licencës përcaktohet në bazë të zerave dhe vlerës së punimeve që do të kryhen sipas preventivit të punimeve.

- Secila nga Kategoritë e Kërkuara me sipër (me ngjyrë të kuqe) është B (sipas VKM-së nëse jemi në kategorinë B atëherë për secilën kategori vlera e punimeve duhet të jetë 21-50 milion leke) Kërkojmë një sqarim nga ana e AK sesi është bërë përcaktimi i kategorive për punimet sipas zerave të preventivit, sepse nisur nga zërat e preventivit nuk ka asnjë zë specifikisht për Punime Inxhinierie Mjedisit, por mund të konsiderohet si pjesë përberëse e punimeve të grupit të kategorive të përgjithshme të ndërtimit. Duke nisur nga kjo, vlera e punimeve të mjedisit nuk mund të shkojë më shumë se 20 milion leke dhe rrjedhimisht kategoria e tyre duhet të jetë A dhe jo B. Gjithashtu për Punimet në Kategorinë NS-9, vlera e tyre me një studim të sasive dhe me një cmim nisur nga Manuali i Cmimeve nr.3 2015, miratura me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), nuk zë më shumë se 10% të fondit limit të prokuruar, pra 6,039,194 Leke, rrjedhimisht punimet e kësaj kategorie duhet të jenë në kategorinë A dhe jo B Në pikën 7-8 është kërkuar si më poshtë: Operatori ekonomik duhet të ketë drejtues teknikë në licence dhe të figurojnë në listepagesa të punësuar në shoqëri :
- InxhinierNdërtimi (2)
- Inxhinier Topograf, Gjeodet (2)
- Inxhinier Mjedisit (1)
- Inxhinier Mekanik (1)
- Inxhinier Hidroteknik (1)
- Inxhinier Gjeolog (1)

Sa me sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë, kontratë punë, diplomë, CV dhe të jenë në listepagese. 8.Gjithashtu operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e shoqërisë të punësuar dhe në Listepagesa:

- Minimalisht 3 (tre) Specialist Ndërtimi shoqëruar me certifikatë trajnimi dhe kontratë punë dhe të jenë në listepagese.
- Minimalisht 1 (një) Teknik Topograf shoqëruar me certifikatë trajnimi dhe kontratë punë dhe të jenë në listepagese.
- Minimalisht 1(një)Teknik ndërtimi shoqëruar me diplomë ose License të jenë me kontratë punë dhe në listepagese
- Minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të pajisur me dëshmi nga IQT ose Ekuivalente me të, të cilët të figurojnë në listepagesa. Nga të cilët të jenë të pajisur me dëshmi nga IQT, të kenë kontratë punë dhe të figurojnë në listepagese :

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, 1 (një) Inxhinierë Mekanik, 2 (dy) Teknikë Ndërtimi, 2 (dy) Hidraulikë, 1 (një) Saldator, 2 (dy) Mekanik, 1 (një) Elektracist, 2 (dy) Karpentier, 1 (një) Murator, 1 (një) Hekurkthyes.

Për sa më sipër, duke u mbështetur gjithmonë në natyrën e objektit dhe zërat e punimeve nuk është e nevojshme që të ketë më shumë se një të punësuar për secilin nga Inxhinierat e mësipërm, përse kohe është kërkuar që duhet të figurojnë në licencën e saj. Numri i Inxhinierëve të kërkuar është i teperuar për natyrën dhe vlerën e punimeve për këtë objekt prokurimi. Ju lutem një sqarim për operatorin ekonomik duhet të ketë patjetër 2 drejtues Teknik në licence si Inxhinier ndërtimi dhe Inxhinier Gjeodet??? Operatori ekonomik jo patjetër të gjithë inxhinierët i ka drejtues teknik në licence e

shoqerise, mund te jete dhe staf mbeshtes dhe kapaciteti Teknik i tij eshte i permbushur. Sipas nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur...” sic duket dhe autoriteti ka percaktuar kriteret. Sipas Listes me siper rezulton se kerkohen • Minimalisht 3 (tre) Specialist Ndertimi shoqeruar me certifikate trajnimi dhe kontrate pune dhe te jete ne listepagese. • Minimalisht 1 (nje) Teknik Topograf shoqeruar me certifikate trajnimi dhe kontrate pune dhe te jete ne listepagese. • Minimalisht 1(nje)Teknik ndertimi shoqeruar me diplome ose License te jete me kontrat pune dhe ne listpagese • 2 (dy) Teknikë Ndërtimi shoqeruar me deshmi nga IQT Kerkojme nje sqarim nga ana juaj cfare vepre arti dhe cfare volumesh jane ne preventivin e punimeve qe AK-ja kerkon ne total 3 Teknik Ndertimi, 1 Teknik Topograf dhe 3 Specialist Ndertimi. Me cfare argumentimi jane vendosur keto kriteret, pervec argumentimit bazik qe eshte afati i shkurter i zbatimit te kontrates. Percaktimi kaq qarte i stafit mbeshtetes nuk tregon gje tjeter vec diskriminimin e disa operatoreve ekonomik, dhe favorizimin e disa te tjereve Ne piken 10 eshte kerkuar si me poshte: Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te disponojne: Impiant prodhim Betoni me QKL 1 cope Pronësi ose me qira Impiant prodhim Inertesh per betonin me QKL 1 cope Pronësi ose me qira Linje per thyerje Guri me QKL 1 cope Pronësi ose me qira Impiant per prodhimin e asfaltit 1 cope Pronesi ose me qira Per sa mesiper duhet te paraqesin dokumentacionin e pronesise apo marrjes me qera, te shoqeruar me leje mjedisore te leshuar nga QKL si meposhte :-QKL-Leje Mjedisi te tipit B, Kodi: III.1.B “Per impiant betoni, prodhimin e produkteve te betonit, shoqeruar me planvendosjen per Impiantin, monitorimin mjedisor.-QKL-Leje Mjedisi Kodi: III.1.B. “Per Impiant Inertesh”-QKL-Leje Mjedisi Kodi: III.1.B. “Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret” per linjen e thyerjes se gurit. Sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjes. Shoqëritë e huaja duhet te kene kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktures, Republika e Shqipërisë, sic percaktohet ne Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008-Per linjat e mesiperme, Operatori Ekonomik ofertues duhet qe te kete ne stafin e tij mbeshtetes minimalisht 1 (një) Inxhinier Mekanik i specializuar per Impiantet. Per kete operatori ekonomik duhet te dorezoje Kontrate noteriale pune, Liçencen per Inxhinierin si dhe te jete ne listepagese. Sipas tabelës me siper eshte kerkuar qe operatori ekonomik pjesemarrës i permbush kriteret nese impiantet i ka ne pronesi ose me qera. Ju lutemi nje sqarim sesi dote veprohet ne lidhje me kerkesen tuaj kur OE i disponon Impiantet me Qera. Perseri OE duhet te kete te punesuar 1 (një) Inxhinier Mekanik i specializuar per Impiantet. Kerkojme te merren masa nga ana juaj per rregullimin e kriterëve te vendosura, dhe te shmangni abuzimet dhe diskriminimin qe po ju beni te gjithë OE qe duan te jene pjesemarrës ne kete procedure, dhe jo te favorizoni OE specifik!

2-Njësia e Koordinimit të APP ka paraqitur info për procedurën dhe rekomandimet përkatëse datë 06/09/2022, sa më poshtë vijon:

Nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve/enteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), sa i takon autoritetit kontraktor Bashkia Dimal (në vijim AK) rezulton se, ndërmjet të tjerash është

shpallur edhe procedura me REF-40445-09-01-2022, me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Sheq-Gajdë”, me fond limit 60,391,938 lekë pa TVSH.

A. Duke marrë shkas nga problematikat e konstatuara në këtë procedurë prokurimi, APP vlerëson se, kriteret në vijim nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik, pikës 1, të nenit 77, të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, dhe nenit 39, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, që cdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, duke cënuar kështu edhe përcaktimet e nenit 3 të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Konkretisht:

1. Në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zoterojë Liçencën Profesionale të lëshuar nga institucionet e autorizuara me ligj në kategoritë si më poshtë:

PUNIME TË PËRGGJITHSHME NDËRTIMI

NP-1-C Punime gjurmimi në tokë

NP-4-C Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

NP-5-A PunimentoksoreUra e VepraArti

NP-9-A Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.

NP-12-B Punime të inxhinierisë së mjedisit.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS-6-A Sinjalistikarrugore jo ndriçuese

NS-7-A Barrieradhembrojtjerrugore

NS-9-B Punime strukturore speciale

NS-10-A Shtresa dhe mbistruktura speciale

NS-18-A Punime topogjeodezike

Per operatorët e huaj te behet njehsimi i licenses profesionale qe disponojne nga vendi i origjines nga institucioni i autorizuar sipas legjislacionit ne fuqi per dhenien e licencave profesionale ne fushen e studimit e projektimit ne ndertim, ne plotesim te licensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontrates.”

N.P. 5 Punime nëntokësore-“Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntoke që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi “goma” ose mbi “hekur”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele”.

N.P. 9 Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime-“Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrore ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafragmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve”.

N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore “Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimi të kompaktësimi të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimi natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte”.

N.S-7 Barriera dhe mbrojtje rrugore-“Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja ristrukturimi i elementeve si guard rail, në jersey, zvogëluetit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa”.

N.S-9 Punime strukturore speciale-“Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t’u ndërtuar në terrene rezistonte dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përfshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratorit nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve.

Impermeabilizzazione dhe konsolidimin e terreneve”.

N.S-10 Shtresa dhe mbistruktura special-“Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i shtresave (dyschemeve) të realizuara me materiale të veçanta, natyrale ose artificiale, të cilat janë me ngarkesa të konsiderueshme, si mund të jenë pistat aeroportuale”.

Për rrjedhim të sa më sipër, AK duhet të rivlerësojë nevojën për vendosjen e kërkesës për disponimin e kategorive të mësipërme, duke j’u përmbajtur përcaktimeve të pikës 1, nenit 77, të LPP dhe nenit 41, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Gjithashtu, duke konsideruar faktin që kriteri mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës, AK duhet t’i përmbahet edhe përcaktimeve të nenit 3, të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Së dyti, në lidhje me nivelin e klasifikimit të përcaktuar për kategoritë e kërkuara në licencave profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve të ndërtimit, konkretisht licencës N.P 1 C dhe N.P 4 C, sugjerojmë rivlerësimin e tyre, dhe në çdo rast mirëargumentim nga ana teknike, duke u bazuar në vlerat e punimeve që parashikohen të kryhen për çdo kategori respektive, si dhe duke u bazuar në parashikimet e rregullores së miratuar me VKM nr.42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, ku përcaktohet se niveli i klasifikimit A i korespondon vlerës së punimeve 0 deri 20 milion lekë, B-21 deri 50 milion lekë, C-51 deri 100 milion lekë dhe D-101 deri 200 milion lekë.

2. Në pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Operatori ekonomik duhet te kete drejtues teknikë ne licence dhe te figurojne ne listepagesa te punesuar ne shoqeri:

- Inxhinier Ndërtimi (2)

- Inxhinier Topograf, Gjeodet (2)
- Inxhinier Mjedisi (1)
- Inxhinier Mekanik (1)
- Inxhinier Hidroteknik (1)
- Inxhinier Gjeolog (1)

Sa me sipër operatori ekonomik duhet të paraqese, kontrate pune, diplomë, CV dhe të jene ne listepagese”.

Së pari, në lidhje me kërkesën për drejtues teknik në licencën e shoqërisë Inxhinier Mjedisi, Inxhinier Mekanik, Inxhinier Hidroteknik, dhe Inxhinier Gjeolog, duke marrë shkas nga tipologjia objektit të kontratës, vlerësojmë se AK nuk ka parashikuar asnjë veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierëve të sipërcituar. Sjellim në vëmendje të AK, në hartimin e kriterit për inxhinierin, duhet t’i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe të nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që cdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Për rrjedhoje, sugjerojmë AK të rivlerësojë nevojën në lidhje me vendosjen e kërkesës për Inxhinier Mjedisi Inxhinier Mekanik, Inxhinier Hidroteknik, dhe Inxhinier Gjeolog.

I njëjti konstatim të mbahet në konsideratë edhe në pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik, në lidhje me kërkesën për 1 (një) Teknik Ndërtimi, 2 (dy) Mekanik, 1(një) Elektracist, si dhe në pikën 2.3.10 të kapacitetit teknik në lidhje me kërkesën për 1 (një) Inxhinier Mekanik.

Së dyti, sugjerojmë AK të rivlerësojë ose në të kundërt të mirë argumentojë kërkesën për numrin 2 (dy) të kërkuar për inxhinierë ndërtimi dhe inxhinierë topograf, gjeodet.

I njëjti konstatim të mbahet në konsideratë edhe në pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik, në lidhje me punonjësit e ndihmës së shpejtë 3 (tre).

Së treti, ë lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (disponimin e punonjesve), sugjerojmë që AK ti përmbahet rigorozikisht përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen. Ky përcaktim të mbahet në konsideratë edhe për pikat 2.3.6, dhe 2.3.7 të kapacitetit teknik.

B. Njëkohësisht, APP rekomandon që AK, duke ju përmbajtur rigorozisht përcaktimeve të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik dhe për fusha të tjera ku procedura shtrin ndikimin, apo kuptimit të tyre, duhet të saktësojë/riformulojë kriteret në vijim, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen në plotësimin e kriterit nga OE ofertues apo që mbarten edhe në procesin e vlerësimit të përmbushjes së kriterit nga KVO.

Konkretisht:

1. Në pikën 2.2.3 të kapacitetit ekonomik dhe finciar, AK ka kërkuar: “Dokument që vërteton se ka shlyer detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për vitin 2021 dhe 2022, prane të gjitha njesive vendore ku operatori ekonomik ka ushtruar apo ushtron aktivitetin sipas ekstraktit të QKR. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomike,ky vertetim duhet të paraqitet nga secili prej pjesëtareve të bashkimit)”.

Duke marrë shkas nga fakti që njësitë e vetëqeverisjes vendore përcaktojnë rregulla të pavarura për kohën e shlyerjes së taksave dhe tarifave vendore, me qëllim shmangien e konfuzionit në plotësimin e këtij kriteri nga OE, për detyrimet e vitit 2022, sugjerojmë AK kërkesën e mësipërme ta shoqërojë dhe me referimin konkret në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (AK gjatë vlerësimit të ofertave lidhur me plotësimin e këtij kriteri duhet të mbajë në konsideratë përcaktimet e këtij ligji lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2022).

Gjithashtu, sugjerojmë AK të riformulojë ose në të kundërt të mirëargumentojë kërkesën e përcaktuar në pikën 2.2.4 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, në lidhje me dokumentin e kërkuar për OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, pasi për kërkesën në fjalë, AK mund të kryej vetë verifikimet përkatëse nëse operatorët ekonomikë kanë detyrime financiare apo jo ndaj AK (Bashkia Dimal).

2. Në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë një punësim mesatar jo më pak se 30 (tridhjetë) punonjësish, për periudhën Janar 2022-Korrik 2022 të vërtetuar me;

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Janar 2022-Korrik 2022.

b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi të konfirmuara nga administrata tatimore për periudhën Janar 2022-Korrik 2022, të shoqëruar me formularët e deklaratimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Për këtë operatori duhet të paraqesë formularin E-SIG 025 për periudhën e kërkuar”.

Në lidhje me kërkesën për disponimin e punonjësve të kërkuar, në listëpagesa për periudhën Janar-Korrik 2022, në kuptim të:

-Pikës 2, të nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: “...Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.”

-Pikës 4/c, të nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: “fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”, sqarojmë se, kriteri për fuqinë punëtore i shërben autoritetit kontraktor për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Ky kriter nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Për këtë qëllim, APP rekomandon që kërkesa e AK për fuqinë punëtore të bëhet në funksion të qëllimit për të cilin kërkohej (për realizimin e objektit konkret të prokurimit) e për rrjedhim të rivlerësohet nga AK shtrirja e kriterit për periudhën Janar 2022-Korrik 2022, vendosja e të cilës mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës që prokurohet dhe njëkohësisht vlerësohet se përmbushin kërkesat në lidhje me besueshmërinë, përvojën dhe reputacionin nëpërmjet përmbushjes së kriterëve të tjera të vendosura nga AK.

3. Në lidhje me pikën 2.3.9, të kapacitetit teknik për disponimin e mjeteve, mbështetur në tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet, punimet konkrete që do të realizohen dhe volumet e tyre, rekomandojmë që AK të mirëargumentojë ose të rivlersojë mjetet e kërkuara, konkretisht, konkretisht numrin e lartë të mjeteve të transportit dhe mjeteve të gërmimit, si dhe në rast se i qëndron kriterit, të mirëargumentojë teknikisht nevojën.

4. Në pikën 2.3.10, të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te disponojnë:

Impiant prodhim Betoni me QKL 1 cope Pronësi ose me qira

Impiant prodhim Inertesh per betonin

me QKL 1 cope Pronësi ose me qira

Linje per thyerje Guri me QKL 1 cope Pronësi ose me qira

Impiant per prodhimin e asfaltit 1 cope Pronësi ose me qira

Per sa mesiper duhet te paraqesin dokumentacionin e pronësisë apo marrjes me qera, te shoqeruar me leje mjedisore te leshuar nga QKL si meposhte :

-QKL-Leje Mjedisi te tipit B, Kodi: III.1.B “Per impiant betoni, prodhimin e produkteve te betonit, shoqeruar me planvendosjen per Impiantin, monitorimin mjedisor.

-QKL-Leje Mjedisi Kodi: III.1.B. “Per Impiant Inertesh”

-QKL-Leje Mjedisi Kodi: III.1.B. “Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret” per linjen e thyerjes se gurit” Nisur nga kërkesat e mësipërme për Impiant prodhim Betoni me QKL, Impiant prodhim Inertesh per betonin me QKL, Linje per thyerje Guri me QKL, Impiant per prodhimin e asfaltit, sugjerojmë që AK të pranojë si mundësi që të impiantet e mësipërme disponohetn edhe me kontratë furnizimi.

Së dyti, në rastet kur, fabrika e asfaltit, inerteve dhe prodhimin të asfaltit, linja per thyerjen e gurit, nuk janë në pronësi apo me qira nga OE, por me kontratë furnizimi, rezulton se, kërkesa për paraqitjen e “leje mjedisore, leje shfrytëzimi, QKL...etj”, u drejtohet personave të tretë, që nuk janë konkurrent në këtë procedurë prokurimi. Për rrjedhojë, sugjerojmë rivlerësimin/argumentimin e kësaj kërkesë.

5. Në pikën 2.3.11 gërma e, të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje dhe te paraqese kete certifikatat e vlefshme si më poshtë;

e) Çertifikatën mbi sitemet e menaxhimit të pergjegjshmerise sociale SA 8000-2014 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne rast te bashkimit te Operatoreve Ekonomik (JV) ky kriter mund te plotesohet nga i gjithe bashkimi i operatoreve”.

Vlerësojmë se, Çertifikata SA 8000-2014 mbi “Sitemet e Menaxhimit të Pergjegjshmerise Sociale”, nuk është e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit, ndaj i rekomandojmë AK të rivlerësojë/mirëargumentojë nevojën për vendosjen e këtyre kërkesave, me qëllim përmbushjen e përcaktimeve të nenit 44 pika 3, te VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.

Përpos sa më lart, AK duhet të mbajë në konsideratë që, në zbatim të përcaktimeve të nenit 78, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, cdo kriter i vecantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht. Gjithashtu, sjellim në vëmendjen tuaj se përlllogaritja e vlerës së fondit limit duhet të argumentohet dhe dokumentohet (nese nuk është argumentuar) sipas përcaktimeve të nenit 76, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Si përfundim, sqarojmë se, në rastin, kur nga AK konsiderohet i nevojshëm ndryshimi i dokumenteve të tenderit, përfshirë këtu edhe kriteret për kualifikim, mbështetur në përcaktimet e nenit 75, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor nuk duhet të

anullojë procedurën, por mund të bëjë ndryshime përmes hartimit të një shtojce, e cila ju vihet në dispozicion operatorëve ekonomikë, në Dokumentet Standarde të Tenderit të publikuara.

Sipas rekomandimeve të Njësisë së Koordinimit të App-së, datë 06/09/2022, dhe kërkesës së sqarim të operatorit ekonomik, në App, u krye modifikimi i dokumentave të tenderit sipas prot 2406/6 datë 12/09/2022.

Shtojca për ndryshim të dokumentave të tenderit nr 1406/6 datë 12/09/2022.

ISHTE4Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zoterojë Liçencën Profesionale të lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj në kategoritë si më poshtë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

NP-1-C Punime gjurmimi në tokë

NP-4-C Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

NP-5-A Punime nentoksore Ura e Vepra Arti

NP-9-A Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.

NP-12-B Punime të inxhinierisë së mjedisit.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS-6-A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese

NS-7-A Barriera dhe mbrojtje rrugore

NS-9-B Punime strukturore special

NS-10-A Shtresa dhe mbistruktura speciale

NS-18-A Punime topogjeodezike

Per operatorët e huaj të behet njehsimi i licenses profesionale qe disponojne nga vendi i origjines nga institucioni i autorizuar sipas legjislacionit ne fuqi per dhenien e licencave profesionale ne fushen e studimit e projektimit ne ndertim, ne plotesim te licensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontrates.

BEHET: 4. Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zoterojë Liçencën Profesionale të lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj në kategoritë si më poshtë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

NP-1-C Punime gjurmimi në tokë

NP-4-C Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

NP-9-A Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.

NP-12-B Punime të inxhinierisë së mjedisit.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS-6-A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese

NS-7-A Barriera dhe mbrojtje rrugore

NS-9-A Punime strukturore special

NS-10-A Shtresa dhe mbistruktura speciale

NS-18-A Punime topogjeodezike

Per operatorët e huaj të behet njehsimi i licenses profesionale qe disponojne nga vendi i origjines nga institucioni i autorizuar sipas legjislacionit ne fuqi per dhenien e licencave profesionale ne fushen e studimit e projektimit ne ndertim, ne plotesim te licensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontrates.

ISHTE:7. Operatori ekonomik duhet te kete drejtues teknikë ne licence dhe te figurojne ne listepagesa te punesuar ne shoqeri :

- Inxhinier Ndërtimi (2)
- Inxhinier Topograf, Gjeodet (2)
- Inxhinier Mjedisi (1)
- Inxhinier Mekanik (1)
- Inxhinier Hidroteknik (1)
- Inxhinier Gjeolog (1)

Sa me siper operatori ekonomik duhet te paraqese, kontrate pune, diplomë, CV dhe te jene ne listepagese.

BEHET:7. Operatori ekonomik duhet te kete drejtues teknikë ne licence dhe te figurojne ne listepagesa te punesuar ne shoqeri :

- Inxhinier Ndërtimi (2)
- Inxhinier Topograf, Gjeodet (2)
- Inxhinier Mjedisi (1)
- Inxhinier Hidroteknik (1)
- Inxhinier Gjeolog (1)

Sa me siper operatori ekonomik duhet te paraqese, kontrate pune, diplomë, CV dhe te jene ne listepagese.

Veprimet e mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK zj.J.M, zj. L.B si dhe hartuesit e kriterëve të kualifikimit zj. M.B, zj. B. B dhe z. A.P për hartimin e specifikimeve teknike së bashku me z. M. D e z.I. S.

Kriteri:Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, në të cilin citohet se;

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

nenin 3, parimet e përgjithshme në të cialt citohet se;

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.***
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.***
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.***

Kreu V, neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, pikat 1 dhe 5 ku përcaktohet se;

Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve

të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu X, neni 40, pika 3 e cila citon se;

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

neni 78, pika 2, paragrafi dytë i cili citon se;

... Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, diskriminim dhe trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Dimal, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar proces-verbalit nr.2406/10, të datës 18/10/2022, KVO-ja ka kryer në vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i operatorëve ekonomikë K. ShPK, nipt J.....H, dhe F. ShPK, nipt K.....C, është i saktë, referuar kriterëve të procedurës dhe vlera e ofertës së ofruar është **57,305,850 lekë.**

2. Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i operatorëve ekonomikë L. ShPK, nipt K.....K, V. K SHPK, nipt K.....L, E.-A ShPK, nipt K.....H, referuar vetëdeklarimeve në sistem, është i saktë, por oferta e paraqitur është anomalisht e ulët, dhe vlera e ofertës së ofruar është **37,414,293 lekë.**

Me shkresën nr 2406/11 datë 18/10/2022, këtij bashkimi operatorësh ekonomikë, ju dërgua kërkesë për paraqitjen e shpjegimeve për ofertën anomalidsht të ulët, e cila u protokollua në Institucion me nr prot 3000 dtaë 21/10/2022.

Sipas urdhërit nr 2406/13 datë 24/10/2022, u ngrit grupi i punës me specialistë të fushës për shqyrtimin e shpjegimeve për ofertën anomalisht të ulët, i përberë nga;

1.J.. A.-Inxhinierë

2-M. D.-Inxhinierë

3-G.H.-Juriste.

Grupi i punës përgatiti informacionin me nr prot 2406/15 datë 07/11/2022, komisionit të vlerësimit të ofertave, ku pas shqyrtimit të fakteve, konkludoi se ulja drastike e cmimeve të

blerjes së materilaeve ndikon në cilësinë e tyre, dhe për pasojë në cilësinë dhe standartin e ndërtimit, ndaj si të tilla nuk do të merren në konsideratë.

Sipas proces-verbalit përfundimtar të kvo, nr 2406/18 datë 09/11/2022, u konkludua skualifikimi i Bashkimit të operatorëve ekonomikë L. ShPK, nipt K.....K, V.. K. SHPK, nipt K.....L, E.-A ShPK, dhe kualifikimi i Bashkimi i operatorëve ekonomikë K.. ShPK, nipt J.....H, dhe Fled ShPK, nipt K.....C, konkretisht si më poshtë.

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	Bashkimi i operatorëve ekonomikë Llazo ShPK, V. K. SHPK,, E.-A. ShPK	37,414,293	Skualifikuar-Sepse shpjegimet e ofertës anomalisht të ulët nuk ishin bindëse për Autoritetin Kontraktor, dhe nuk siguronin cilësi në kryejën e punimeve të procedurës
2	Bashkimi i operatorëve ekonomikë K.ShPK,, dhe F.ShPK,	57,305,850	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 01/12/2022 në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 1OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 01/12/2022, ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë **K. ShPK, nipt J.....H, dhe F. ShPK, nipt K.....C** për të cilën është lidhur kontrata datë 05/01/2023 për vlerën **57,305,850 lekë pa TVSH** dhe vlera **68,767,020 lekë me TVSH**, dhe me afat 28 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Titulli i gjetjes: Vlerësim jo objektiv dhe në përputhje me parimet e PP nga KVO.

Situata: Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës Sheq-Gajdë”, me fond limit në shumën 60,391,938 lekë, në fazën e vlerësimit të ofertave u konstatua se: Në këtë procedurë kanë marrë pjesë dy BOE, e konkretisht BOE “L. ShPK & V. K. ShPK & E.-A. ShPK” me vlerë oferte në shumën 37,414,293 lekë dhe BOE K. ShPK & F. ShPK”, me vlerë oferte në shumën 57,305,850 lekë. Nga procesi i vlerësimit të KVO rezulton se të dy BOE pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e AK por një prej tyre ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët. Për këtë arsye KVO ka kërkuar sqarime të cilat janë sjellë nga BOE “L.ShPK & V. K. ShPK & E.-A. ShPK” me shkresën nr. 686prot, datë 20.10.2022 administruar nga Bashkia Dimal me shkresën nr. 3000prot, datë 21.10.2022. OE “L. ShPK” ka sqaruar ofertën e paraqitur me argumentimin se, disa nga zërat e ofertës shpjegohen teknikisht sipas analizës së paraqitur dhe ofertave të çmimeve të marra prej tij, gjë që justifikon dhe ofertën e paraqitur në atë vlerën 37,414,293 lekë. Me shkresën nr. 2406/13prot, datë 24.10.2022, titullari i autorizuar i AK zj. L.B ka ngritur komisionin e përbërë prej J.A, M.D dhe G. H, për shqyrtimin e argumentimit të paraqitur nga OE. Nga verifikimi i dokumentacionit të kryer prej komisionit, të cilët kanë mbajtur procesverbalin me nr. 2406/4prot, datë 07.11.2022 dhe me shkresën nr. 2406/5prot, datë 07.11.2022, i kanë bërë me dije titullarit të AK dhe KVO se dokumentacioni i paraqitur nga BOE “L. ShPK” nuk është bindës. Komisioni i vlerësimit të ofertave duke patur në përbërje të vet specialist të fushës duhet të vlerësonte dhe sqarimet e paraqitura nga BOE me ofertë anomalisht të ulët, duke gjykuar në përputhje me parimet e LPP. Grupi i auditimi pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi dhe komisioni i ngritur, arrin në përfundimin se s'kualifikimi i “L. ShPK & V. K. ShPK & E.-A. ShPK”, është i padrejtë dhe se dokumentacioni i paraqitur justifikon vlerën e ofertës së dhënë për shkak se një pjesë e zërave të preventivit gjenden pranë zonës së Bashkia Dimal me çmime/kosto më të ulët dhe të favorshme nga manuali i çmimeve të punimeve të ndërtimit. Komisioni në argumentimin e tyre se nuk është bindës dokumentacioni i paraqitur, nuk kanë dhënë arsye për mosbindjen se cila ka qënë arsyeja e

refuzimit të dokumentacionit të parqitur pasi elementet e paraqitur nga ofertuesi janë zëra analize dhe paraqesin arsyet e anës teknike të kostos së tyre më të ulët, zgjidhjet teknike të punës me kosto më të ulët, origjinalitetin e materialeve më çmim më të ulët dhe pajtueshmërinë me detyrimet ligjore të kostove të punës. Gjithashtu BOE ka paraqitur dëshmi se plotëson kërkesat e cilësisë së AK dhe dokumentacionin e kërkuar për të cilat ka deklaruar se merr përsipër kryerjen e punimeve sipas të gjitha kushteve të kërkuara nga Bashkia Dimal sikurse ka paraqitur dhe dokumentacionin shtesë për të justifikuar dhe dhënien e ofertës, pavarësisht se ka qënë anomalisht e ulët. Nëse do të kualifikohej BOE “L. ShPK & V. K. ShPK & E.-A. ShPK”, Bashkia Dimal do të kryente këtë procedurë me një vlerë 19,891,557 lekë më pak. Pra **shuma prej 19,891,557 lekë pa TVSh përbën efekt financiar negativ** për buxhetin e Bashkia Dimal. *Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK zj.J.M, zj. L.B, anëtarët e KVO zj. R.S, zj. I.D, zj. I.S dhe anëtarët e komisionit të shqyrtimit të shpjegimeve zj. Juliana Avdurramani, zj. M. D. dhe zj. G.H.*

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 2,

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;***
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

nenin 93, pika 2, e cila citon se:

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;*
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;*
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ financiar për buxhetin e Bashkia Dimal.

Shkaku: Mos respektim i parimeve të kuadrit ligjor për prokurimin publik.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Dimal, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, të marrë masat e duhura që, të mbajë në konsideratë të parimet e prokurimit publik, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, me qëllim përdorimin e fondeve me ekonomicitet, efikasitet dhe efikasitet.

2.4.4. Auditim mbi hartimin e zbatimin e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomi fitues.

1. Mbi zbatimin e punimeve për kontratën me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve me rërë bituminoze i fshtatrave të bashkisë”:

Titulli i Gjetjes:	Nga kontrolli i dosjes teknike dhe vëzhgimit në terren për obejktin “Rikonstruksioni i rrugëve me rërë bituminoze i fshatrave të bashkisë,” u konstatuan diferenca në volume.
Situata:	Nga auditimi në terren dhe matjet e kryera nga ana e grupit të auditimit u konstatua se: Nga kontrolli në terren i këtyre rrugëve të cilat janë të shpërndara nëpër fshatra të ndryshëm të kësaj bashkie u konstatua se rrugët në shumë pjesë të tyre kishin dëmtime të medha si gropa apo rreshqitje të shtresave rrugore madje në disa pjesë rëra bituminoze kishte degraduar. Projekti i kësaj rruge <u>nuk është eficient dhe efektiv</u> pasi kjo metodë projektimi nuk garanton jetëgjatësi të objektit të ndërtuar. Një rikonstruksion rruge nuk mund të jetë jetëgjatë kur në të ndodhen vetëm 2 shtresa konkretisht stabilizant 10 cm dhe rërë bituminoze 10 cm. Lidhja mes këtyre dy shtresave nuk realizohet sipas kushteve teknike gjithashtu dhe vetë shtresa e rërës bituminoze nuk është zgjidhje e duhur marrë parasysh që këto rruge nuk kanë kanale për kullimin e ujrave. Prania e ujrave mbi sipërfaqen e rrugës për një kohë të gjatë ndikon në degradimin e rrugës për një afat kohor të shkurtër.
Kriteri:	Ligji nr. 10297, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2, neni 8 në të cilin citohet se: Qëllimi i ligjit Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë. Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit Titullarëte njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.
Ndikimi/Efekt:	Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se vlera e këtij investimi në shumën 39, 918, 096 lekë pa TVSH dhe 47, 901, 715 lekë me TVSh është shpenzim pa efektivitet për buxhetin e Bashkia Dimal,
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Dimal.
Rëndësia:	Lartë .
Rekomandime:	Nga ana e bashkisë Dimal konkretisht zyrës së urbanistikës dhe kryetarit të bashkisë të merren masa për të hartuar dhe miratuar projekte me efikasitet dhe efektivitet.

Për mangësitë e konstatuara nga hartuesit e projektit **ngarkohen me përgjegjësi:**

- 1) Zj. J.M, me detyrë Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e titullarit të AK,
- 2) Z. A.P, me detyrë Drejtor i Urbanistikës
- 3) Znj.V.J përgjigjëse e Urbanistikës
- 4) Zj. M.D specialiste e urbbanistikës

5) Z. I.S specialis i urbanistikës

2. Mbi zbatimin e punimeve për kontratën me objekt “**Mbrojtja nga gërryerjet e lumit Osum në zonën e Dafinave, bashkia Dimal**”;

Observacion:

Në lidhje me zbatimin e punimeve për kontratën me objekt “Mbrojtja nga gërryerjet e lumit Osum në zonën e Dafinave, bashkia Dimal” nëpërmjet shkresat nr. 989/8, datë 26.05.2023, administruar nga KLSH me nr. 121/6, datë 30.05.2023, ka paraqitur komente dhe shpjegime për konstatimet në lidhje me procedurat e prokurimit e konkretisht, nga zj. R.S dhe zj. N.M në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për kontratën në fjalë, është paraqitur observacion lidhur me;

Pretendimi i subjektit:

Nga ana e pretenduesve janë paraqitur dokumentacion mbi situacionin përfundimtar në të cilin paraqiten volumet e punimeve të cilat janë të përfunduara dhe janë të njëjta me ato të cilat grupi i auditimit ka verifikuar gjatë fazës në terren.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar grupi i auditimit sqaron se nuk konstatohetn diferencat volumesh me ato të matura në terren. Pta situacioni përfundimtar është në përputhje me matjet në terren. Si përfundim në këtë rast dëmi ekonomik nuk ekziston pasi nga ana e mbikëqyrësit është vënë situacioni përfundimtar i kërkuar. Për këto arsye grupi i auditimit merr në konsideratë pretendimet e paraqitura nëRaportin Përfundimtar të Auditimit.

3. Mbi zbatimin e punimeve për kontratën me objekt **Rikonstruksioni i qëndër komuntare Llambi Mile, Bashkia Ura Vajgurore**”, me këto të dhëna:

Të dhëna për:			
Kontratën e zbatimit		Mbikëqyrjen	Kolaudimin
Nr3086/10 Prot, datë 17.12.2020	Afati i punimeve është 6 muaj nga data e fillimit të punimeve.	kontrata nr.prot.38/7 datë 23.12.2020	-
Vlera e kontratës 40,608,800 lekë pa TVSH	Periudha e garancisë së defekteve – 1 vit nga data e marrjes në dorzim.	“ A. M.sh.p.k me nr. Licence L.....Q me administrator E. M.	-
Kontraktori: BOE M. sh.p.k dhe N. 2. sh.p.k	Punimet kanë filluar me datë Punimet kanë përfunduar	Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 519,529 lekë me TVSH.	-

Nga auditimi në terren dhe matjet e kryera nga ana e grupit të auditimit u konstatua se:

Zëri 2.267/1 Shtresë me pllaka porcelani importi është situacionuar 572 m2.

Sipërfaqja reale e matur nga jashtë në terren rezulton të jetë 526 m2. Duke zbritur dhe muret e jashtëm dhe të brendshëm llogaritur dhe lartësinë e plintuseve rezulton se duhet ti zbresim 33 m2 sipërfaqe. Në total janë 526 m2-33m2=493 m2 sipërfaqe e shtruar me pllaka porcelani importi. 573-492=79 x 2753 lekë/m2=217,487 lekë

Instalimet telefon/internet

Nga kontrolli në terren nuk u konstatuan këto instalime me vlerë në total për gjithë nenzërat e kësaj rubrike janë në vlerë 55,350 lekë.

F.V tub CU të përkulshëm me termoizolim fi 14 x1.0 mm UNIEN 057. Nuk u konstatua në terren edhe nga mbikëqyrësi i punimeve se ku ndodhet ky tub. Është situacionuar 550 ml me vlerë 374,550 lekë.

F.V tuba të brinjëzuar HDPE SN d=315 mm për sistemimin e KUB-së Nuk u konstatua në terren edhe nga mbikëqyrësi i punimeve se ku ndodhet ky tub. Eshtë situacionuar 80 ml me vlerë 156, 800 lekë.

Enë zgjerimi të kaldajës copë 2 me vlerë 82, 800 lekë nuk janë konstatuar nga ana e grupit të auditimit si dhe nga ana e mbikëqyrësit.

Shuma prej 886, 897 lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar bashkisë Dimal.

Kaldajë celiku (grup termik) lënda e djegshme ashkla druri me kapacitet Q=250 kë me vlerë 910, 000 lekë.

Nga kontrolli në terren u konstatua se kjo kaldajë sipas tabelës së stampuar në trupin e sajë është Q= 174 kvv

4. Mbi zbatimin e punimeve për kontratën me objekt “Rikonstruksioni i qëndër komuntare Llambi Mile, Bashkia Ura Vajgurore”:

Titulli i Gjetjes:	Nga kontrolli i dosjes teknike dhe vëzhgimit në terren për obejktin “Rikonstruksioni i qëndër komuntare Llambi Mile, Bashkia Ura Vajgurore” u konstatuan diferencë volumesh.
Situata:	<p>-Zëri 2.267/1 Shtresë me pllaka porcelani importi është situacionuar 572 m2.</p> <p>Sipërfaqja reale e matur nga jashtë në terren rezulton të jetë 526 m2. Duke zbritur dhe muret e jashtëm dhe të brendshëm llogaritur dhe lartësinë e plintuseve rezulton se duhet ti zbrisim 33 m2 sipërfaqe. Në total janë 526 m2-33m2=493 m2 sipërfaqe e shtruar me pllaka porcelani importi. 573-492=79 x 2753 lekë/m2=217, 487 lekë.</p> <p>-Instalimet telefon/internet</p> <p>Nga kontrolli në terren nuk u konstatuan këto instalime me vlerë në total për gjithë nenzërat e kësaj rubrike janë në vlerë 55, 350 lekë.</p> <p>-F.V tub CU të përkulshëm me termoizolim fi 14 x1.0 mm UNIEN 057. Nuk u konstatua në terren edhe nga mbikëqyrësi i punimeve se ku ndodhet ky tub. Eshtë situacionuar 550 ml me vlerë 374, 550 lekë.</p> <p>-F.V tuba të brinjëzuar HDPE SN d=315 mm për sistemimin e KUB-së Nuk u konstatua në terren edhe nga mbikëqyrësi i punimeve se ku ndodhet ky tub. Eshtë situacionuar 80 ml me vlerë 156, 800 lekë.</p> <p>-Enë zgjerimi të kaldajës copë 2 me vlerë 82, 800 lekë nuk janë konstatuar nga ana e grupit të auditimit si dhe nga ana e mbikëqyrësit Shuma prej 886, 897 lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar bashkisë Dimal.</p> <p>-Kaldajë celiku (grup termik) lënda e djegshme ashkla druri me kapacitet Q=250 kë me vlerë 910, 000 lekë.</p> <p>Nga kontrolli në terren u konstatua se kjo kaldajë sipas tabelës së stampuar në trupin e sajë është Q= 174 kvv</p>
Kriteri:	Ligji 8402 date 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” neni 7 Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi i punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve, i emëruar nga investitori, duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë. Mbikëqyrësi i punimeve është i

	detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Në rastin kur gjykohet nga investitori, në rolin e mbikëqyrësit caktohet një punonjës i investitorit, gjithmonë i pajisur me licencën përkatëse. Kur mbikëqyrësi i punimeve konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojë menjëherë inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut. Kontrata nr.prot.38/7 datë 23.12.2020
Ndikimi/Efekti:	Shuma prej 355, 637 lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të bashkisë Dimal.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Dimal.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga ana e mbikëqyrësit të merren masa për të zbatuar me përpikmëri projektin e miratuar sipas cdo zëri punimi.Nga ana e kontraktorit të merren masa për tu zvendësuar kaldaja me kapacitet Q=174 kv me kaldajë Q=250 kv sipas specifikimit që është përcaktuar në situacionin përfundimtar .Nga ana e bashkisë Dimal të ngrihet një grup pune për të verifikuar nëse ky zvendësim është bërë dhe të bëjnë njoftim përkatës në KLSH.

Për veprimet dhe mosveprimet e kryera ngarkohen me përgjegjësi:

1)Mbikëqyrësi i punimeve A.. M.. me administrator E.. M.

5. Mbi zbatimin e punimeve për kontratën me objekt “Rikonstrukcion i rrjeteve shpërndarës të ujësjellsit në bashkinë Ura Vajgurore” me të dhënat si më poshtë;

Kontratën e zbatimit		Mbikëqyrjen	Kolaudimin
Nr2515/5 Prot, datë 16.10.2020	Afati i punimeve është 12 muaj nga data e fillimit të punimeve.	kontrata nr.prot.3638/12 datë 16.10.2020	Kontrata 22/4 datë 27.07.2022
Vlera e kontratës 71, 774, 494 lekë me TVSH	Periudha e garancisë së defekteve – 1 vit nga data e marrjes në dorzim.	“A.M sh.p.k me nr. Licence L.Q me administrator E.M.	G-L C me administratore L. H.
Kontraktori :S. sh.p.k	Punimet kanë filluar me datë Punimet kanë përfunduar	Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 1,739,732 lekë meTVSH.	Vlera e kontratës së kolaudimit është 96,000 lekë me tvsh.

Nga auditimi në terren dhe matjet e kryera nga ana e grupit të auditimit u konstatua se:

3/1 Ujësjellsit “Rrjeti i shpërndarjes Bahkia Dimal dhe fshati Bistrovicë” subjekti S..

Janë kryer verifikimet në terren duke u bazuar dhe mbi projektin teknik dhe janë kontaktuar këto problematika:

*Zëri Shtresë cakelli t=20 cm. Nga vëzhgimi në terren i mbulimit të tubacioneve të dërgimit nga st.pompave në depo nuk u konstatua që këto tubacione të mbulphen me cakëll 20cm derisa shtersa e cakëllit është e fundit dhe do të ishte e dukshme nëse do ishte vendosur. Janë situacionuar 2209 m2 shtresë cakulli t=20 cm me vlerë 618, 547 lekë.

*Rruga për në depo.

Është situacionuar 931 m2 shtersë cakëlli t=20 cm me vlerë 279, 300 lekë. Nga vëzhgimi në terren kjo rrugë ishte e paaksesueshme nga mjetet dhe në gjendje jo të mirë. Shtresa e cakëllit pothuajse nuk dukej.

Shuma prej **897,847 lekë përbën dëm ekonomik** shkaktuar buxhetit të bashkisë Dimal.

6. Mbi zbatimin e punimeve për kontratën me objekt “Rikonstruksion i rrjeteve shpërndarës të ujësujellit në bashkinë Ura Vajgurore”:

Titulli i Gjetjes:	Nga kontrolli i dosjes teknike dhe vëzhgimit në terren për obejktin “ <i>Rikonstruksion i rrjeteve shpërndarës të ujësujellit në bashkinë Ura Vajgurore</i> ”u konstatuan punime të pakryera.
Situata:	Nga auditimi në terren dhe matjet e kryera nga ana e grupit të auditmit u konstatua se: 3/1 Ujësujelli “Rrjeti i shpërndarjes Bahkia Dimal dhe fshati Bistrovicë” subjekti S.. Janë kryer verifikimet në terren duke u bazuar dhe mbi projektin teknik dhe janë kontaktuar këto problematika: *Zëri Shtresë cakëlli t=20 cm. Nga vëzhgimi në terren i mbulimit të tubacioneve të dërgimit nga st.pompave në depo nuk u konstatua që këto tubacione të mbulphen me cakëll 20cm derisa shtresa e cakëllit është e fundit dhe do të ishte e dukshme nëse do ishte vendosur. Janë situacionuar 2209 m2 shtresë cakulli t=20 cm me vlerë 618, 547 lekë. *Rruga për në depo. Është situacionuar 931 m2 shtersë cakëlli t=20 cm me vlerë 279, 300 lekë. Nga vëzhgimi në terren kjo rrugë ishte e paaksesueshme nga mjetet dhe në gjendje jo të mirë. Shtresa e cakëllit pothuajse nuk dukej.
Kriteri:	Ligji 8402 date 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” neni 7 Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi i punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve, i emëruar nga investitori, duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë. Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Në rastin kur gjykohet nga investitori, në rolin e mbikëqyrësit caktohet një punonjës i investitorit, gjithmonë i pajisur me licencën përkatëse. Kur mbikëqyrësi i punimeve konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojë menjëherë inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut.
Ndikimi/Efekti:	Shuma prej 618,547 lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të bashkisë Dimal.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Dimal.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga ana e bashkisë Dimal të merren masa për të arkëtuar shumën prej

618,547lekë vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Për veprimet dhe mosveprimet e kryera ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Mbikëqyrësi i punimeve ARENA MK me administrator E.M.
- 2) Kolaudatori i punimeve G..L..C me administrator L.H

7. Mbi zbatimin e punimeve për kontratën me objekt “Rrjeti i jashtëm dhe brendshëm njësisë administrative Cukalat, bashkia Ura Vajgurore”:

Titulli Gjetjes:	i Nga kontrolli i dosjes teknike dhe vëzhgimit në terren për obejktin “Rrjeti i jashtëm dhe brendshëm njësisë administrative Cukalat, bashkia Ura Vajgurore”u konstatuan se:
Situata:	Nga auditimi në terren dhe matjet e kryera nga ana e grupit të auditimit u konstatua se: Nga auditimi dhe kontrolli në terren i ujësellsit të njësisë admintrative Cukalat u konstatua se rrethimet e depove Bistrovicë, Cukalat dhe Allambrez nuk janë rrethuar me rrjetë teli me gjëmba si në situacion por me rrjetë teli normale konkretisht zëri: 3.837 Rrethim me tela me gjëmba janë situacionuar 250 m2 me vlerë 450, 288 lekë në depo Allambrez, 250 m2 me vlerë 450, 288 lekë në depo Bistrovicë, 250 m2 me vlerë 450, 288 lekë, 280 m2 me vlerë 505, 620 lekë në depon Cukalat. Në total 1,406,196 lekë .
Kriteri:	Ligji 8402 date 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” neni 7 Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi i punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve, i emëruar nga investitori, duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë. Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Në rastin kur gjykohet nga investitori, në rolin e mbikëqyrësit caktohet një punonjës i investitorit, gjithmonë i pajisur me licencën përkatëse. Kur mbikëqyrësi i punimeve konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojë menjëherë inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut. Ligji nr. 10297, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2, neni 8 në të cilin citohet se: Qëllimi i ligjit Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë.
Ndikimi/Efekti:	Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se vlera e këtij investimi në 1,406,196 lekë është invenstim pa efektivitet dhe eficenc.
Shkaku:	Neglizhencë nga mbikëqyrësit
Rëndësia:	Lartë .
Rekomandime:	Nga ana e bashkisë Dimal të merren masa për të arkëtuar shumën prej 1,406,196 lekë nga operatori ekonomik BOE “S. ShPK dhe G... C” vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e ndryshimit të zërave të të punimeve të situacionuara nga ato të konstatuara në terren.
Rëndësia:	Ulët .
Rekomandime:	Nga ana e bashkisë Dimal të merren masa për të arkëtuar shumën prej 54,000 lekë vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit Për veprimet dhe mosveprimet e kryera ngarkohen

me përgjegjësi:

- 1) INSTITUTI I KONSULECES NE NDERTIM IKN me administrator Y.M
- 2) OE B.Y kolaudator i punimeve

8. Mbi zbatimin e punimeve për kontratën me objekt “Ndërtim kopshtesh në lagjen 28 nëntori Ura Vajguore, Syzes dhe lagje 4 shtatori”:

Titulli i Gjetjes:	Nga kontrolli i dosjes teknike dhe vëzhgimit në terren për obejktin “Ndërtim kopshtesh në lagjen 28 nëntori Ura Vajguore, Syzes dhe lagje 4 shtatori” u konstatuan punime të pakryera.
Situata:	Nga auditimi në terren dhe matjet e kryera nga ana e grupit të auditimit u konstatua se: Në kopshtin Syzes për rubrikën 10 të situacionit përfundimtar Gropa Septike në terren nuk u konstatua të ishte e ndërtuar kjo gropë si nga ana e grupit të auditimit si nga ana e mbikëqyrës të punimeve. Vlera e situacionuar për këtë zë me gjithë nënzërat e sajë është 314, 343 lekë. Kopështi 28 nëntori është situacionuar: Zëri i punës F.V dritare druri dopia xham 12.6 m2 dhe F.V dyer druri me dy carje vertikale me xham 6.2 m2. Nga matjet në terren rezulton se sipërfaqja e dritareve është 14.3m2. Diferenca 18.8m2-14.3 m2=4.5 m2 x 12000 lekë/m2=54, 000 lekë.
Kriteri:	Ligji 8402 date 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” neni 7 Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi i punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve, i emëruar nga investitori, duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë. Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Në rastin kur gjykohet nga investitori, në rolin e mbikëqyrësit caktohet një punonjës i investitorit, gjithmonë i pajisur me licencën përkatëse. Kur mbikëqyrësi i punimeve konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojë menjëherë inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut. Kontrata me nr, prot 36/7 datë 30.10.2020.
Ndikimi/Efekti:	Shuma prej 54,000 lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të bashkisë Dimal.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Dimal.

të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Për veprimet dhe mosveprimet e kryera ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Mbikëqyrësi i punimeve A. M me administrator E. M.

Observacion:

Për sa më sipër subjekti i audituar nëpërmjet shkresat nr. 989/5/6/7, datë 26.05.2023, administruar nga KLSH me nr. 121/6, datë 30.05.2023, ka paraqitur komente dhe shpjegime për konstatimet në lidhje me procedurat e prokurimit e konkretisht, nga zj. L.B, zj. B. B., zj. J. A., zj. M. D, Zj. R.S, Zj. I. S., Zj. M. K e Zj. I.D është paraqitur observacion lidhur me;

Pretendimi i subjektit:

Nga ana e pretenduesve janë trajtuar pretendime në lidhje me disa nga procedurat e prokurimit, lidhur me kriteret e kualifikimit, specifikimet teknike, pët të cilat kanë paraqitur sqarime të njëjta me pretendimet e paraqitura për këto procedura, mbi akt konstatimet e lëna në subjekt.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar grupi i auditimit sqaron se pretendimet e dërguara janë të njëjta sikurse janë paraqitur për akt konstatimet, duke mos sjellë fakte, prova apo referenca ligjore të reja për të kundërshtuar konstatimet e grupit të auditimit. Për këto arsye grupi i auditimit nuk merr në konsideratë pretendimet e paraqitura nëRaportin Përfundimtar të Auditimit.

2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

2.5.1. Auditimi mbi zbatimin e procedurave ligjore në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Plani i detajuar vendor;

2.5.2. Auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e regjistrit të territorit. Organizimi dhe funksionimi i Sistemit GIS;

2.5.3. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në marrjen e vendimeve për leje zhvillimore ndërtimi në pronë private dhe publike;

2.5.4. Auditim mbi zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve të përdorimit, hartimi dhe firmosja e procesverbaleve të kolauditimit nga kolaudatori, zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve;

2.5.5. Auditimi mbi mandatpagesat dhe ballafaqimi me fletën e përlllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj;

Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj;

Në zbatim të drejtimit 5, të programit të auditimit nr. 121/1, datë 31.01.2023, u shqyrtua dokumentacioni nga sistemi e-leje me të dhënat si më poshtë;

- Dokumentacioni në sistemin “E leje”;

- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës, drejtorinë e financës, drejtorinë juridike, si dhe nga arkiva, etj.

- Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastruktura.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit u konstatua se:

Titulli i Gjetjes:	Nuk janë marrë miratimet nga institucionet përkatëse.
Situata:	Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejen e ndërtimit me të dhënat:- nr. prot 2105 datë 11. 09. 2020 me zhvillues D. B. me objekt Magazinë dhe dy stalla për për rritjen e shpendëve me adresë Ura Vajguore nuk është marrë miratim nga TAP-i bazuar mbi sugjerimin që i është dhënë nga përgjigjja e shkresës së AZHT.

	- nr. 437 dhe leje ndërtimi: Magazine bujqesore 1 kat ne Drenovice, Ura Vajgurore adresa e realizimit të punimeve: Ura Vajgurore Fshati Drenovice nuk është marrë mendim nga institucionet si AKM,AZHT.
Kriteri:	VKM nr. 408, datë 13. 05. 2015 neni15 pika ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit.
Ndikimi/Efekti:	Dhënia e mendimit nga ana e institucioneve të përfshira është e rëndësishme në miratimin e lejeve të ndërtimit pasi miratimi i një leje ndërtimi pa marrë mendim pozitiv nga këto institucione mund të çenojë bazën ligjore të tyre.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Dimal.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Dimal të merren masa për të marrë mendimet pozitive nga institucionet e përfshira dhe ti respektojë rekomandimet e tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1)Zj. J.M, me detyrë Kryetar i Bashkisë Dimal, në cilësinë e titullarit
- 2)Z. A.P drejtor i DPZHTK bashkia Dimal
- 3)Zj. V.J. përgjegjës e sektorit të DPZHTK bashkia Dimal
- 4)Z. I.S specialist pranë DPZHTK bashkia Dimal

Titulli i Gjetjes:	Në planin e vendosjes së miratuar nuk është përcaktuar mënyra e aksesit në pronë.
Situata:	Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejen e ndërtimit me të dhënat: leje zhvillimi nr. 2977/1, datë 24/09/2021 dhe leje ndërtimi leje ndërtimi nr. 3360/1, datë 10/11/2021. leje ndërtimi për magazine sherbimi 1 kat " adresa e realizimit të punimeve: Kutalli,Dimal bazuar mbi përgjigjen e kthyer nga ana e ARRSH-së ku citohet se duhet të respektojë distancat nga kufiri rrugor si dhe të aksesit të bëhet në rrugët e brendshme dhe jo në aksin kombëtar Berat-Fier.
Kriteri:	VKM nr. 408, datë 13. 05. 2015 neni15 pika ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit.
Ndikimi/Efekti:	Mospërcaktimi në planvendosje i mënyrës së aksesit në pronë lë hapësira që kjo pronë mund të aksesohet dhe nga rruga kombëtare Berat -Fier e cila është në kundërshtim me përgjigjen e lëshuar nga ana e ARRSH-së.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Dimal.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Dimal të merren masa për të marrë mendimet pozitive nga institucionet e përfshira dhe ti respektojë rekomandimet e tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1)Zj. J.M, me detyrë Kryetar i Bashkisë Dimal, në cilësinë e titullarit
- 2)Z. A.P drejtor i DPZHTK bashkia Dimal

3)Zj. V.J përgjegjës e sektorit të DPZHTK bashkia Dimal

4)Z. I.S specialist pranë DPZHTK bashkia Dimal

Titulli i Gjetjes:	Nuk është bërë ballafaqimi i projekt zhvillimit të FSHZH me projektin dhe lejen e ndërtimit të miratuar nga bashkia Dimal.
Situata:	Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejen e ndërtimit me të dhënat:njesi sherbimi adresa e realizimit të punimeve: kutalli,dimal me nr. prot 1514 dhe leje zhvillimi 3827/1 datë 13. 12. 2021 bazuar mbi kthimin e përgjigjes nga ana e ARRSH-së ku në atë aks ka projekt zhvillimi nga ana e FSHZH dhe DPZHTK e bashkisë Dimal të marrë masa për të bërë ballafaqimin nëse kjo leje e miratuar prek ose jo projektin e zhvillimit që do realizojë FSHZH.
Kriteri:	VKM nr. 408, datë 13. 05. 2015 neni15 pika ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit.
Ndikimi/Efekti:	Moskryerja e ballafaqimit të dy projekteve,atij të FSHZH dhe projektit të lejes së ndërtimit të miratuar nuk jep garanci që zhvillimi i ri që do kryhet nga leja e miratuar nuk prek projekt-zhvillimin që do kryej FSHZH.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Dimal.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Dimal të merren masa për të marrë mendimet pozitive nga institucionet e përfshira dhe ti respektojë rekomandimet e tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1)Zj. J.M, me detyrë Kryetar i Bashkisë Dimal, në cilësinë e titullarit

2)Z. A.P drejtor i DPZHTK bashkia Dimal

3)Zj. G.H me detyrë specialiste pranë DPZHTK bashkia Dimal

4)Z. I.S specialist pranë DPZHTK bashkia Dimal

5)Zj. M.D specialiste pranë DPZHTK bashkia Dimal

Titulli i Gjetjes:	Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI).
---------------------------	--

Situata:	<p>Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejen e ndërtimit me të dhënat: -Njesi Sherbimi ADRESA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE: Kutalli,Dimal me nr. prot 1514 dhe leje zhvillimi 3827/1 datë 13. 12. 2021 taksa e ndikimit në infarstrukturë nuk është llogaritur saktë pasi duhet të merret vlera më e lartë nga dy mënyrat e llogaritjes së vlerës së investimit,asaj sipas preventivit dhe sipas kostos së ndërtimit. Vlera e preventivit: 10,002,033 lekë. Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtim shërbime: 5% Taksa për tu paguar: 10,002,033 lekë * 5% = 500,101. 65 lekë vlerë kjo e llogaritur nga ana e DPZHTK bashkia Dimal.</p> <p>Taksa e ndikimit llogaritur sipas kostos së ndërtimit: $425 \text{ m}^2 * 37000 \text{ lekë/m}^2 * 5\% = 786,250 \text{ lekë}$ Diferenca $786,250 \text{ lekë} - 500,101 = 286,149 \text{ lekë}$.</p> <p>- Nr. 2471/2, datë 24/08/2021 Fabrikë për përpunimine vajit të ullirit, bashkia Ura Vajgurore, Vlera e objektit 11,037,296lek *2% =220745. 9 leke. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur saktë pasi objekti Fabrikë vaj ulliri është kategorizuar në grupin e objekteve bujqësore me nivel taksimi 2%. Duhet të ishte kategorizuar në grupin e objekteve industri pasi kemi të bëjmë me prodhim të një produkti dhe jo magazinim bujqësor bazuar mbi paketën fiskale Vlera e objektit 11,037,296lek *2% =220745. 9 leke. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur saktë pasi objekti Fabrikë vaj ulliri është kategorizuar në grupin e objekteve bujqësore me nivel taksimi 2%. Duhet të ishte kategorizuar në grupin e objekteve industri me 3% pasi kemi të bëjmë me prodhim të një produkti dhe jo magazinim bujqësor bazuar mbi paketën fiskale. $11,037,296 * 3\% = 331,118 \text{ lekë}$. Diferenca $331,118 - 220,745 = 110,373 \text{ lekë}$.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji 107 Neni 46 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja 1. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë. 2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja paguhet përpara dorëzimit të dokumentit të lejes së ndërtimit nga autoriteti përgjegjës i planifikimit.</p> <p>- vendimi nr. 80 datë 24. 12. 2021 “mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore për bashkinë dimal dhe njësitë administrative.</p>
Ndikimi/Efekti:	Vlera prej 286,149 lekë dhe vlera prej 110,373 lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar bashkisë Dimal.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Dimal.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga ana e DPZHTK bashkia Dimal të merren masa për të arkëtuar shumat prej 286,149 lekë dhe 110,373 lekë shuma të cilat përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë si dhe të merren masa për të llogaritur në mënyrën e saktë taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1)Zj. J.M, me detyrë Kryetar i Bashkisë Dimal, në cilësinë e titullarit

- 2)Z. A.P drejtor i DPZHTK bashkia Dimal
- 3)Zj. G.H me detyrë specialiste pranë DPZHTK bashkia Dimal
- 4)Z. I.S specialist pranë DPZHTK bashkia Dimal
- 5)Zj. M. D specialiste pranë DPZHTK bashkia Dimal

Titulli i Gjetjes:	Nuk përputhet projekti i miratuar në lejen e ndërtimit me certifikatën e përdorimit të miratuar.
Situata:	Nga kontrolli në sistemin e-leje për certifikatën e përdorimit me të dhënat: “Banese 1kat mbuluar me cati, me bodrum”, në fshatin Donofrose, Njësia Administrative Cukalat, Bashkia Dimal, paraqitur nga zhvilluesi F.S. me nr. prot 1553 Certifikatë përdorimi. Nuk përputhet realizimi në terren i objektit bazuar mbi imazhet e ngarkuara në sistemin e-leje krahasuar me projektin e miratuar.
Kriteri:	vkm 408Neni 27 Certifikata e përdorimit 1. Në përfundim të procesit të zhvillimit aplikuesi paraqet kërkesën për t’u pajisur me certifikatë përdorimi, së bashku me procesverbalin e kolaudimit dhe dokumentacionin shoqërues, përfshirë deklaratën teknike se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe kushtet teknike në fuqi, pranë autoritetit të zhvillimit.
Ndikimi/Efekti:	Mosrespektimi i projektit të miratuar nga DPZHTK bashkia Dimal con në kequrbanizim të zonave në zhvillim duke lënë pasoja me efekt negativ.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Dimal.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga DPKZHT Dimal të merren masa për të respektuar me përpikmëri zbatimin e projektit të miratuar.

Për veprimet e mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1)Zj. J.M, me detyrë Kryetar i Bashkisë Dimal, në cilësinë e titullarit.
- 2)Z. A.P drejtor i DPZHTK bashkia Dimal.
- 3)Zj. G. H me detyrë specialiste pranë DPZHTK bashkia Dimal.
- 4)Zj. M.D specialiste pranë DPZHTK bashkia Dimal.

2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Territorit të Njesisë Vendore.

6.1. Auditim mbi plotësimi i kriterëve arsimore për punonjësit e IMT, sipas përcaktimeve të nenin 11 të ligjit nr. 183/2014 datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit në ndërtimet e kundërligjshme” etj;

6.2. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

6.3. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

6.4. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatimin në teren të kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit të Bashkisë etj, sipas dispozitave ligjore në fuqi (neni 81-Inspektimi, pika 3, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar, etj.).

Në zbatim të drejtimit 6, të programit të auditimit nr. 121/1, datë 31.01.2023, u shqyrtua dokumentacioni i dosjes së procedurës me objekt “**Kontrolli i IMTV**” me të dhënat si më poshtë;

Në bazë të process-verbaleve të kundravajtjes, vendimeve të gjobave, vendimeve të prishjeve të objekteve të kundraligjshme, të vëna në dispozicion nga IMTV bashkia Dimal janë ilustruar në Aneksin nr. 1, pika 6, “*Mbi të dhënat për kundravajtjet e vendosura nga (IMTV)*”, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Territorit të Njësisë Vendore u konstatua se:

Titulli i Gjetjes:	Arsimimi i kryeinspektorit të IMTV bashkia Dimal.
Situata:	Nga kontrolli i inspektoriatit të mbrojtjes së territorit bashkia Dimal u konstatua se arsimimi i kryeinspektorit nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
Kriteri:	Ligjin 9780 neni Neni 11 Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, tekno-logjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.”.
Ndikimi/Efekti:	Emërimi i një punonjësi pa arsimimin përkatës sipas kuadrit ligjor në fuqi sidomos në pozicione të cilat nevojiten punonjës të aftë edhe nga ana teknike vec menaxheriale sjell mosfunksionim normal të këtij sektori sic është IMTV.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e kryetarit të bashkisë Dimal.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga e kryetarit të bashkisë Dimal të merren masa për të emëruar në krye të këtij inspektoriatit punonjës me arsim të duhur sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Kryetari i bashkisë Dimal J. M.

Titulli i Gjetjes:	*Në 10 raste nuk është mbajtur vlera e gjobës sipas vlerës së punimeve të kryera në kundërshtim
Situata:	Nga kontrolli i inspektoriatit të mbrojtjes së territorit u konstatua se në 10 raste nuk është mbajtur vlera e gjobës sipas kuadrit ligjor në fuqi.
Kriteri:	Ligji 107/2014 Neni 52 Kundërvajtjet administrative e) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera
Ndikimi/Efekti:	Efekt negativ në buxhetin e bashkisë Dimal.
Shkaku:	Mosaftësi profesionale për të llogaritur saktësisht vlerat e gjobave sipas rasteve të kundravajtjeve.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga ana e kryetarit të bashkisë Dimal të merren masa për të emëruar në krye të këtij Inspektoriatit punonjës me arsim të duhur sipas kuadrit ligjor

	në fuqi. Gjithashtu nga IMTV të merren masat e duhura për rastet e konstatuara me shkelje të vendosen kundërvajtjet administrative përkatëse.
--	---

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Ish/Kryeinspektori i IMTV A. C.

Kryeinspektori i IMTV K.C

Titulli i Gjetjes:	Nuk janë mabjtur vendime gjobash dhe vendime prishje sipas akteve të konstatimit të mabjtura në terren.
Situata:	Nga kontrolli i inspektoriatit të mbrojtjes së territorit u konstatua se në 58 rastë është konstatuar se janë mbajtur process-verbal kundravajtje por nuk kanë dalë me vendime gjobe,në 94 rastë është mbajtur proves-verbal kundravajtje është mbajtur dhe vendim me gjobë por nuk është mbajtur vendim prishje.
Kriteri:	Ligji 9780 për inspektimin dhe kontrollin e territorit, Neni 5 Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore Gjatë ushtrimit të përgjegjësi të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme: a) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit; b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit; c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit; ç) vendos pezullimin e punimeve/ndërtimeve në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit; d) vendos prishjen e ndërtimit të kundër-ligjshëm; dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjisllacionit në fuqi; e) detyrohet t'i japë informacionin dhe/ose dokumentacionin e kërkuar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit brenda një afati kalendarik 5-ditor nga data marrjes së kërkesës, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij inspektorati; ë) merr vendim zhdëmtimi në ngarkim të subjektit kundërvajtës për shpenzimet e prishjes së ndërtimit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme; f) përgatit dhe i jep të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, të këtij neni. Fjala “ndërtim/punim”, sipas këtij neni, përfshin ato procese dhe/ose objekte ndërtimore që ndërtohen ose instalohen në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, që zhvillohen nën dhe/ose mbi tokë, çdo veprim/proces ndërtimi, gërmimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në territor ose strukturë dhe i referohet gjendjes 4 aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme në çastin e ushtrimit

	të inspektimit.”.
Ndikimi/Efekti:	Keqfunksionim dhe keqmenaxhim i inspektoriatit vendor të mbrojtjes së territorit.
Shkaku:	Mosaftësi profesionale për të menaxhuar dhe kryer detyrën sipas kuadrit ligjor në fuqi.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga e kryetarit të bashkisë Dimal të merren masa për të emëruar në krye të këtij inspektoriatit punonjë me arsim të duhur sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Ish/Kryeinspektori i IMTV A.C

Kryeinspektori i IMTV K.C

2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

2.7.1 Hartimi i programit (Plan veprimet) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

1.Hartimi i programit (Plan veprimet) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Dimal rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 375/9 datë. 15.09.2022. Nga Bashkia Dimal për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditësh, në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit” me shkresën nr. 1104/11prot, datë07.10.2022, me atë të së cilës janë pranuar të gjitha rekomandimet. Bashkia Dimal ka përgatitur programin e masave që do të merren dhe realizohen për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar afatet, personat apo drejtoritë përgjegjëse si dhe janë nxjerrë shkresat përkatëse për zbatim. Ky program masash është dërguar në KLSH me shkresën nr. 1104/17 prot, datë 07.10.2022.

2.7.2 Realizimi i programit (Plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve, në zbatim të afatit ligjor të përcaktuar në pikën nr. 2, neni 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, e cila citon: “*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*” rezulton se:

Nga ana e Bashkia Dimal nuk është dërguar raporti mbi realizimin e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor për zbatimin e rekomandimeve veprim jo në përputhje me përcaktimet e ligjit funksional për KLSH-në. Për këto veprime e mosveprime ngarkohet me përgjegjësi kryetari i Bashkisë z. J.M.

Gjithashtu nga Bashkia Dimal nuk rezulton të jetë raportuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve në Këshillin e Bashkisë.

Titulli i gjetjes:*Mos raportim brenda 6-muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit dhe mos raportim në KB mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.*

Situata:Nga auditimi konstatohet se,Bashkia Dimal ka hartuar planin e veprimet të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1104/17 datë 07.10.2022, por nuk ka

dërguar raport brenda 6-muajve për realizimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna. Gjithashtu rezultoi se Bashkia Dimal nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij”.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5.

Ndikimi: Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit sjell që disa aktivitete në Bashkinë Dimal të kryhen në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe të kenë ndikime financiare në vijimësi.

Shkaku: Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Dimal me qëllim zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Bashkia Dimal të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi. Gjithashtu të raportohet në auditimet në vijim brenda afatit të përcaktuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

2.7.3 Statusi i rekomandimeve të lëna në Auditimin e mëparshëm.

Titulli i gjetjes: Bashkia Dimal nuk ka marrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Situata: Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 375/9 datë 15.09.2022 i ka dërguar Bashkinë Dimal Raportin Përfundimtar të Auditimit në të cilin, për përmirësimin e gjendjes, është kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 16 masa organizative janë pranuar 16 masa nga të cilat janë realizuar 3 masa, janë në proces 3 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe nuk janë zbatuar 7 masa.

b. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike-të ardhura të munguara janë rekomanduar 4 masa nga të cilat, janë pranuar për zbatim 4 masa, janë zbatuar 1 masë, janë në proces zbatimi 2 masa, dhe është 1 masë pjesërisht e realizuar.

c. Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Dimal, për punonjësit e saj konstatohet se nga ana e Bashkia Dimal nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e konstatuar me shkelje dhe me përgjigjësi në Raportin e auditimit të mëparshëm.

Kriteri: Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa j), ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime,

Shkaku: Mos ndjekja e gjitha procedurave për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës 1,422,101 lekë.

Ndikimi/Efekti: Ndikon në përmirësimin e proceseve të veptimtarisë së Bashkisë Dimal.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dimal të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përshpejtuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara dhe pjesërisht të zbatuara si më poshtë:

Për zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH është ngritur grupi i punës pa nr. prot, dhe pa datë, me përbërje zj. M.B Drejtori i Financës dhe Buxhetit, zj. R.S me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, z. A.P me detyrë Drejtor i Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, zj. N. P Drejtorja Juridik, z. I.S Drejtor i Tatim Taksave dhe Menaxhimit të Aseteve, z. Q.M Përgjegjës i sektorit të auditimit të Brendshëm, zj. B. B me detyrë përgjegjëse e sektorit të Burimeve Njerëzore, z. K. Ç me detyrë kryeinspektor i IMVT dhe zj. G. H me detyrë specialiste në sektorin Juridik dhe të Burimeve njerëzore, e cili ka hartuar Programi e Punës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH. Zbatimin e rekomandimeve në rubrikat Masa organizative, Masa për ulla e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, Masa për Eliminimin e Efekteve Negative të konstatuara në Administrimin e Fondeve Publike dhe për Menaxhimin me Ekonomicitet, Efiçencë dhe Efektivitet të Fondeve Publike si dhe Masat Disiplinore të detajuara në plan veprimin janë realizuar e konkretisht:

MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm konstatohet se, Bashkia Dimal nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Edhe pse janë miratuar regjistrat e riskut, bashkia nuk ka hartuar një strategji në menaxhimin e riskut, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke u mjaftuar vetëm me trajnimet e organizuara nga ASPA, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh në njësinë vendore. Nuk janë hartuar programe për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafi. Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet, nuk ka programe të licencuara e për rrjedhojë programet me të cilat punohet nuk garantojnë mbrojtjen e të dhënave të sistemit elektronik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, 20, 21, 22, neni 32 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes. vendore”, urdhrin e Kryeministrit nr.164 datë 05.10.2017. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 19-27 të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Autorizues, të merren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, të hartojë dhe të miratoj gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhërin nr.2851 datë 06.10.2022 ka hartuar planin e masave për njohjen e sistemit të GMS, në të cilin janë përcaktuar objektivat, planet konkrete, personat përgjegjës.

Njësia e Auditimit ka marë pjesë në seanca trajnimi organizuar për njohjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Është bërë hartimi dhe miratimi i regjistrit të rrishtit nga të gjitha drejtoritë., ku janë evidentuar rrishtet kryesore. Jane zhvilluar seanca dëgjimore me përfaqësues të Ministrisë së Financave për menaxhimin financiar dhe kontrollin, dhe nga Sekretari i Përgjithshëm i Njesisë, si dhe për manualet e proceseve të punës,

Nëpunesi Autorizues, Drejtorja e Financës, Grupi i Menaxhimit Strategjik në mbledhjet periodike gjatë vitit 2022, ka kryer analiza për njohjen dhe identifikimin e risqeve për arritjen e objektivave të institucionit duke i njohur Drejtuesit e Menaxhimit dhe me Manualin e menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Deri në datën e verifikimit rezulton se ky rekomandim është zbatuar.

1.2. Rekomandimi: Nga Drejtorja e Burimeve Njerëzore të merren masa për përditësimin e rregullores duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.3 Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhërin nr.2851/1 datë 06.10.2022 ka ngarkuar Drejtorin e Burimeve Njerëzore në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit.

Deri në datën e verifikimit është bërë si më poshtë:

Burimet njerëzore janë duke përshtatur rregulloren e brendshme të Intitucionit në lidhje me përshkrimet e punës për pozicionet sipas strukturës 2023. Ndërkohë janë realizuar të gjitha përshkrimet e punës për pozicionet sipas formularëve standart ligjorë (formulari 4). Në lidhje me nevojat për trajnim Burimet njerëzore kanë planifikuar nevojat për trajnim të stafit dhe i kanë përcjellë ato pranë ASPA me shkresën nr. 1449/2prot, datë 07.11.2022 dhe në mënyrë elektronikë datë 09.11.2022 sipas dokumentit bashkëlidhur.

Deri në datën e verifikimit rezulton se ky rekomandim është zbatuar.

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Dimal, u konstatua se për vitet 2020 dhe 2021 është përcaktuar që NJAB të ketë në përbërjen e saj 3(tre) punonjës, por që për periudhën nën auditim rezulton se kjo njësi ka funksionuar me 3 (dy) punonjës 1 përgjegjësi i njësisë i certifikuar dhe 2 specialist auditit të pa certifikuar, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, “Manualit të Auditimit të Brendshëm” miratuar nga Ministër i Financave nr.100/ 2016 dhe VKM nr.83/2016, përcaktohet qartë që në strukturën e [AB] mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm dhe gjatë afatit 2 vjeçar zhvillon trajnimet e mjaftueshme për tu certifikuar.[NJAB]. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 19-27 të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dimal, të marrë masa për plotësimin e strukturës së NJAB konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi duke marrë masa për certifikimin e audituesve të pa certifikuar.

2.2 Nga verifikimi rezultoi se:

Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhërin nr.2851/2 datë 06.10.2022 ka ngarkuar Drejtorin e Burimeve Njerëzore në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit. Deri në datën e verifikimit është bërë Regjistrimi i 2 specialistëve të auditit në Kursin e Çertifikimit në Sezonin 2022-2023.

Specialistët e Njësisë së Auditit të Brendshëm janë në proces çertifikimi 13881/1 prot, datë 19.07.2022 të drejtorisë së harmonizimit dhe auditimit të brendshëm).

Deri në datën e verifikimit rezulton se ky rekomandim është ende në proces.

3. Gjetje nga auditimi: Realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2021 me të ardhurat e veta të Bashkisë Dimal ka diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar, pasi planifikimi është në vlerën 233,212,180 lekë, ndërsa realizimi në vlerën 159,351,349 lekë, ose në masën 68%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 51,945,680 lekë, realizuar 21,602,995 lekë, ose në masën 41 %.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Dimal në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” Gjithashtu edhe gjatë vitit 2021 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor, duke mos nxjerrë konkluzione për rishikimin e buxhetit vjetor 2021. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 27-46 të Raportit të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtorja e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuara dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korrigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2.Nga verifikimi rezultoi se:

Në zbatim të të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 2851/3 datë 06/10/2022 ka ngarkuar Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e të Ardhurave Vendore në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit.

Deri në datën e verifikimit rezulton se ky rekomandim është i pa zbatuar.

4.Gjetje nga auditimi: Bashkia Dimal nuk ka marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura. Në datën 01.01.2021 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 124,121,418 lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Nga kjo vlerë gjatë vitit 2021 është likuiduar vlera 71,441,097 lekë, ose 66% e detyrimit.

Por gjatë vitit 2021 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 48,676,892 lekë, duke e çuar vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në datën 31.12.2021 në 101,357,088 lekë, ose në masën 18% më ulët se detyrimet në fillim të vitit buxhetor.

Raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimet totale të miratuara, ka vlerën 17.8% (101,357,088/569,028,077), shifër që e klasifikon Bashkinë Dimal në njësi të qeverisjes vendore me probleme financiare.

Detyrimet e prapambetura janë krijuar nga mos realizimi i të ardhurave dhe nga marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, datë 27.04.2017, kreu XI, neni 55, pika 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 27-46 të Raportit të Auditimit).

4.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dimal dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2.Nga verifikimi rezultoi se:

Në zbatim të të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 2851/3 datë 06/10/2022 ka ngarkuar Drejtorinë e Financës në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit

Ky rekomandim është i pa zbatuar.

5.Gjetje nga auditimi: Bashkia Dimal për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën 1,623,128 lekë, nga e cila vlera 532,128 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve për 2 raste, ndërsa vlera 1,091,000 lekë për 2 raste i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore, njëri prej të cilëve lidhet me dëmshpërblim për shlyerje të vonuar investimi nga fondet e buxhetit të shtetit (FZHR), ndërsa vendimi tjetër me objekt dëmshpërblim për probleme pronësie.

Si rezultat i fenomenit të mos likuidimit në kohë të detyrimeve kontraktuale nga fondet e buxhetit të shtetit (FZHR), Bashkia Dimal ka administruar vendimin gjyqësor nr. 2270 datë 05.02.2019, me objekt dëmshpërblim për shlyerje të vonuar investimi, vlerë të vendimit 16,640,021 lekë, kreditor subjekti “G. K.” ShPK, prej të cilit gjatë vitit 2021 është likuiduar vlera 1,000,000 lekë, ndërsa vlera 15,640,021 lekë është detyrim i pa shlyer.

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFEnr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 27-46 të Raportit të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dimal të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të

ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 2851/3 datë 06/10/2022 ka ngarkuar Drejtorinë e Financës në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit.

Ky rekomandim është i pa zbatuar.

6.Gjetje nga auditimi: Në Strukturën e DTV Bashkia Dimal janë evidentuar mangësi në funksion të realizimit e të ardhurave, pasi nuk është krijuar Sektori i Masave Shtrenguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në DTV Bashkia Dimal, ku janë evidentuar një numër i lartë i detyrimeve të paarkëtuara (debitor), në vlerën 222,498 mijë lekë, nga e cila: subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërorë në vlerë 29,320 mijë lekë për 123 subjekte si dhe abonentë familjarë në vlerë 193,178 mijë lekë, në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI-“Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me shkresën nr. 737 prot., datë 07.02.2018. Veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin Autorizues si dhe Drejtorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2. faqet 27-46 të Raportit të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dimal në bashkëpunim me Drejtorin e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Dimal me specialit të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.2.Nga verifikimi rezultoi se:

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 2851/4 datë 06/10/2022 ka ngarkuar Sektorin e Burimeve Njerëzore në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit.

Ky rekomandim është i pa zbatuar.

7.Gjetje nga auditimi: Për vitin 2021, Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 70, datë 02.12.2020, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat. Nga të dhënat e pasqyrës aneks nr. 2 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit, shihet se për vitin 2021 planifikimi i të ardhurave është në vlerën 257,891 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 169,929 mijë lekë ose 66 %, mos realizim në vlerën 87,962 mijë lekë, kryesisht në taksat e popullatës, si p.sh. taksa e tokës bujqësore, taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërimit. Konstatohet se për disa taksa dhe tarifa, realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa taksa dhe tarifa të tjera realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve, e cila kryesisht vjen për shkak të mosnjohjes së situatës dhe moskryerjes së rregullt të procedurave, gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Dimal, që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkallimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale, për të mos shkaktuar deficit në të

ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve, etj, në dëm të interesave të publikut. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë”; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 42, “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, “Raportimi financiar” nënpika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 27-46 të Raportit të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Bashkia Dimal, gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.2.Nga verifikimi rezultoi se:

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 2851/3 datë 06/10/2022 ka ngarkuar Drejtorinë e Financës në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit

Deri në datën e verifikimit është ende në proces.

8.Gjetje nga auditimi: Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimore dhe mbajtjen e aktrakordimeve respektivisht:

- Me ASHK për taksa e kalimit të pronësisë;
- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe me Ministrinë e Financave.
- Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, nuk është mbajtur korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 27-46 të Raportit të Auditimit).

8.1.Rekomandimi; Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Dimal, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga Agjentët Tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizmin e Agjentëve Tatimore me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

8.2.Nga verifikimi rezultoi se:

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 2851/5 datë 06/10/2022 ka ngarkuar Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit.

Deri në datën e verifikimit është bërë si më poshtë:

-Me ASHK nuk janë ndërmarrë veprime.

-Me renten kemi kërkuar informacion me nr 2886 prot ne dt 11/10/2022 per derdhjen e rentes minerare ne bashkinë Dimal, Kthim pergjigje me nr 18062/1 dt 02/11/2022 per venien ne dispozicion emrat e guroreve dhe NIPT.Nga ana jone është vene ne dispozicon lista me te dhenat e subjekteve me shkres nr 2886/2 prot dt 03/11/2022. Kthim pergjigje nr 18062/3 prot dt 10/11/2022 nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave informacioni jo i detajuar.

Ky rekomandim është pjesërisht i zbatuar.

8.2.Rekomandimi; Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mbliidhen nga Agjentët Tatimore, të kryqëzojë informacionet me institucioni e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

8.3.Nga verifikimi rezultoi se:

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 2851/6 datë 06/10/2022 ka ngarkuar Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit.

Deri në datën e verifikimit është bërë si më poshtë:

-Çdo muaj kryhet akt-rakordim me D.R.SH.T.RR Berat

-Cdo muaj kryhet akt-rakordimi SH.A.U.K Dimal

-Cdo muaj kryhet akt-rakordim me D.R.T Berat

-Informacion cdo muajpërditësohet nga Ministria Finacave

Ky rekomandim është pjesërisht i zbatuar.

9.Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 303,646,532 lekë, të cilat janë detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore të papaguara deri në 31.12.2021 e analizuar sipas aneksit nr. 2 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit. Nga analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” konstatohet se Drejtoria e Financës nuk ka bërë kontabilizimin e detyrimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH-së të dërguara në Bashkinë Dimal respektivisht, shkresa me nr. 259/19 datë 06.07.2017 si dhe shkresa me nr. 262/9 prot., datë 27.06.2020 edhe pse ka dalë urdhër zhdëmtimeve përkatëse, të dala nga Kryetari i Bashkisë sipas planit të veprimit. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93. (Më hollësisht trajtuar në pika 3, faqet 46-57 të Raportit të Auditimit).

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për kontabilizimin e masave shpërblim dëmi të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dërguar në Bashkinë Dimal me shkresat me nr. 259/19 datë 06.07.2017 si dhe shkresa me nr. 262/9 prot., datë 27.06.2020

9.2.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 2851/3 datë 06/10/2022 ka ngarkuar Drejtorinë e Financës në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit.

Deri në datën e verifikimit rezultoi se ky rekomandim është zbatuar.

10.Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” (debitorë) më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 33,272,199 lekë. Nga analiza e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” për vitin 2021 konstatohet se vlera 2,540,000 lekë e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin” është bërë në mënyrë të gabuar, në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 32. (Më hollësisht trajtuar në pika 3, faqet 46-57 të Raportit të Auditimit).

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” Veprimet sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022.

Në mbyllje te pasqyrave financiare 2022

10.2.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 2851/3 datë 06/10/2022 ka ngarkuar Drejtorinë e Financës në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit.

Ky rekomandim është i pa zbatuar.

11.Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 19,539,878 lekë, ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 36,033,092 lekë, e analizuar sipas aneksit nr. 2 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit. Nga analiza e kësaj llogarie u konstatua se në totalin e llog 202- Studime dhe kërkime", nga 31 projekte që janë në këtë llogari një pjesë e projekteve dhe studimeve janë vënë në zbatim ose kanë përfunduar gjatë viteve të mëparshme dhe gjatë vitit ushtrimor 2021, nuk i janë shtuar kostos totale të objekteve, megjithëse vlerat respektive të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” dhe llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” janë rritur në kontabilitet, në këto llogari nuk janë shtuar kostot e projekteve përkatëse. Konstatohet se Drejtoria e financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2021, në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33. (Më hollësisht trajtuar në pika 3, faqet 46-57 të Raportit të Auditimit).

11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë (202) “Studime dhe kërkime”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e kostos totale të objektit.

11.2.Nga verifikimi rezultoi se:

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 2851/3 datë 06/10/2022 ka ngarkuar Drejtorinë e Financës në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit.

Deri në datën e verifikimit është bërë si më poshtë:

Ky rekomandim është i pa zbatuar.

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për periudhën objekt auditimi janë certifikuar në total 8 prona si dhe përpara vitit 2020 janë certifikuar 68 prona objekte inventari në ndërtesa e konstruksione të cilat nuk janë të pasqyruara në llogaritë përkatëse të AAM respektivisht

- Llogaria 210 "Toka, troje, terrene", më 31.12.2020 paraqitet me vlerë 0 lekë e pa ndryshuar dhe për vitin 2021. Nga auditimi rezultoi se referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Dimal ka regjistruar në Drejtorinë rajoneve të ASHK Dimal 57 prona të cilat janë pajisur me certifikatë pronësie për të cilat nuk është bërë kontabilizimi i tyre si rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur e analizuar sipas aneksit nr. 3 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit;

- Llogaria 211 "Pyje, Plantacione, kullota" më 31.12.2020 paraqitet me vlerë 4,884,832 lekë ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 5,204,732 lekë e cila përfaqëson vlerën neto të pyjeve në administrim e pronësi të Bashkisë Dimal e analizuar sipas aneksit nr. 4 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit. Nga analiza e kësaj llogarie si dhe referuar procesit të inventarizimit si dhe referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Dimal ka regjistruar në Drejtorinë rajoneve të ASHK Dimal 18 prona të cilat janë pajisur me certifikatë pronësie për të cilat nuk është bërë kontabilizimi i tyre si rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur e analizuar sipas aneksit nr. 3 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

- Llogaria (212) "Ndërtesa e Konstruksione", më 31.12.2020 paraqitet me vlerë 781,539,208 lekë dhe më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 751,168,448 lekë. sipas aneksit nr. 5 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se në llogarinë 212 "Ndërtesa e Konstruksione", nuk është kontabilizuar Objekti Kopshti i Fshatit Poshnjë me numër pasurie 455/19, indeksi i hartës 172-A zona kadastrale 3032, si rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur e analizuar sipas aneksit nr. 3 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33. (Më hollësisht trajtuar në pika 3, faqet 46-57 të Raportit të Auditimit).

12.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Dimal në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procedurat ligjore të rivlerësimit të 76 prona të certifikuar në ASHK, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Dimal më 31.12.2022, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale historike (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje/ulje rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse(21) "Aktive afatgjata materiale" e llog.(109) "Diferenca nga rivlerësimi".

12.2.Nga verifikimi rezultoi se:

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 2851/8 datë 06/10/2022 ka ngarkuar Drejtorinë e Financës në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit.

Ky rekomandim është i pa zbatuar.

12.2.Rekomandimi:Titullari i Bashkisë Dimal në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të ngrëjë një grup pune me specialit të fushës, për kryerjen e inventarizimit të asteve të Bashkisë Dimal, të paraqitura në pasqyrat financiare, mbi evidentimin e gjendjes së tyre në fakt dhe në rast mungesë të ndiqen procedurat ligjore për sistemin dhe nxjerrje përgjegjësie.

12.3.Nga verifikimi rezultoi se:

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 2851/9 datë 06/10/2022 ka ngarkuar Drejtorinë e Financës në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit. Deri në datën e verifikimit është bërë si më poshtë:

Nga ana e titullarit është ngritur grupi i punës me spëcialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit të aseteve të Bashkisë Dimal, të paraqitura në pasqyrat financiare, mbi evidentimin e gjendjes së tyre në fakt.

Ky rekomandim është në proces zbatimi.

13.Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes nga auditimi i fundit të kryer në Bashkinë Dimal, sipas shkresës nr. 241/44 datë 13/04/2021, u konstatua se: Bashkia Dimal nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor, si dhe nuk ka hartuar një plan veprimi të ri për masat e ri kërkuara, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të ri kërkuara, u konstatua se: nga 9 masa organizative të rikërkuara është zbatuar 1 masa organizative, janë në proces 3 masa dhe nuk është zbatuar 5 masa organizative.

Nga 9 masa shpërblim dëmi në vlerën 42,161,450 lekë, është arkëtuar vlera 426,000 si dhe ndodhen në proces gjyqësorë 6 masa në vlerë 41,735,450 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 67-78 të Raportit të Auditimit).

13.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dimal të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën Nr. 241/44 datë 13/04/2021, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre, konkretisht:

a-Për 3 masa organizative të cilat janë në proces si dhe për 5 masa organizative të pa zbatuar

b-Për 6 masë shpërblim dëmi në vlerë 41,735,450 lekë.

Menjëherë

13.2.Nga verifikimi rezultoi se:

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë ka ngritur Urdhërin nr. 2851/10 datë 06/10/2022,në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit.

Deri në datën e verifikimit është bërë si më poshtë:

Rekomandimet janë diskutuar në takimet periodike me drejtuesit e programeve buxhetore për analizën e përgjegjësisë për secilin.

Ky rekomandim është pjesërisht i zbatuar.

MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE. (TËARDHURA TË MUNGUARA)

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Dimal, nuk ka vepruar në mënyrë efektive për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjare në vlerën 222,498,907 lekë si vijon:

Nga mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë për abonentët familjar në vlerën 193,178,411 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Dimal, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjar deri në datën 31.12.2021.

Nga mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në vlerën 29,320,496 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguara për buxhetin e Bashkisë Dimal. Në mënyrë të përmbledhur debitorët e subjekteve fizikë dhe juridike paraqiten në aneksin 7 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit. Veprimet e mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve. (Më hollësisht trajtuar në pika 2.6, faqet 27-46, të Raportit të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Dimal, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën 222,498,907 lekë, duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon:

Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.

Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).

Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

Drejtorja e të Ardhurave Vendore Bashkia Dimal, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke të njoftojë nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) familjet të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

1.2.Nga verifikimi rezultoi se:

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 2851/6 datë 06/10/2022 ka ngarkuar Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit. Deri në datën e verifikimit është bërësi më poshtë:

A-Ka kryer urdher bllokime per tatimpagues familjar nr 2146/19 deri 2146/22 dt 30/08/2022, 2261/4 dt 30/08/2022, 2264/5 dt 31/08/2022, 2261/6-2261/7-2261/15 dt 02/09/2022, 2734/9 dt05/10/2022, 2734/10 dt 06.10/2022, 2734/11 dt10/10/2022, 2734/12-2734/13 dt 12/10/2022,2734/14 dt 14/10/2022,2734/15-2734/16 dt 17/10/2022,2734/18-2734/19 dt 24/10/2022,2734/20-2734/21 dt 26/10/2022,2347/18 dt 27/10/2022,3081 dt 28/10/2022,3081/4

dt07/11/2022,3081/5 dt 08/11/2022,3081/6 dt 10/11/2022,3081/7 dt 16/11/2022,3081/9 dt 25/11/2022, 3081/13 dt 05/12/2022, 3081/14 dt 09/12/2022, 3081/15 dt 15/12/2022, 2507/24 dt 26/09/2022.

-Urdher bllokim per biznesin 2734/3-2734/6 dt 28/09/2022.

B-Është dërguar kërkesë përtë dhëna me nr. 3597 prot dt 30/12/2022 D.RSH.TRR Berat, kthim pergjigje nga ana e tyre nr 8/1 prot dt 10.01.2023.

C-Ka kryer urdher ekzekutim per cdo subjekt dhe familjar sipas informacionit te bankave nr 2566/1-2566/10, dt 13/09/2022, 2566/11-2566/18 dt 23/09/2022, 2743-2743/18 dt 27/09/2022, 2759/5 dt 06/10/2022, 2759/8-2759/18 dt 28/10/2022,2759/11-2759/21 dt 02/11/2022,2759/22-2759/23 dt 03/11/2022, 2759/26-2759/28 dt 09/11/2022, 2759/29-2759/31 dt 14/11/2022, 2759/32-2759/33 dt 15/11/2022, 3205-3205/3 dt 15/11/2022, 3205/7-3205/25 dt 21/11/2022, 3374/2-3374/22 dt 13.12.2022,3458-3458/13 dt 13/12/2022,3458/15-3458/19 dt 19/12/2022, 3585/1-3585/7 dt 29/12/2022

D-Jane bërë listat elektronike te debitorve dhe per cdo taksa pagues ne territorin e bashkisë dhe është bërë njoftim me poste per te gjitha detyrimet (taksa+tarifa).

Ky rekomandim është zbatuar.

2.Gjetje nga auditimi: Rezulton se në territorin e Bashkisë Dimal dhe në Njësitë Administrative në vartësi, ushtrojnë aktivitetin 14 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, nga të cilat janë pajisur me autorizim 12 subjekte, nga të cilat 2 subjekte janë përpara periudhës objekt auditimi si dhe janë pajisur me licenca/autorizime të reja subjekti 12 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, kanë mbyllur aktivitetin e tyre 2 subjektet të cilat nuk ushtrojnë më aktivitetin në tregtimin me pakicë të hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre si dhe nuk janë licensure me leje tregtim karburanti, gjithsej 5 subjekte të cilët ushtrojnë aktivitet dhe papaguar detyrimin fiskal në vlerën 2,800,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Dimal si dhe në dy raste janë nënshkruar akt marrëveshje më subjektet për pagimin me këste të detyrimeve. Veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 35 të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4. e VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar si dhe kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15 të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pika 2.6, faqet 27-46, të Raportit të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policinë Bashkiake, Bashkia Dimal, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për pajisen me licenca të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe arkëtimin e tarifës së pataksuar prej 2,800,000 lekë ndajë 5 subjekteve, sipas pasqyrës Aneks nr. 6 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

2.2.Nga verifikimi rezultoi se:

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 2851/11 datë 06/10/2022 ka ngarkuar Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit. Deri në datën e verifikimit është bërë si më poshtë:

-Njoftim nr 393 prot datë 07/02/2022

- Rinjofitim nr 393/1 prot datë 23/11/2022
- Letër Kujtes nr 3317-3320 prot datë 23/11/2022
- Është dërguar leter kujtes me nr 2800/4-2800/5-2800/6 prot datë 29/12/2022
- Është kryer urdher bllokimi me nr 3081/12 prot datë 01/12/2022

Ky rekomandim është pjesërisht i zbatuar.

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Dimal në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Berat janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Berat. Konkretisht për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.12.2021, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 22,841,850 lekë për 826 persona, kanë paguar detyrimet 626 persona me vlerë 17,240,850 lekë dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2021 gjithsej 200 persona me vlerë 5,600,456 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Dimal. Gjithashtu nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Dimal për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Dimal të jetë drejtuar ASHK Dega Berat, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,,,”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë. (Më hollësisht trajtuar në pika 2.6, faqet 27-46, të Raportit të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 5,600,456 lekë ndaj 200 personave si dhe t’i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Berat vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 2851/12 datë 06/10/2022 ka ngarkuar Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit. Deri në datën e verifikimit është bërë si më poshtë:

-Pas rakordimit të të dhenave me Drejtorinë e Tatim Taksave rezulton se debitor deri me datë 31/12/2021, për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje janë 172 persona me vlerë 4,914,363 leke. Pas rakordimit nga drejtoria përgjegjëse është bërë dhe observacion me nr 1104/12 prot datë 10/06/2022.

-Jane bërë njoftime nga specialisti përgjegjës i legalizimeve për të gjithë debitoret me nr 1856-1856/1-1856/2-1856/3-1856/4 prot datë 29/06/2022, 1856/5 prot datë 26/08/2022, 2927 prot datë 14/10/2022.

-Jane bërë urdher bllokimet nga drejtoria e tatim taksave me nr 2261 prot datë 17/08/2022,3081/6 prot datë 10/11/2022.

Ky rekomandim është pjesërisht i zbatuar.

4.Gjetje nga auditimi: Për vitin 2020 – 2021 nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, janë mbajtur 62 procesverbale konstatimi, dhe në zbatim të tyre janë nxjerrë vendime me gjobë në vlerën 27.200.000 lekë vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për bashkinë Dimal. Sa më sipër rezulton se për të gjitha praktikantët IMT-ja, nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, në kundërshtim me: neni 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime; neni 15-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni), (Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3); - nenet, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 ”Për kundërvajtjet administrative”. (Më hollësisht trajtuar në pika 2.6, faqet 27-46, të Raportit të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojnë në Gjykatë të marrin masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar sipas aneksit nr. 7 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2.Nga verifikimi rezultoi se: : Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 2851/13 datë 06/10/2022 ka ngarkuar Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Drejtoria Juridike, në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit.

Deri në datën e verifikimit është bërë si më poshtë:

Nga ana e Drejtorisë Juridike, për gjobat e vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, në vlerën 27,200,000 për periudhën deri 31.12.2021, rezulton se janë paraqitur Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlore kërkesë për lëshim urdher ekzekutiv për 62 kundravajtës nga ku rezulton se :

a)Për 9 kundravajtës kanë kryer ekzekutim vullnetar të detyrimit si më poshtë :

Kundravajtësi Z. H. ka kryer ekzekutim vullnetar datë 13.08.2020, vlera 50000 lekë.

Kundravajtësi K. D. ka kryer ekzekutim vullnetar datë 27.07.2020, vlera 50000 lekë.

Kundravajtësi V. L. ka kryer ekzekutim vullnetar datë 11.01.2021, vlera 50 000 lekë.

Kundravajtësi F. S. ka kryer ekzekutim vullnetar datë 04.03.2021, vlera 300 000 lekë.

Kundravajtësi E.. sh.p.k ka kryer ekzekutim vullnetar datë 16.08.2021, vlera 50 000 lekë.

Kundravajtësi B. D. ka kryer ekzekutim vullnetar datë 07.04.2021, vlera 300 000 lekë.

Kundravajtësi G. B Sh.p.k ka kryer ekzekutim vullnetar datë 28.09.2021, vlera 100 000 lekë.

Kundravajtësi P..ka kryer ekzekutim vullnetar datë 03.11.2021, vlera 100 000 lekë.

Kundravajtësi K. J. ka kryer ekzekutim vullnetar datë 08.04.2022, vlera 50 000 lekë.

b) Për 8 kundravajtës me vendim të formës së Prerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është lëshuar titull ekzekutiv, për të cilat ju është dërguar shkresë Zyrës Përmbaremore Shtetërore, për të vijuar procedurën për ekzekutim të detyrueshëm të titullit ekzekutiv si më poshtë:

Kërkesë për ekzekutim të detyrueshëm shkresa nr. 2567, datë 12.08.2020, drejtuar Zyrës përmbaremore, për kundravajtësin I. G., për vlerën 500 000 lekë.

Kërkesë për ekzekutim të detyrueshëm shkresa nr. 272, datë 27.08.2021, drejtuar Zyrës përbarimore, për kundravajtësin M.D për vlerën 500,000 lekë.

Kërkesë për ekzekutim të detyrueshëm shkresa nr. 2751, datë 30.08.2021, drejtuar Zyrës përbarimore, për kundravajtësin A. H, për vlerën 500,000 lekë.

Kërkesë për ekzekutim të detyrueshëm shkresa nr. 2752, datë 30.08.2021 drejtuar Zyrës përbarimore, për kundravajtësin M.G , për vlerën 500,000 lekë.

Kërkesë për ekzekutim të detyrueshëm shkresa nr. 2718, datë 27.08.2021 drejtuar Zyrës përbarimore, për kundravajtësin L.X, për vlerën 500,000 lekë.

Kërkesë për ekzekutim të detyrueshëm shkresa nr. 2704, datë 26.08.2021, drejtuar Zyrës përbarimore, për kundravajtësin K.H, për vlerën 500,000 lekë.

Kërkesa për ekzekutim të detyrueshëm, drejtuar Zyrës Përbarimore, për kundravajtësin Fatos Vrapit, për vlerën 500,000 lekë.

Kërkesa për ekzekutim të detyrueshëm, drejtuar Zyrës Përbarimore, për kundravajtësin Llambi Nano, për vlerën 500 000 lekë.

c) Për 45 kundravajtës Viojnë të jenë në proces gjyqësor kundravajtësit si mëposhtë :

Në Proces Gjyqësor Nr.1714 datë 30.06.2020 për B.K

Në Proces Gjyqësor Nr.2393 datë 01.09.2020 për Q.H

Në Proces Gjyqësor Nr.2389 datë 01.09.2020 për G. H

Në Proces Gjyqësor Nr.2388 datë 01.09.2020 për B.C

Në Proces Gjyqësor Nr.2704 datë 26.08.2021 për X. S

Në Proces Gjyqësor Nr.2509 datë 10.09.2021 për N.C

Në Proces Gjyqësor Nr.629 datë 19.02.2021 për S. V

Në Proces Gjyqësor Nr.630 datë 19.02.2020 për V. C

Në Proces Gjyqësor Nr.607 datë 17.02.2021 për K. G

Në Proces Gjyqësor Nr.628 datë 19.02.2020 për M. C

Në Proces Gjyqësor Nr.627 datë 19.02.2020 për H. M

Në Proces Gjyqësor Nr. datë 07.04.2021 vendim nr: 299 për H. G

Në Proces Gjyqësor Nr 626 datë 19.02.2021 për T.H

Në Proces Gjyqësor Nr.448 datë 02.02.2021 për M.H

Në Proces Gjyqësor Nr.450 datë 02.02.2021 për A.Q

Në Proces Gjyqësor Nr. 449. datë 02.02.2021 për H.C

Në Proces Gjyqësor Nr.559/2 datë 27.01.2022 për A. B

Në Proces Gjyqësor Nr. 1299 datë 15.04.2021 për I.M

Në Proces Gjyqësor Nr.1295 datë 15.04.2021 për B.C

Në Proces Gjyqësor Nr.1296 datë 15.04.2021 për T.K

Në Proces Gjyqësor Nr.1297 datë 15.04.2021 për R.D

Në Proces Gjyqësor Nr.1300 datë 15.04.2021 për S.V

Në Proces Gjyqësor Nr.1442 datë 30.04.2021 për K.K

Në Proces Gjyqësor Nr.1443 datë 30.04.2021 për Z.H

Në Proces Gjyqësor Nr.1441 datë 30.04.2021 për F. V

Në Proces Gjyqësor Nr.1413 datë 26.04.2021 për I. V

Në Proces Gjyqësor Nr.1444 datë 30.04.2021 për A.H

Në Proces Gjyqësor Nr.1414 datë 26.04.2021 për S. V

Në Proces Gjyqësor Nr.1412 datë 26.04.2021 për L. Z

Në Proces Gjyqësor Nr.1881 datë 10.06.2021 për O.B

Në Proces Gjyqësor Nr.1882 datë 10.06.2021 për A.M

Në Proces Gjyqësor Nr.2181 datë 29.06.2021 për N. Gj.
 Në Proces Gjyqësor Nr.2339 datë 14.07.2021 për J. H.
 Në Proces Gjyqësor Nr.2340 datë 14.07.2021 për G. K.
 Në Proces Gjyqësor Nr.295 datë 16.08.2021 për D.G.
 Në Proces Gjyqësor Nr.2608 datë 17.08.2021 për M. H.
 Në Proces Gjyqësor Nr.2677 datë 24.08.2021 për A. M.
 Në Proces Gjyqësor Nr.2966 datë 13.09.2021 për R. S.
 Në Proces Gjyqësor Nr.2970 datë 13.09.2021 për D.V.
 Në Proces Gjyqësor Nr.3964 datë 06.12.2021 për V. D.
 Në Proces Gjyqësor Nr.3514 datë 02.11.2021 për S. N.
 Në Proces Gjyqësor Nr.3963 datë 06.12.2021 për M. H.
 Në Proces Gjyqësor Nr.356 datë 03.02.2022 për N. S.
 Në Proces Gjyqësor Nr.355 datë 03.02.2022 për J. V.
 Në Proces Gjyqësor Nr.2395 datë 01.09.2020 për Xh. V.

Ky rekomandim është në proces zbatimi.

D. MASA DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Dimal t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

1. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr. 2851/14 datë 06/10/2022 ka ngarkuar Sektori i Burimeve Njerëzore Drejtoria Juridike, në ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit. **Ky rekomandim është pa zbatuar.**

2.8 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

Në zbatim të drejtimit 8, të programit të auditimit nr. 121/1, datë 31.01.2023, u shqyrtua dokumentacioni i dosjes për dhënien e pasurisë me qira për periudhën 01.04.2020 deri më 31.12.2022 u konstatua se nga Bashkia Dimal është zhvilluar një procedurë konkurimi me objekt “Dhënie me qira të fondit pyjor” me të dhënat e mëposhtme:

Zhvillimi i Procedurës së konkurimit me objekt: “Dhënie me qira të fondit pyjor”	
1. Urdhër Konkurimi nr. 912 prot, datë 19.03.2021. nënshkruar nga z. L.B	3. Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave: Urdhër nr. 912/1, datë 19.03.2021 1 R.S (kryetar) 2 E. H (anëtar) 3.N.Ç (anëtar) 4. A.P (anëtar) 5. I.S (anëtar)
2. Lloji i Procedurës: Konkurim për pasuritë; 1. NR.1502, NR. 1503 dhe NR. 1504 ndodhur në Zonën Kadastrale nr. 3561 Dimal (Ura Vajgurore) 2.NR. 1/713 ndodhur në Zonën Kadastrale nr. 3682 Dimal me sipërfaqe totale 220,466 m ²	6. Afati i dhënies me qira i pasurisë: 10 vjet
4. Vlera dysheme për detyrimin e qirasë: 100,000 Lekë/Ha në një vit kalendarik dhe për sipërfaqe trungishte 45,000 lekë/Ha	7. Procesverbal për anulimin e procedurës së
5. Data e hapjes së konkurimit: 02.04.2021	

Ora 10. ⁰⁰	konkurrimit publik: Nr. 912/4 datë 19.03.2021
8 Data e rihapjes së konkurimit: 19.04.2021 Ora 10. ⁰⁰	9. Procesverbal për anulimin e procedurës së konkurrimit publik: Nr. 912/6 datë 19.04.2021
10. Data e rihapjes së konkurimit: 14.06.2021 Ora 10. ⁰⁰	7. Ofertat e Operatorëve Ekonomikë: - "S." shpk për 971,500 lekë/Ha
8. Ankimime AK, APP dhe KPP: Jo	9. Përgjigje ankesës: Jo
10. Data e lidhjes së kontratës: Nr. 912/13 prot., datë 02.11.2021	11. Afati i kontratës: 10 vjeçare

Titulli i gjetjes: Dhënie e fondit pyjor jo në përputhje me kuadrin ligjor.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes së dhënies me qira të fondit pyjor nga Bashkia Dimal, u konstatua se, me urdhrin nr. 912, datë 19.3.2021, të nënshkruar nga zj. L.B, në mungesë me porosi të titullarit të Bashkia Dimal zj. J.M, është krijuar grupi i punës për hartimin e dokumentave standarde të konkurrimin publik për dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore, me përbërje zj. G.H, zj. I.D e zj. G.H. Me urdhrin nr. 912/1, datë 19.03.2021, është krijuar komisioni i hapjesdhe vlerësimit të ofertave me përbërje zj. R.S, z.E.H, zj. N.C, z. A.P e z. I.S. Dhënia e këtyre pasurive është propozuar në Këshillin Bashkiak nga Kryetari i Bashkisë znj. J.M sipas Vendimit nr. 69, datë 02.12.2020 dhe relacionit, për pasuritë; Nr. 1/713 ZK 3682, vol. I fq. 145, Indeksi i hartës BR-D-7, me sipërfaqe totale 51,309 m2 në pronësi të Bashkisë Ura Vajguore, lëshuar nga ASHK Berat;

- Nr. 1502 ZK 3561 vol. 10, fq. 128, Indeksi i hartës K-34-112-(156-B), me sipërfaqe totale 115,345 m2 në pronësi të Bashkisë Ura Vajguore, lëshuar nga ASHK Kuçovë;

-Nr. 1503 ZK 3561 vol. 10, fq. 127, Indeksi i hartës K-34-112-(173-C), me sipërfaqe totale 36,069 m2 në pronësi të Bashkisë Ura Vajguore, lëshuar nga ASHK Kuçovë;

- Nr. 1504 ZK 3561, vol. 10, fq. 126, K-34-112-(173-C), me sipërfaqe totale 17,743 m2 në pronësi të Bashkisë Ura Vajguore, lëshuar nga ASHK Kuçovë.

Nga Bashkia është propozuar dhënia me qera e pasurive të sipërcituara sipas Vendimit të KB nr. 69, datë 02.12.2020 miratuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr.1079/2 datë 17.12.2020 të paluajtshme për qëllim;

1. Kryerjen e procedurave të konkurrimin publik dhe elementëve të tij, në mbështetje të Udhëzimit të Udhëzimit të Ministrit të mjedisit nr. 01, datë 09.06.2016 për "Rregullat e procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", si dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për administrimin e fondit pyjor.

2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e korrespondencës, plotësimin e dokumentacionit si dhe për kryerjen e procedurave të mëtejshme në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 01, datë 09.06.2016 ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Drejtoria Juridike.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se,me Vendim të KB nr. 69, datë 02.12.2020, është propozuar dhënia me qera e pasurive të sipërcituara, miratuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr.1079/2 datë 17.12.2020. Referuar certifikatave të pronësisë konstatohet se nuk janë përcaktuar kufitarët e pasurive në kundërshtim me nenet 17 dhe 26 të ligjit 111/2018 "Për Kadastrën". Gjithashtu miratimi për dhënien me qera të pasurive të sipërcituara është në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Dimal (Ura Vajguore) të miratuar me vendim të KKT nr. 3 datë 08.02.2017, për zonat ZU 10.1; ZU 10.2; ZU 10.9; ZB 2.17, të cilat bëjnë pjesë në zonën e propozuar për zhvillim.

Në njësitë ZU.10.1; 10.2; 10.9, përdorimi i lejuar i tokës është aktivitete sociale dhe rekreative (AR) dhe infrastruktura teknike IN. Nënkatëgoritë dhe funksionet e lejuara të tokës janë parqet, këndet e lojrave, sheshet, objektet e rekracionit dhe sportive në natyrë, vepra të burimeve të rinovueshme të energjisë, të furnizimit me ujë, të mbrojtjes kundër përmbytjes. Ndërsa në njësinë strukturore ZB.2.17, përdorimi mbizotërues është toka natyrore dhe përdorime të tjera të lejuara janë bujqësi dhe infrastruktura teknike. Në këtë njësi nuk lejohen ndërtimet. Duke shqyrtuar plan propozimin e pasqyruar në planin e biznesit bashkëlidhur kontratës, evidentohen mospërputhshmëri me PPV me Vendimin Nr. 3, në raport me tipologjinë e ndërtimit të lejuar sipas njësive përkatëse.

Me vendimin nr.45 datë 09.07.2021 të KB me 8 vota pro, 4 vota kundër dhe 2 vota abstenim, nga 21 anëtarë, është vendosur shprehja e dakordësisë dhe miratimi i heqjes nga fondi kullësor pyjor publik, për zhvillimin e aktivitetit të agroturizmit për sipërfaqen 17,4 ha, nga shoqëria S. ShPK.

Me shkresën nr. 487/2prot, datë 23.07.2021, të Prefektit të Qarkut Berat, është kthyer për shqyrtim vendimi i marrë më parë me nr. 45, datë 09.07.2021, të KB, i cili bie ndesh me nenin 54 gërma e, të ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në të cilën parashikohet që “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak” “miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve”, pasi nuk plotësohet kuorumi për miratimin e këtij vendimi dhe mungon dokumentacioni teknikoligjor me argumentimin përkatës përse kërkohet vijimi i procedurave për heqjen nga fondi pyjor/kullësor publik. Kjo pasi bie ndesh me nenin 55 pika 4, “Votimi”, në të cilën parashikohet që “Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkonjën e), të nenit 54 , të këtij ligji.

Me VKB nr. 55 datë 02.09.2021, me 15 vota pro nga 21 anëtarë, është dhënë dakordësia për vijimin e procedurave të Heqjes nga fondi pyjor/kullësor publik të sipërfaqe pyjore Bregu i pashijes dhe mali i Kozarës Për Zhvillimin e Aktivitetit Agroturizëm nga Shoqëria S. ShPK, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 614/1 datë 08.09.2021 dhe në datë 09.09.2021 ka dalë urdhër zbatimi i firmosur nga Sekretari i përgjithshëm. Znj R.S.

Me shkresën nr. 3034 prot datë 17.09.2021 i është dërguar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit me lënda “Dërgimi i Raportit Teknik dhe Dakortësisë sipas Vendimi të Këshillit Bashkiak Dimal për dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/ kullësor publik për Aktivitetin Agroturizëm nga shoqëria S. ShPK” duke vënë në djeni dhe shoqërinë S. ShPK.

Me shkresën nr. 6641/1 prot datë 12.10.2021 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit i ka kthyer përgjigje Bashkisë Dimal ku theksohet fakti se “Bazuar në Ligjin nr. 57/2020 “Për Pyjet” dhe VKM nr. 1353 datë 10.10.2008 “Për Rregullat dhe paraqitjen e kërkesës, mbajtja e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe vëllimit të fondit pyjor” të ndryshuar, kërkesa për heqjen nga fondi pyjor/kullësor duhet të paraqitet nga shoqëria “S.” ShPK”. në territorin e Bashkisë së cilës kryhet aktiviteti;

Me urdhër nr. 912 datë 19.03.2021 është ngritur grupi i punës për hartimin e dokumentave standarte të konkurimit publik për dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore i përbërë nga; 1. Znj G. H.; 2. Znj. I.D dhe 3. Znj. G.H i firmosur nga znj. L.B me detyrë Nënkryetare e Bashkisë.

Me urdhrin nr. 912/1 datë 19.03.2021 është krijuar komisioni për hapjen dhe Vlerësimin e Ofertave për shpalljen e konkurimit publik. Me procesverbalin nr. 912/2 janë hartuar dokumentet e konkurimit publik e cila nuk është publikuar në buletin e APP dhe me shkresën

nr. 912/4 datë 19.04.2021 është mbajtur procesverbali “ Për anulimin e procedurës së konkurrimit publik”.

Me shkresën nr. 912/5 datë 06.04.2021 është njoftuar në Buletin e APP dhe botuar në Buletin nr. 54, datë 12.04.2021, me këto të dhëna:

Sipërfaqja totale e tokës është 220,446 m² (22.4 ha), afati i dhënies me qira-9 vjet, duke filluar nga nënshkrimi i kontratës; Vlera dysheme për detyrimin e qirasë është 100,000 Lekë/Ha në një vit kalendarik dhe për sipërfaqe trungishte 45,000 lekë/Ha; data e konkurrimit është përcaktuar 19.04.2021

Vlerësimi i ofertave të konkurrentëve do të bëhet me pikë:

Nr	Lloji i kriterit	Pesha e matur në pikë e kriterit vlersues
1	Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1: 10 000 ku të bjenë evidentuar elementët kryesor si: Kufijt natyrorë, relivimi, objektet aktuale si dhe çdo planimetri tjetër në shkallën më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit.	20
2	Plan Biznesi dhe investimet që do të bëhen	15
3	Planin e rehabilitimit të sipërfaqes	15
4	Nivelin e punësimit në veprimtari	
5	Masën e qirasë lekë/ha/vit	35

Me shkresën nr. 912/6 datë 19.04.2021 është mbajtur procesverbali “ Për anulimin e procedurës së konkurimit publik”.

Me shkresën nr. 912/7 prot datë 02.06.2021 është rihapur procedura dhe është njoftuar në Buletin e APP dhe botuar në Buletin nr.88, datë 07.06.2021, me këto të dhëna:

Sipërfaqja totale e tokës është 178,400 m² (17.8 ha), afati i dhënies me qira-10 vjet, duke filluar nga nënshkrimi i kontratës; Vlera dysheme për detyrimin e qirasë është 100,000 Lekë/Ha në një vit kalendarik dhe për sipërfaqe trungishte 45,000 lekë/Ha; data e konkurrimit është përcaktuar 19.04.2021

Vlerësimi i ofertave të konkurrentëve do të bëhet me pikë:

Nr	Lloji i kriterit	Pesha e matur në pikë e kriterit vlerësues
1	Projekti teknik i përshtatjes së pronës ku përfshinë edhe a. Përshkrimi i llojit dhe shkallës së përshtatjes së pronës b. hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1: 10 000 ku të bëjnë evidentuar elementët kryesor si: Kufijt natyrorë, rilevimi, objektet aktuale si dhe çdo planimetri tjetër në shkallën më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit.	35
2	Plan Biznesi me përshkrimet për zonat e investimeve që parashikohen të kryhen.	15
3	Masa e Investimit	20
4	Plani i rehabilitimit të sipërfaqes	5
5	Niveli i punësimit në veprimtari	15
6	Masa e qirasë	10

Me shkresën nr. 912/8 datë 14.06.2021 shoqëria S. ShPK. ka shprehur interes për marrjen pjesë në procedura për dhënien në përdorim të fondit pyjor publikuar në buletin nr. 88 datë 07.06.2021 të APP.

Me shkresën e mbajtur me dorë dhe protokolluar me nr. 912/10 datë 24.06.2021 është mbajtur procesverbali i vlerësimit të ofertave ku është vlerësuar në total me 100 pikë nga 4 anëtarët e komisionit znj R.S z. E.H znj. N.C dhe z. I.S si dhe nuk ka firmosur procesverbalin e vlerësimit

të ofertave z. A.P si pjesë e komisionit miratuar me urdhërin nr. 912/1 prot., datë 19.03.2021. Me shkresën nr. 912/11 datë 01.07.2021 është njoftuar kryetarja e Bashkisë znj. J.M mbi shpalljen fitues të OE S. ShPK.

Me shkresën nr. 912/12 datë 07.02.2021 është mbajtur proces verbali për dhënien e dakortësisë për heqen nga fondi pyjor dhe kullësor dukë kërkuar dhe dakortësinë e KB. Procesverbali është i firmosur nga 4 antarët e komisionit.

Është lidhur kontrata për dhënien e fondit pyjor me nr. 912/13, datë 02.11.2021, të nënshkruar nga përfaqësuesi i Bashkia Dimal zj. R.S me detyrë Sekretar i Përgjithshëm me autorizim përkatës për lidhje kontrate nga titullari i Bashkisë, me nr. 3517prot, datë 02.11.2021 dhe përfaqësuesi i subjektit “S. SHPK”.

Kontrata e lidhur ndërmjet palëve, nënshkruar me datë 02.11.2021 dhe projekti i propozuar duhet të bazohet në Planin e Përgjithshëm Vendor me vendimin nr. 3, datë 08.02.2017. Duke qenë që se është miratuar Plani i Përgjithshëm Vendor, i ndryshuar, me Vendimin nr. 04, datë 14.12.2022, plani i vjetër nuk është më në fuqi. Për këtë arsye, kushtet e kontratës dhe plani i propozuar duhet të rishikohen në përputhje me PPV e 2022.

Në bazë të PPV të miratuar me Vendimin nr. 04, datë 14.12.2022, parcela në të cilën do të zhvillohet projekti, i përket njësive strukturore të rishikuar sipas PPV të ndryshuar, si më poshtë: ZU.10.1; ZU.10.2; ZU.18/1; ZU.18/2. Njësitë strukturore ZU 10.1 dhe ZU 10.2 i përkasin sistemit UB_Urban dhe kategoria e lejuar është “AR.5.Parqe, kënde lojërash, sheshe, objekte rekreacioni dhe sportive në natyrë, IN.4 Vepra të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë, të furnizimit me ujë, të mbrojtjes kundër përmbytjeve”. Ndërsa njësitë strukturore ZU.18/1 dhe ZU.18/2, i përkasin kategorisë së lejuar AR.1, hotele deri në 100 shtretër, teatro-kinema, ndërtesa shfaqjes, ndërtesa dhe ambiente sportive, hapësira të gjelbra, IN.4, vepra të burimeve të rinovueshme të energjisë të furnizimit me ujë, të mbrojtjes kundër përmbytjeve. Në projektin e pasqyruar nga sipërmarrësi, në planimetrinë e përgjithshme në të cilën përcaktohet zonimi funksional, evidentohet se parashikohen të realizohen ndërtime në funksion të bujqësisë me destinacione si; stalla për bagëti, stallë për kuaj, baxho, kantinë vere etj., funksione të cilat kërkojnë respektimin e kriterëve e parametrave të veçanta dhe nuk bëjnë pjesë në tipologjinë e lejuar sipas PPV në zonat ZU 10.1 dhe në ZU 10.2. Gjithashtu duhet të verifikohet statusi i resursit të tokës, në përputhje me PPV dhe tarifat e rishikuara sipas statusit të tokës në truall, bazuar në vendimin nr. 440, datë 03.06.2020, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 480, datë 27.06.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”, pika 5, kreu VII/1, “Kalimi i tokave të resurseve të ndryshme në kategorinë e resursit tokë urbane, truall sipas planeve të detajuara dhe planeve të përgjithshme vendore”.

Dhe sa më sipër trajtuar, në bazë të Ligjit Nr.57/2020, “Për pyjet”, Neni25, pika 3, Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat përfundojnë në çastin kur KKT-ja miraton tjetër zhvillim për sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar, objekt kontrate. Rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për këto veprimtari caktohen me udhëzim të ministrit.”, Bashkia Dimal duhet të rishikojë kushtet e kontratës dhe projekti i propozuar në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor, dhe legjislacionin e sipërpërmendur në fuqi. *Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi titullari i Bashkisë Dimal zj. J.Mj, zj. L.B, zj. R.S, zj. G. H., zj. I.D, zj. G.H dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak.*

Kriteri: Ligjit Nr.57/2020, “Për pyjet”, Neni25, pika 3, Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar”, Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin

dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 12, pika c, neni 13, neni 20, Plani i Përgjithshëm Vendor miratuar me vendim të KKT nr. 3 datë 08.02.2017, i ndryshuar. Plani i Përgjithshëm Vendor miratuar me Vendimin nr. 04, datë 14.12.2022, Udhëzimi nr. 1, datë 16.03.2017, “Për mënyrën dhe procedurat e zbatimit të planeve të përgjithshme vendore”, i ndryshuar, pika 5.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ financiar për buxhetin e Bashkia Dimal.

Shkaku: Mos respektim i kuadrit ligjor për Planifikimin e e Zhvillimit të Territorit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Këshilli Bashkiak, Kryetari i Bashkisë Dimal, të marrë masat e duhura që, të rishikojnë të gjithë procesin e dhënies me qira të fondit pyjor dhe kontratën e nënshkruar, të rishqyrtojnë projektin e paraqitur nga subjekti “S. ShPK” si kontraktues për dhënien e fondit pyjor, sipas kushteve dhe tarifave të miratuara, për resursin e tokës, me qëllim arkëtimin e të ardhurave në përputhje me këto tarifa, përshtatjen e tipologjisë së ndërtimit në zonat me aktivitete sociale dhe rekreative, sipas PPV të miratuar me vendimin të KKT nr. 04, datë 14.12.2022 dhe Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i pesë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, u konstatua se; referuar Strukturës dhe Organigramës së Bashkisë Dimal në Rregulloren e saj, në disa raste ka mbivendosje dhe mbingarkesë kompetencash. Në bazë të pyetësorit dërguar njësive të menaxhimit, nuk ka një urdhër nga titullari i institucionit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi. Nuk ka raporte periodike mbi zhvillimin e aktiviteteve të kontrollit sipas afateve të përcaktuar në Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit. Bashkia Dimal nuk ka një plan trajnimesh të brendshme, për rrjedhojë as një buxhet trajnimesh për punonjësit e shërbimit civil apo punonjësit marrëdhëniet me të cilët rregullohen me anë të Kodit të Punës. Bashkia Dimal nuk ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik. Bashkia Dimal nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim. Në Bashkinë Dimal nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut. Vendosija e znj. M.B me detyrë shef finance dhe nëpunës zbatues i Bashkia Dimal, si kryetari i Njesisë së Prokurimit, është jo në përputhje me kuadrin ligjor rregullator të nëpunësit zbatues. Bashkia Dimal nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Bashkia Dimal nuk ka hartuar dhe miratuar hartat e procesit të punës. Bashkia Dimal nuk ka miratuar gjurmën e auditimit. Nuk janë përditësuar raportet periodike apo publikimet vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin prokurimeve, raporte të auditimit, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale. *Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 9 - 30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Dimal të hartojë një plan trajnimesh për punonjësit e këtij institucioni.

Të hartohet dhe miratohet Plani Strategjik i institucionit. Të hartohet dhe miratohet strategjia e menaxhimit të riskut.

Të miratohet Gjurma e Auditimit për institucionin. Sektorët dhe Drejtoritë që janë ngarkuar me zbatimin e aktiviteteve të cituara në Plan e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, duhet të hartojnë në mënyrë periodike raporte drejtuar titullarit, ku të përshkruhet ecuria e zbatimit.

Menjëherë dhe në vijim

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë dhe përbërjes së Sektorit të Auditit të Brendshëm, u konstatua se; nuk është ngritur Komiteti i Auditimit. Niveli profesional i punonjësve në Sektorin e Auditit të Brendshëm nuk është në standardin e përcaktuar nga ligji.

Ka shmangie nga Plani Vjetor i miratuar nga titullari i institucionit, si dhe nuk është miratuar apo dokumentuar ndryshimi i Planit në Raportin Vjetor referuar Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore. Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit. Në dosjet e auditimit të realizuar nga Njësia e Auditimit nuk është dokumentuar plani i veprimit. Nga shqyrtimi i një prej dosjeve të auditimit të përzgjedhura, u konstatua mungesa e një sërë

dokumentesh, të cilat parashikohen nga Manuali i Auditimit të Brendshëm. *Veprime jo në përputhje Ligjin nr. 114 dt. 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 11, 14. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 1, faqe 9 - 30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: -Titullari i institucionit të miratojë Komitetin e Auditimit të Brendshëm në përputhje me ligjin dhe të certifikohen dy punonjësit e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, sipas kërkesave të Ligjit për Auditimin e Brendshëm.

- Dosjet e auditimit të arkivohen sipas përcaktimeve të legjisllacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijim

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Dimal ka diferenca me vlerën e planifikuar. Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën 335,674,180 lekë, ndërsa realizimi në vlerën 319,520,908 lekë, ose në masën 95,16%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 212,517 mijë lekë, realizuar 157,618 mijë lekë, ose në masën 74,16 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Dimal në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifata vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2006 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 32, 65; UMF Nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar pika 101; ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, neni 46. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2, faqe 30-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Bashkia Dimal, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore. Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2021, të llogarisë(401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën në vlerën 266,150,796 lekë. Bashkia Dimal në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 101,357,088 lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta, dhe Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti 32,151,954 lekë nga investimet e FZHR-së, vlera 101,357,088 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 91,926,520 lekë, ose 90,69% e vlerës së planifikuar, diferenca prej 9,430,568 lekë e pa likuiduar gjatë vitit 2022. Por gjatë vitit 2022 janë marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 137,394,223 lekë, duke e çuar në 31.12.2022 vlerën e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta në 146,824,791lekë. Peshën kryesore të detyrimeve e zënë ato për investime në vlerën 122,634,948 lekë, ose në masën 83% të detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta bashkisë.Pra, në datën 31.12.2022 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar

me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022) është rritur me 45,467,703 lekë, ose në masën prej 44%.

Përveç sa më lartë më 31.12.2022 Bashkia Dimal ka krijuar detyrime të tjera të reja gjatë vitit 2022, me burim financimi nga granti (FZHR), të cilat janë detyrime për dy ujësjellës, në vlerën 119,326,005 lekë, duke çuar vlerën totale të detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022 në 266,150,796 lekë. Peshën kryesore të detyrimeve totale (së bashku me detyrimet e FZHR) e zënë ato për investime në vlerën 223,961,553lekë, ose në masën 84% të totalit prej 266,150,796 lekë. Në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 61 dhe neni 54, “Kryerja e pagesave”, Ligjin nr. 25 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15 pika 1 dhe nenin 11 pika 1, Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pikën 164. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2, faqe 30-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Bashkia Dimal të marrë masa për hartimin sa më real të buxhetit, mbështetur në realizimin sa më objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve duke pasuur parasysh shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë dhe në vijim

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes së dhënies me qira të fondit pyjor nga Bashkia Dimal, u konstatua se, Është lidhur kontrata me nr. 912/13, datë 02.11.2021, me objekt “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor”, me afat 10 vjet dhe me vlerën 971,500 lekë/vit, ndërmjet Bashkia Dimal përfaqësuar nga znj. J.M në cilësinë e Qiradhënësit dhe zhvillues subjektin “S. ShPK” në cilësinë e Qiramarrësit. Kontrata e lidhur është bërë pas miratimit të Këshillit Bashkiak i cili me vendimin nr. 55 datë 02.09.2021, me 15 vota pro nga 21 anëtarë, është dhënë dakortësia për vijimin e procedurave të Heqjes nga fondi pyjor/kullor publik të sipërfaqe pyjore Bregu i pashijes dhe mali i Kozarës Për Zhvillimin e Aktivitetit Agroturizëm nga Shoqëria S. ShPK, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 614/1 datë 08.09.2021. Miratimi i dhënies së fondit pyjor nga Këshilli Bashkiak dhe kontrata e lidhur është dhënë jo në përputhje me kondicionet urbane sipas PPV në fuqi, në kohën e miratimit të kontratës, pasi në njësitë strukturore në të cilën është kërkuar të zhvillohet projekti i propozuar nuk lejohen ndërtimet e tipologjive të propozuara. Gjithashtu ndryshimi i zhvillimit të njërive të miratuar me PPV e re të vitit 2022, sjell edhe ndryshimin e statusit të resursit të tokës. Si rezultat i ndryshimeve nevojitet rishikimi i kushteve të kontratës të lidhur përpara miratimit të PPV dhe tarifave përkatëse të tokës në të cilën do të zhvillohet projekti. Veprime jo në përputhje me Ligjin nr.57/2020, “Për pyjet”, Neni25, pika 3, Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 12, pika c, neni 13, neni 20, Plani i Përgjithshëm Vendor miratuar me vendim të KKT nr. 3 datë 08.02.2017, i ndryshuar. Plani i Përgjithshëm Vendor miratuar me Vendimin nr. 04, datë 14.12.2022, Udhëzimi nr. 1, datë 16.03.2017, “Për mënyrën dhe procedurat e zbatimit të planeve të përgjithshme vendore”, i ndryshuar, pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 8, faqe 156-161, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandim: Këshilli Bashkiak, Kryetari i Bashkisë Dimal, të marrë masat e duhura që, të rishikojnë të gjithë procesin e dhënies me qira të fondit pyjor dhe kontratën e nënshkruar, të rishqyrtojnë projektin e paraqitur nga subjekti “S.” ShPK si kontraktues për dhënien e fondit pyjor, sipas kushteve dhe tarifave të miratuara, për resursin e tokës, me qëllim arkëtimin e të

ardhurave në përputhje me këto tarifa, përshtatjen e tipologjisë së ndërtimit në zonat me aktivitete sociale dhe rekreative, sipas PPV të miratuar me vendimin të KKT nr. 04, datë 14.12.2022 dhe Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit u konstatua se; në 5 (pesë) procedura prokurimi, nga Autoriteti Kontraktor janë vendosur kritere e kërkesa të veçanta si licenca, akte ekspertiza ligjore etj., si dhe specifitime teknike të cilat nuk janë sqaruar në mënyrë teknike dhe ligjore për lidhjen e ngushtë me objektin e prokurimit dhe natyrën e kontratave.

Vendosja e kriterëve kufizuese dhe të pa argumentuara sjellin për pasojë diskriminim dhe trajtimin e pabarabartë të ofertuesve në procedurat e prokurimit publik. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik, Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, Kreu V, neni 21, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu X, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 12, pika 2/a, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 45/1 pika 2, neni 59, pika 2. (Mëhollësisht trajtuarnë pikën 4, faqe 54-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Dimal, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifitimeve teknike, të lidhura me objektin e prokurimit dhe natyrën e kontratave, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

Menjëherë dhe në vijim

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës së furnizimit me karburant konstatohet se nuk është hartuar raport për monitorimin e zbatimit të kontratës, për t’u siguruar se cilësia e mallrave të furnizuara ka qënë ose jo në përputhje me cilësinë për të cilën OE kontraktues është shpallur fitues i kësaj procedure, dhe nuk është raportuar në APP për zbatimin e kontratës. Veprim jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77, pika 3, pika 4, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 43. (Mëhollësisht trajtuarnë pikën 4, faqe 54-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Dimal, në zbatimin e kontratave të furnizimit të marrë masat për të hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të kontratës, për t’u siguruar se cilësia e mallrave të furnizuara ka qënë ose jo në përputhje me cilësinë për të cilën OE kontraktues janë shpallur fitues.

Menjëherë dhe në vijim

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, Bashkia Dimal nuk ka dërguar raport brenda 6-muajve për realizimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna. Gjithashtu rezultoi se Bashkia Dimal nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto jo në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 137-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandim: Bashkia Dimal të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi. Gjithashtu të raportohet në auditimet në vijim brenda afatit të përcaktuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Bashkia Dimal nuk ka marrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm e konkretisht:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 16 masa organizative janë pranuar 16 masa nga të cilat janë realizuar 3 masa, janë në proces 3 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe nuk janë zbatuar 7 masa.

b. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike-të ardhura të munguara janë rekomanduar 4 masa nga të cilat, janë pranuar për zbatim 4 masa, janë zbatuar 1 masë, janë në proces zbatimi 2 masa, dhe është 1 masë pjesërisht e realizuar.

c. Në lidhje me masat disiplinore në kompetencë të Bashkisë Dimal, për punonjësit e saj konstatohet se nga ana e Bashkia Dimal nuk janë marrë masat e duhura për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e konstatuar me shkelje dhe me përgjegjësi në Raportin e auditimit të mëparshëm. Veprime këto jo në përputhje me Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa j), ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7,faqe137-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dimal të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përsheptuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara dhe pjesërisht të zbatuara si më poshtë:

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dimal dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dimal të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dimal në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Dimal t me specialit të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.1.Rekomandimi; Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Dimal, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga Agjentët Tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për penalizmin e Agjentëve Tatimore me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.2.Rekomandimi; Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifin apo taksat të cilat mbledhen nga Agjentët Tatimore, të kryqëzojë informacionet me institucionin e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemit në kontabilitet të llogarisë 4342 Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” Veprimet sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022.

Në mbyllje te pasqyrave financiare 2022

11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë (202) “Studime dhe kërkime”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e kostos totale të objektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Dimal në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për të kryer procedurat ligjore të rivlerësimit të 76 prona të certifikuara në ASHK, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Dimal më 31.12.2022, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale historike (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje/ulje rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse(21) “Aktive afatgjata materiale” e llog.(109) “Diferenca nga rivlerësimi”.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dimal të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën Nr. 241/44 datë 13/04/2021, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre, konkretisht:

a-Për 3 masa organizative të cilat janë në proces si dhe për 5 masa organizative të pa zbatuar

b-Për 6 masa shpërbllim dëmi në vlerë 41,735,450 lekë.

Menjëherë

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policinë Bashkiake, Bashkia Dimal, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për pajisjen me licenca të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe

derivatet e tyre dhe arkëtimin e tarifës së pataksuar prej 2,800,000 lekë ndajë 5 subjekteve, sipas pasqyrës Aneks nr. 6 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli në sistemin e-leje për lejet e ndërtimit rezulton se: Leja me nr. prot 2105 datë 11.09.2020 me zhvillues D.B me objekt Magazinë dhe dy stalla për rritjen e shpendëve me adresë Ura Vajguore nuk është marrë miratim nga TAP-i bazuar mbi sugjerimin që i është dhënë nga përgjigja e shkresës së AZHT, nr.437 dhe leje ndërtimi: Magazine bujqësore 1 kat ne Drenovicë, Ura Vajguore adresa e realizimit të punimeve: Ura Vajguore Fshati Drenovicë nuk është marrë mendim nga institucionet si AKM, AZHT. Me nr. 2977/1, datë 24/09/2021 dhe leje ndërtimi nr. 3360/1, datë 10/11/2021, për magazine shërbimi 1 kat " adresa e realizimit të punimeve: Kutalli, Dimal bazuar mbi përgjigjen e kthyer nga ana e ARRSH-së ku citohet se duhet të respektojë distancat nga kufiri rrugor si dhe të aksesit të bëhet në rrugët e brendshme dhe jo në aksin kombëtar Berat-Fier. Me nr. prot 1514 dhe leje zhvillimi 3827/1 datë 13.12.2021 bazuar mbi kthimin e përgjigjes nga ana e ARRSH-së ku në atë aks ka projekt zhvillimi nga ana e FSHZH dhe DPZHTK e bashkisë Dimal të marrë masa për të bërë ballafaqimin nëse kjo leje e miratuar prek ose jo projektin e zhvillimit që do realizojë FSHZH. Veprime jo në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 neni 15 pika ë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 6, faqe 133-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1.Rekomandime: Nga DPKZHT Dimal të merren masa për të marrë konformitetin nga institucionet e përfshira dhe ti respektojë rekomandimet e tyre.

Menjëherë dhe në vijim

11. Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli në sistemin e-leje për certifikatën e përdorimit me të dhënat: “Banese 1kat mbuluar me çati, me bodrum në fshatin Donofrose, Njësia Administrative Cukalat, Bashkia Dimal, paraqitur nga zhvilluesi F.S.. me nr. prot 1553 Certifikatë përdorimi rezulton se nuk përputhet realizimi në terren i objektit bazuar mbi imazhet e ngarkuara në sistemin e-leje krahasuar me projektin e miratuar. *Veprime jo në përputhje me me VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 6, faqe 133-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1.Rekomandime: Nga DPKZHT Dimal të merren masa për të respektuar me përpikmëri zbatimin e projektit të miratuar.

Menjëherë dhe në vijim

12. Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli i inspektoratit të mbrojtjes së territorit bashkia Dimal u konstatua se arsimimi i kryeinspektorit nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Si rezultat i kësaj, në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së IMTV rezultoi se në 10 raste nuk është mbajtur vlera e gjobës sipas kuadrit ligjor në fuqi. Veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, nenin 11 dhe nenin 52. Gjithashtu nga kontrolli i inspektoratit të mbrojtjes së territorit u konstatua se në 58 raste është konstatuar se janë mbajtur proces-verbal kundërvajtje por nuk kanë dalë me vendime gjobe, në 94 raste është mbajtur proces-verbal kundërvajtje është mbajtur dhe vendim me gjobë por nuk është mbajtur vendim prishje. Veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, neni 4 dhe në nenin 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 7, faqe 137-162, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1.Rekomandime: Nga ana e kryetarit të bashkisë Dimal të merren masa për të emëruar në krye të këtij Inspektoriatit punonjës me arsim të duhur sipas kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu nga IMTV të merren masat e duhura për rastet e konstatuara me shkelje të vendosën kundërvajtjet administrative përkatëse.

Menjëherë dhe në vijim

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës Sheq-Gajdë”, me fond limit në shumën 60,391,938 lekë, në fazën e vlerësimit të ofertave u konstatua se: Në këtë procedurë kanë marrë pjesë dy BOE, e konkretisht BOE “L.. ShPK & V.. K.. ShPK & E..-A.. ShPK” me vlerë oferte në shumën 37,414,293 lekë dhe BOE K...ShPK & F... ShPK”, me vlerë oferte në shumën 57,305,850 lekë. Nga procesi i vlerësimit të KVO rezulton se të dy BOE pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e AK por një prej tyre ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët. Grupi i auditimi pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi dhe komisioni i ngritur, arrin në përfundimin se s’kualifikimi i “L... ShPK & V... K.. ShPK & E...-A.. ShPK”, është i padrejtë dhe se dokumentacioni i paraqitur justifikon vlerën e ofertës së dhënë për shkak se një pjesë e zërave të preventivit gjenden pranë zonës së Bashkia Dimal me çmime/kosto më të ulët dhe të favorshme nga manuali i çmimeve të punimeve të ndërtimit. Gjithashtu BOE ka paraqitur dëshmi se plotëson kërkesat e cilësisë së AK dhe dokumentacionin e kërkuar për të cilat ka deklaruar se merr përsipër kryerjen e punimeve sipas të gjitha kushteve të kërkuara nga Bashkia Dimal sikurse ka paraqitur dhe dokumentacionin shtesë për të justifikuar dhe dhënien e ofertës, pavarësisht se ka qenë anomalisht e ulët. Nëse do të kualifikohej BOE “L... ShPK & V... K..... ShPK & E...-A...ShPK”, Bashkia Dimal do të kryente këtë procedurë me një vlerë 19,891,557 lekë më pak. Pra **shuma prej 19,891,557 lekë pa TVSh përbën efekt financiar negativ** për buxhetin e Bashkia Dimal. *Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 2, nenin 93, pika 2. (Mëhollësisht trajtuarnë pikën nr. 4, faqe 54-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1.Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Dimal, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, të marrë masat e duhura që, të mbajë në konsideratë të parimet e prokurimit publik, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, me qëllim përdorimin e fondeve me ekonomikitet, efikasitet dhe efikasitet.

Menjëherë dhe në vijim

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “**Rrjeti jashtëm dhe brendshëm, njësia administrative Cukalat, Bashkia Ura Vajgurore**”, me fond limit në shumën 201,420,870 lekë pa TVSh dhe me vlerë kontrate në shumën 200,412,476 lekë pa tvsh, me BOE fitues “S. ShPK dhe G. C.ShPK”. Bashkia Dimal, nëpërmjet Komisionit të vlerësimit të ofertave, në të cilën, nga 3 OE pjesëmarrës, ka s’kualifikuar 2 OE për mosplotësim të kriterëve të kërkuara dhe ka kualifikuar 1 OE. Nga verifikimi i dokumentacionit të BOE të kualifikuar dhe shpallur fitues, rezulton se, BOE i kualifikuar nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara nga AK, pra në këtë rast tenderi duhej të anulohet. Mos anulimi i procedurës së prokurimit ka çuar në kualifikim dhe shpallje fitues të OE i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, duke sjellë si rezultat lidhjen e kontratës në kushtet e paligjshmërisë të procedurës së prokurimit publik në **vlerën 238,203,283 lekë** me TVSH.Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, neni 46, neni 53, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 66, pika 3, VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Vendim nr. 664, datë 26.9.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave ‘Për informatizimin e llogaritjes së

kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10, pika 11. (Mëhollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 54-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1.Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimeve në Bashkia Dimal, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, të marrë masat e duhura që, të mbajë në konsideratë të gjitha aktet ligjore në vlerësimin e OE pjesëmarrës në kushtet kur ata plotësojnë të gjitha kërkesat e vendosura nga AK.

Menjëherë dhe në vijim

MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Rikonstruksion i rrjeteve shpërndarës të ujësjellësit në bashkinë Ura Vajgurore”**, me kontratë nr.2515/5 Prot, datë 16.10.2020, me vlerë kontrate në shumën 71,774,494 lekë me TVSH, me sipërmarrës S.ShPK, referuar preventivit të punimeve, në lidhje me zëri Shtresë çakelli t=20 cm.u konstatua se; Nga vëzhgimi në terren i mbulimit të tubacioneve të dërgimit nga st. pompave në depo nuk u konstatua që këto tubacione të mbulohen me çakëll 20cm derisa shtresa e çakllit është e fundit dhe do të ishte e dukshme nëse do ishte vendosur. Janë situacionuar 2209 m2 shtresë çakëlli t=20 cm me vlerë 618,547 lekë. Veprime jo në përputhje me Ligji 8402 date 10.9.1998 **“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”** neni 7, si dhe kontrata Nr. 2515/5 Prot, datë 16.10.2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 4, faqe 54-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandim: Nga ana e bashkisë Dimal të merren masa për të arkëtuar shumën prej **618,547lekë** vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Rikonstruksioni i qendër komunitare Llambi Mile, Bashkia Ura Vajgurore”** Vlera e kontratës 40,608,800 lekë pa TVSH sipërmarrësit BOE M. ShPK dhe N. 2. ShPK me kontratë nr.3086/10 Prot, datë 17.12.2020 u konstatua se: Zëri 2.267/1 Shtresë me pllaka porcelani importi është situacionuar 572 m2.Sipërfaqja reale e matur nga jashtë në terren rezulton të jetë 526 m2. Duke zbritur dhe muret e jashtëm dhe të brendshëm llogaritur dhe lartësinë e plinteve rezulton se duhet ti zbresim 33 m2 sipërfaqe. Në total janë 526 m2-33m2=493 m2 sipërfaqe e shtruar me pllaka porcelani importi.573-492=79 x 2753 lekë/m2=217,487 lekë.

-Instalimet telefon/internet: Nga kontrolli në terren nuk u konstatuan këto instalime me vlerë në total për gjithë nen zërat e kësaj rubrike janë në vlerë 55,350 lekë.

-Enë zgjerimi të kaldajës copë 2 me vlerë 82,800 lekë nuk janë konstatuar nga ana e grupit të auditimit si dhe nga ana e mbikëqyrësit. Vlera totale prej **355,637 lekë** përbën dëm ekonomik si pasojë e punimeve të parrealizuara dhe situacionimit të volumeve më shumë se gjendja faktike në terren. Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 8402 date 10.9.1998 **“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”** neni 7 si dhe Kontrata nr. prot.38/7 datë 23.12.2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 4, faqe 54-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandim:Nga ana e bashkisë Dimal të merren masa për të arkëtuar shumën prej **355,637 lekë** vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *Ndërtim kopshtesh në lagjen 28 nëntori Ura Vajgurore, Syzes dhe lagje 4 shtatori* Vlera e kontratës 21,609,579 lekë me TVSH sipërmarrësit F.ShPK me kontratë nr.1576/13 Prot, datë 16.10.2020 është konstatuar se : Zëri i punës F.V dritare druri dopio xham 12.6 m² dhe F.V dyer druri me dy çarje vertikale me xham 6.2 m².Nga matjet në terren rezulton se sipërfaqja e dritareve është 14.3m².Diferenca 18.8m²-14.3 m²=4.5 m² x 12000 lekë/m²=**54,000 lekë**. *Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 8402 date 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” neni 7, si dhe Kontrata me nr, prot 36/7 datë 30.10.2020. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 4, faqe 54-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandim: Nga ana e bashkisë Dimal të merren masa për të arkëtuar shumën prej **54,000 lekë** vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit e-leje për lejet e miratuara nga ana e DPZH TK Bashkia Dimal u konstatua se për lejen e ndërtimit njësi shërbimi adresa e realizimit të punimeve: Kutalli, Dimal me nr. prot 1514 dhe leje zhvillimi 3827/1 datë 13.12.2021 taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur saktë dhe ka një diferencë **prej 286,149 lekë shumë e cila përbën të ardhur të munguar** për buxhetin e Bashkisë Dimal, si dhe për lejen nr. 2471/2, datë 24/08/2021 fabrikë për përpunimin e vajit të ullirit, bashkia ura vajgurore taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur saktë dhe ka një diferencë prej **110,373 lekë shumë e cila përbën të ardhur të munguar** për buxhetin e Bashkisë Dimal. *Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 46, si dhe me Vendimin e KB nr. 80 datë 24.12.2021 “Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore për bashkinë Dimal dhe njësitë administrative”. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 4, faqe 54-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandim: Nga ana e DPZH TK bashkia Dimal të merren masa për të arkëtuar shumat prej 286,149 lekë dhe 110,373 lekë shuma të cilat përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë si dhe të merren masa për të llogaritur në mënyrën e saktë taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli i dosjes teknike dhe vëzhgimit në terren për objektin *“Rrjeti i jashtëm dhe brendshëm njësia administrative Cukalat, bashkia Ura Vajgurore,”* Vlera e kontratës 238,203,283 lekë me TVSH sipërmarrësit BOE S.ShPK me dhe G.C.kontratë nr.2199/12 Prot u konstatua se: Nga auditimi dhe kontrolli në terren i ujësjellësit të njësisë administrative Cukalat u konstatua se rrethimet e depove Bistrovicë, Cukalat dhe Hallambrez nuk janë rrethuar me rrjetë teli me gjemba si në situacion por me rrjetë teli normale konkretisht zëri: 3.837 Rrethim me tela me gjemba janë situacionuar 250 m² me vlerë 450,288 lekë në depo Allambrez, 250 m² me vlerë 450,288 lekë në depo Bistrovicë, 250 m² me vlerë 450,288 lekë, 280 m² me vlerë 505,620 lekë në depon Cukalat. Në total **1,406,196 lekë vlerë që përbën dëm ekonomik**. *Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” neni 7, me Ligjin nr. 10297, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2, neni 8. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 4, faqe 54-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandim: Nga ana e bashkisë Dimal të merren masa për të arkëtuar shumën prej **1,406,196 lekë** nga operatori ekonomik BOE “S. ShPK dhe G... C...” vlerë që përfaqëson dëm

ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e ndryshimit të zërave të të punimeve të situacionuara nga ato të konstatuara në terren.

Menjëherë dhe në vijimësi

MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1.Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli i dosjes teknike dhe vëzhgimit në terren për objektin “*Rikonstruksioni i rrugëve me rërë bituminoze i fshatrave të bashkisë,*” Vlera e kontratës 39,918,096 lekë pa TVSH sipërmarrësit BOE T.ShPK dhe M.ShPK me kontratë nr.236/21 Nga kontrolli në terren i këtyre rrugëve të cilat janë të shpërndara nëpër fshatra të ndryshëm të kësaj bashkie u konstatua se rrugët në shumë pjesë të tyre kishin dëmtime të mëdha si gropa apo rrëshqitje të shtresave rrugore madje në disa pjesë rëra bituminoze kishte degraduar.

Projekti i kësaj rruge nuk është eficient dhe efektiv pasi kjo metodë projektimi nuk garanton jetëgjatësi të objektit të ndërtuar. Një rikonstruksion rruge nuk mund të jetë jetëgjatë kur në të ndodhen vetëm 2 shtresa konkretisht stabilizant 10 cm dhe rërë bituminoze 10 cm. Lidhja mes këtyre dy shtresave nuk realizohet sipas kushteve teknike gjithashtu dhe vetë shtresa e rërës bituminoze nuk është zgjidhje e duhur marrë parasysh që këto rruge nuk kanë kanale për kullimin e ujërave. Prania e ujërave mbi sipërfaqen e rrugës për një kohë të gjatë ndikon në degradimin e rrugës për një afat kohor të shkurtër. Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se vlera e këtij investimi në shumën 39,918,096 lekë pa TVSH dhe **47,901,715 lekë me TVSh është shpenzim pa efektivitet për buxhetin e Bashkia Dimal.** Veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 10297, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2, neni 8. (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 4, faqe 54-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandim: Nga ana e bashkisë Dimal konkretisht zyrës së urbanistikës dhe kryetarit të bashkisë të merren masa për të hartuar dhe miratuar projekte me eficientë dhe efektivitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultuan të ardhura të munguara progresive 2016-2022, për buxhetin e bashkisë Dimal në vlerën totale 317,757,340 lekë. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave të familjarëve në vlerën 199,755,053 lekë. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit në vlerën 69,920,905 lekë Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 3,822,253 lekë. Të ardhura të munguara nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre në vlerën 2,600,000 lekë. Të ardhura të munguara nga mospagimi i gjobave të vendosura nga IMT-ja në vlerën progresive 33,124,950 lekë. Ka mangësi në rastet e ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI “*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*”, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar . (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2, faqe 30-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandimi:

a) Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Dimal, të marrë masa ligjore ndaj subjekteve debitorë me qëllim mbledhjen e detyrimeve të prapambetura dhe të zbatojë procedurat ligjore për realizimin dhe arkëtimin e tyre.

b) Të marrë masa për arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në momentin që lind detyrimi me qëllim mos krijimin e detyrimeve të prapambetura për secilën kategori biznesi.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me Liçencë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejimin e subjekteve të ushtrojnë aktivitetet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën. Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, rezulton se në territorin e Bashkisë Dimal dhe në Njësitë Administrative në vartësi, ushtrojnë aktivitetin 14 subjekte aktualisht të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga 14 subjekte janë pajisur me autorizim 12 subjekte, nga të cilat 2 subjekte janë përpara periudhës objekt auditimi si dhe janë pajisur me licenca/autorizime të reja subjekti 12 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, kanë mbyllur aktivitetin e tyre 2 subjektet të cilat nuk ushtrojnë më aktivitetin në tregtimin me pakicë të hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre si dhe nuk paguar tarifën për tu pajisur me autorizim tregtim karburanti gjithsej 5 subjekte të cilët ushtrojnë aktivitetet dhe papaguar detyrimin fiskal, evidentohen në vlerën **2,600,000 lekë** e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Dimal nga subjektet e paraqitura në Aneksin nr. 3, pika 2.3, *“Debitorë në fushën hidrokarbure të cilët nuk kanë paguar detyrimin e pajisjes me autorizim”*, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Veprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për Sistemin e Taksave Vendore”*, i ndryshuar neni 35, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 *“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”* i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2, faqe 30-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi:Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Dimal, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për pajisjen me liçenca të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe arkëtimin e tarifës së patakshuar prej **2,600,000 lekë** ndaj **5** subjekteve, sipas pasqyrës më sipër. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për pagesën e tarifës së liçencë/autorizimit, Bashkia Dimal në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik të ndërmarrin veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Dimal, nuk ka zbatuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014 *“Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”*, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për Sistemin e Taksave vendore”*, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen. Rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë **137 persona në vlerë 3,822,253 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Dimal**, sipas të dhënave sipas *Aneks nr. 2*, bashkëlidhur

Raportit Përfundimtar të Auditimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2, faqe 30-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi:Drejtorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **3,822,253,lekë** ndaj **137** personave sipas listës, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacioni të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karburant”, me fond limit në shumën 24,000,000 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate në shumën 24,000,000 lekë pa TVSh me marzh fitimi 16.1% ose 17 leke litër, pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se; Në dosjen e prokurimit nuk rezulton të jetë argumentuar dhe justifikuar sasia e parashikuar. Referuar të dhënave të vëna në dispozicion për vitet e mëparshme rezulton se sasia e konsumuar për vitin 2018 është 71,707 litra, për vitin 2019 është 61,963 litra dhe për vitin 2020 është 79,960 litra. Pra referuar 3 viteve të mëparshme sasia mesatare e konsumuar është 71,210 litra. Për vitin 2021 janë parashikuar 102,439 litra sikurse edhe për vitin 2022. Kjo sasi nuk është argumentuar se përse është parashikuar rreth 22,479 litra më tepër nga viti 2020, dhe 44,958 litra më tepër për të dy vitet. Autoriteti Kontraktor nuk ka siguruar një përshkrim të mallrave që nevojiten për nisjen e procedurës, nuk ka siguruar të dhëna të nevojshme nga strukturat përkatëse për parashikimin e sasisë që nevojiten për realizimin e procedurës, të cilat duhet të argumentonin vlerën e kontratës. Bazuar në çmimin e ditës i cili është marrë për llogaritjen e fondit limit i cili është 117,143 lekë pa TVSH me sasinë prej 44,958 litra e pa argumentuar arrihet në konkluzion se vlera prej **5,266,514 lekë konsiderohet vlerë e pa argumentuar e fondit limit** me pasojë përdorimin e fondeve publike jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit. Gjithashtu nuk rezulton të jetë argumentuar përzgjedhja e llojit të kësaj procedure prokurimi si Marrëveshje Kuadër. Veprime e mosveprime jo në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 12, pika 2/a, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 45/1 pika 2, neni 59, pika 2. (Mëhollësishttrajtuarnëpikën4,faqe54-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: - Autoriteti Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimeve në Bashkia Dimal, të marrë masat e duhura që, të mbajë në konsideratë të gjitha aktet ligjore në llogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim përdorimin e fondeve me ekonomicitet.

- Autoriteti Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimeve në Bashkia Dimal, të marrë masat e duhura që përpara hartimit të urdhrin të prokurimit të argumentojë përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit me qëllim kryerjen e një procesi transparent dhe të besueshëm të procesit.

Menjëherë dhe në vijim

6. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi auditimin e zbatimit të kontratës së furnizimit me karburant për vitin 2021 konstatohet se; Me datën 15.12.2012, referuar fletëhyrjes në magazinë me nr. 66, marrë në dorëzim nga magazinierja është bërë hyrje sasia me karburant 12,520 litra “Naftë”, sipas faturës së OE “G.....”, me nr. 432, datë 15.12.2021. Është mbajtur procesverbali nga komisioni i marrjes në dorëzim në të cilin shprehen se kjo sasi është bërë hyrje sipas kontratës së nënshkruar pa nr. prot., datë 15.12.2021 me vlerë 2,140,419 lekë me TVSh. Në këtë procesverbal citohet gjithashtu se “Sipas kërkesave të njëjësive shpenzuese përkatëse komisioni mori në dorëzim sasinë prej 12,520 litra me vlerë 2,140,419

lekë. Ky shpenzim është njohur dhe në kontabilitet nga nëpunësi zbatues, duke e njohur si detyrime në Pasqyrat Financiare të Bashkia Dimal të vitit 2021. Rast i cili konsiston në marrjen përsipër të një angazhimi të pa parashikuar në buxhetin e vitit 2021 për të cilin nuk janë parashikuar fonde në dispozicion, duke shmangur gjithashtu kryerjen e procedurave standarte të prokurimit, mostrajtimin e barabartë të OE, shmangien e konkurrencës, etj. Nga sa më sipër konstatohet se **shuma prej 2,140,419 lekë është shpenzim financiar i pa argumentuar** për buxhetin e Bashkisë Dimal. *Veprime jo në përputhje me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 3, pika 38, neni 40, Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 2, neni 3. (Mëhollësishttrajtuarnëpikën4,faqe54-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Drejtorja e Ekonomisë dhe Financës, të marrin masat e duhura për miratimin e fondeve përkatës në Këshillin Bashkiak para kryerjes së shpenzimeve dhe iniciativave të angazhimeve buxhetore.

Në vijim

MASA DISIPLINORE.

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Dimal**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

1. **Zj. R.S**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, për problemet e konstatuara në lidhje me vlerësimin e ofertave të paraqitura nga Operatorët Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 2 procedura dhe për problemet e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike, si dhe në 1 rast në procesin e dhënies me qira të fondit pyjor;
2. **Zj. L.B**, me detyrë zëvendës Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e personit të autorizuar si titullar i Autoritetit Kontraktor, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në katër procedura, në një rast në llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit si dhe në 1 rast në procesin e dhënies me qira të fondit pyjor;
3. **Z. A.P**, me detyrë Drejtor i Urbanistikës, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në tre procedura, në një rast në procesin e vlerësimit të ofertave për procedurat e prokurimit si dhe në 1 rast në procesin e dhënies me qira të fondit pyjor;
4. **Zj. M.B**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Financave, për problemet e konstatuara në lidhje me programimin dhe zbatimin e buxhetit të bashkisë, si dhe në lidhje me hartimin e kriterëve të kualifikimit në dy procedura prokurimi;
5. **Zj. I.D**, me detyrë përgjegjës sektori për marrëdhëniet me publikun, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kriterëve të kualifikimit në një procedurë prokurimi, në lidhje me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e

vendosura në DST, në 1 procedurë si dhe në 1 rast në procesin e dhënies me qira të fondit pyjor;

6. **Z. I.S.**, me detyrë specialist topograf në Drejtorinë e Urbanistikës, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kriterëve të kualifikimit në një procedurë prokurimi, në lidhje me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 1 procedurë,
7. **Zj. A.G.**, me detyrë specialiste finance, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në një procedurë, në një rast në llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit si dhe në 1 rast në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave.
8. **Z. E.H.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, për problemet e konstatuara në lidhje me hartimin e kërkesave për kualifikim në DST, në katër procedura, dhe në 1 rast në procesin e dhënies me qira të fondit pyjor;

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “Masa Disiplinore”, të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Dimal**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

Z. I.S., me detyrë Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore, për problemet e konstatuara në lidhje me realizimin e ulët të të ardhurave në buxhetin e bashkisë.

Shënim: Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë raport auditimi duhet t'u bëhet prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t'u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT